

Ana tjetër e medaljes

# ÇKA TASH?

**Populli shqiptar i Kosovës duhet të kthehet edhe një herë në politikë, si në vitet 1988, 1989, 1990, 1998 dhe 1999. Në ato vite, kur elitat drejtuese kanë dështuar, populli është kthyer në politikë dhe u ka dhënë drejtim ngjarjeve, me fuqinë e vet. Në këtë betejë, duhet të kërkohet edhe ndihma e mbarë kombit shqiptar.**



**Milazim KRASNIQI**

**M**esazhet që sollën në Prishtinë anëtarët e treshes së autorizuar nga Grupi i Kontaktit për negociatat shtesë ndërmjet Prishtinës e Beogradit, janë cinike dhe shqetësuese. Treshja e përbërë nga Frenk Vizner (SHBA), Wolfgang Ishinger (Bashkimi Europian) dhe Aleksandër Harçenko (Rusi), si mesazh të parë sollën gjoja gatishmërinë e madhe të Serbisë për bashkëpunim në këtë proces. Por, e vërteta është se Serbia bash në këtë periudhë ka ashpërsuar qëndrimin e saj, duke miratuar edhe një rezolutë të re në Kuvend, e cila praktikisht e injoron çdo angazhim ndërkombëtar për Kosovën. Sipas rezolutës më të re të Kuvendit të Serbisë, çështja e Kosovës është e mbyllur si çështje brenda kornizës shtetërore të Serbisë. Nga ana tjetër, zyrtarë të lartë serbë kanë deklaruar se Serbia do të sakrifikojë edhe anëtarësimin në Bashkimin Europian, për ta mbajtur Kosovën në kornizën e vet shtetërore. Në një ambient të këthillë, ekskluzivist dhe nacionalist, nuk është e qartë se ku e kanë parë ndërmjetësit e rinj prirjen e Serbisë për bashkëpunim. Defekti është në faktin se ndërmjetësit e rinj, duke qenë të një niveli të ulët diplomatik, në krahasim me Marti Ahtisarin, janë të ekzaltuar nga detyra e re, të cilën duke e sheshit se as në ëndërr nuk do ta kenë pare. Veçmas Ishingeri dhe Harçenko. Mesazhi i dytë problematik ishte se treshja kërkon “kompromis nga palët”. Pra, edhe nga Kosova kërkohet që të lëshojë pe edhe më shumë nga sa ka lëshuar, duke e pranuar planin e Marti Ahtisarit. Por, Kosova i ka shterur mundësitë e kompromiseve, sepse ka lëshuar pe edhe ashtu jashtë mase, saqë edhe po të zbatohet plani i Ahtisarit, ai nuk do të mundësonte krijimin e një shteti normal dhe funksional. Ndërsa, çdo kompromis tjetër, nënkupton heqjen dorë nga pavarësia e Kosovës. Duket se kompro-

misi kërkohet, në mënyrë që të hapet udhë për planin B të Serbisë, pra për copëtimin e Kosovës. Ky opsion edhe ishte mesazhi i tretë, gjithsesi mesazhi më skandaloz, sepse ai praktikisht e legalizoi temën e copëtimit territorial të Kosovës. Ambasadori Wolfgang Ishinger deklaroi se ata nuk ishin as kundër opsionit të copëtimit, “nëse palët do ta dëshironin këtë”. Është e turpshme që një diplomat gjerman, i cili i ka përjetuar edhe vetë pasojat e copëtimit të atdheut të vet, të flet me aq lehtësi për copëtimin e atdheut të dikujt tjetër. Por, duket se ai e barti këtë mesazh, ngase ia kanë dhënë atë detyrë punëdhënësit e tij, burokrarët e sklerotizuar të Brukselit, të cilët në garë me Rusinë, janë duke e përkëdhelur Serbinë, si ta kishin fëmijë dëshire.

Edhe pse agjenda e treshes së Grupit të Kontaktit nuk është bërë e njohur, e as mandati i saj i vërtetë, (ata thonë se nuk kanë mandat të bëjnë propozime, ndërsa Ishingeri praktikisht e bëri propozimin më skandaloz të mundshëm), tashmë është e qartë se ata do ta kenë mandat që të ushtrojnë presion mbi Kosovën, për t’ia imponuar një status nën pavarësi, ose copëtimin territorial të saj. Atëherë shtrohet pyetja: çka tash? Çka duhet të bëjnë përfaqësuesit e Kosovës në ekipin e unitetit dhe çka duhet të bëjnë qytetarët e Kosovës?

E para, përfaqësuesit e Kosovës në ekipin e unitetit, duhet të vazhdojnë të mbajnë qëndrim refuzues ndaj çdo opsioni që çon drejt ndarjes ose drejt mbetjes së Kosovës nën Serbinë. Këto opsione nuk duhet të trajtohen fare. Më mirë e kanë të prishen me partnerët e rremë ndërkombëtar se sa me

popullin e vet.

E dyta, kryetari i Kosovës duhet të insistojë në shpalljen e zgjedhjeve të reja parlamentare, nga të cilat do të dilte një Kuvend më i fuqishëm dhe një qeveri më e fuqishme. Nëse nuk mbahen zgjedhjet e reja parlamentare, më 10 dhjetor 2007 Kuvendi aktual nuk ka mandat që ta shpall pavarësinë e vendit. Duket se strategët që duan shtyrjen e zgjedhjeve, pikërisht këtë edhe e kërkojnë, pra që nëse Kuvendi e shpall pavarësinë, ajo të llogaritet jolegale, për faktin se shpallet nga një Kuvend të cilit i ka skaduar mandati.

Ndërsa, populli shqiptar i Kosovës e ka edhe një betejë politike para vetes. Edhe pse janë të zhgënjyer me qeverinë dhe me përfaqësuesit e zgjedhur, qytetarët duhet të mos abstenojnë, po duhet ta artikulojnë me forcë vullnetin e vet për pavarësinë e Kosovës. Kjo mund të manifestohet në procesin elektoral, (nëse mbahen zgjedhjet), por edhe me anën e protestave paqësore, nëse nuk lejohet mbajtja e zgjedhjeve. Populli shqiptar i Kosovës duhet të kthehet edhe një herë në politikë, si në vitet 1988, 1989, 1990, 1998 dhe 1999. Në ato vite, kur elitat drejtuese kanë dështuar, populli është kthyer në politikë dhe u ka dhënë drejtim ngjarjeve me fuqinë e vet. Në këtë betejë, duhet të kërkohet edhe ndihma e mbarë kombit shqiptar.

Mesazhi i kombit shqiptar edhe këtë herë duhet të jetë paqësor, por duke e zgjedhur përfundimisht dilemën ndërmjet paqes me çdo kusht dhe pavarësisë së Kosovës me çdo kusht. Në favor të pavarësisë së Kosovës.



Treshja e Grupit të Kontaktit.

Intervistë me Blerim Kuçin, ministrin që koordinoi shuarjen e zjarreve në Kosovë

# GJENDJA E SIGURISË NË VEND ËSHTË E QETË, POR E BRISHTË

**P**AQJA: Kosova ka qenë në javët e shkuar e tronditur nga një seri zjarresh. A janë vënë të gjitha zjarret nën kontroll?

**KUÇI:** Për fat të mirë zjarret tash për tash janë nën kontroll.

Komiteti ndërministror, i cili është formuar përballë kësaj situatë emergjente, ka filluar përmbylljen e punës së vet. Prej gjendjes së gatishmërisë, shërbimet emergjente kanë ulë nivelin e gatishmërisë në gjendje normale të punës, kurse Komiteti ndërministror është duke e bërë përmbylljen e dokumentacionit teknik, do të thotë se zjarre nuk kemi tash për tash.

Sivjet kushtet klimatike kanë qenë shumë të përshtatshme për t'u përhapur zjarret, kushtet klimatike në Kosovë edhe në rajon kanë mundësuar që zjarret të përhapen. Duke e parë këtë situatë, Departamenti për Emergjencë më 8 korrik ka kërkuar prej Qeverisë të ndërmerr hapa konkretë, në pajtim me Ligjin mbi Fatkeqësitë Natyrore dhe ka paralajmëruar se këtë vit do të kemi vështirësi më zjarret. Në pajtim me këtë kërkesë, më 20 korrik të këtij viti Qeveria ka krijuar Komitetin Ndërministror, në bazë

të Ligjit mbi Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, dhe ka rritur nivelin e gatishmërisë për të përballuar këtë situatë. Gjendja ka qenë shumë alarmante nga fundi i muajit korrik.

**PAQJA: Zotëri Kuçi cilat janë vendimet e Qeverisë për t'u përballur me situatën e vështirë me zjarre?**

**KUÇI:** Duke e parë situatën e vështirë me zjarre, ku 71 zjarre janë paraqitur të shkallës së rrezikshmërisë së lartë, Qeveria ka marrë vendim për krijimin e shtabeve komunale, që ka mundësuar punën Komitetit Ndërministror në aspektin e prokurimit, në aspektin e angazhimit të potencialit teknik dhe njerëzor. Urdhëresat që janë nxjerrë nga Komiteti Ndërministror janë bazuar në ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, dhe komforë një rregullore që ka hartuar qeveria për menaxhimin e kësaj situatë.

Probleme të mëdha kemi pasur fillimisht po edhe gjatë menaxhimit të kësaj situatë në disa regjione, sidomos në regjione të pasura me pyje, si pjesa e Pejës, e Istogut, e Gjakovës, e Therandës, një pjesë e Podujevës.

**PAQJA: Cili ka qenë bashkëpunimi i Qeverisë me Shtabet Komunale dhe a i kanë zbatuar vendimet e Qeverisë këto shtabe?**

**KUÇI:** Shtabet Komunale kanë vepruar komforë vendimeve. Jemi munduar të vendosim një mekanizëm për t'i futur në lëvizje këto shtabe.

Qeveria e Kosovës, përherë të parë është përballur me një situatë të tillë dhe ka vepruar në bazë të ligjit, përherë të parë Qeveria ka vendos mekanizma për përballje me situatat emergjente. Duke e pasur parasysh se përherë të parë jemi përballur me këso lloj situatë, fillimisht kemi pasur disa vështirësi për dinamikën e zbatimit të këtyre vendimeve dhe kualitetin e zbatimit të tyre. Përmes mediave kemi bërë trysni që ka qenë shumë pozitive. Kemi krijuar një grup punues, që ka për detyrë të mbikëqyrë zbatimin e vendimeve të Qeverisë komforë kësaj situatë, dhe po ashtu edhe zbatimin e kualitetit të këtyre vendimeve. Ky grup është në terren duke e kryer punën dhe do t'i jep rekomandimet e veta për marrjen e masave rreth zbatimit ose moszbatimit të tyre. Për fat të keq, një pjesë e komunave nuk janë në dijeni për ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, po ashtu nuk janë në dijeni se cilat janë detyrat për situatë të gatishmërisë. Deri sa është vënë kjo lidhje, edhe pse ka qenë një kohë e shkurtër, kemi pasur vështirësi. Me vonë, me vendosjen e këtij komunikimi, ka filluar zbatimi i vendimeve, po ashtu është rritur kualiteti i zbatimit të tyre edhe kemi mundur ta menaxhojmë situatën.

**PAQJA: Kush ka kontribuar për luftën kundër stuhisë së zjarrit, krahas zjarfikësve?**

**KUÇI:** Duhet të kemi parasysh se komplet rajoni ka qenë në gjendje të vështirë në përballje me zjarrin. Ka qenë një mobilizim i mirë për shuarjen e zjarrit nga Njësi i Zjarfikësve, KFOR-i, TMK-ja, SHPK-ja. Intervenimi i KFOR-it ka qenë i shkëlqyeshëm, që na ka ardhë në ndihmë edhe nga ajri por herë pas here



► Ministri, Blerim Kuçi

edhe nga toka me njësitet e veta të zjarfikësve, por sidomos nga ajri me aktivizimin e nëntë helikopterëve për shuarjen e zjarrit.

Detyra e komitetit ndërmënor ka qenë koordinimi i këtyre mekanizmave për ta përballuar me situatën. Po ashtu edhe një kontribut të madh për shuarjen e zjarreve kanë dhënë edhe njësitet vullnetare, të formuara nga Kuvendet komunale.

**PAQJA: A po bëhet vlerësimi i dëmeve që janë shkaktuara nga zjarri?**

**KUÇI:** Ndër detyrat e këtij komiteti ndërmënor kur është gjendja e nivelit të gatishmërisë, është edhe me vlerësimin e dëmeve. Është krijuar grupi qendror, e edhe grupet komunale. Është edhe një vendim i komitetit ndërmënor që ne duhet dalim deri më 1 shtator me një raport mbi vlerësimin e dëmeve.

**PAQJA: A ekziston ndonjë projekt që të kompensohen pronaret, të cilëve u janë shkaktuar dëme nga zjarret?**

**KUÇI:** Mandati i Komitetit ndërmënor nuk është të bëjë vlerësimin e dëmeve nga këto zjarre, mandati i këtij komiteti është të menaxhojë me këtë situatë dhe ta bëjë eliminimin e rrezikut. Fondi i ndarë nga Qeveria prej 700 mijë eurosh, ka të bëjë më menaxhimin e situatës. Se si do të bëjë kompensimin dhe a do të bëjë kompensimin, është



**Zjarri, armiku natyror i maleve!**

çështje e Qeverisë.

**PAQJA: A ka pasur zjarrvënje të qëllimshme dhe nëse po, a dihet motive të tyre?**

**KUÇI:** Ne kemi një raport mbi hetimet e SHPK-së, nën hetime janë 369 persona, prej tyre më shumë se 12 të janë arrestuar sa i përket vënies së zjarreve. Faktori natyror nuk ka futur zjarrin, faktori natyror e ka ndihmuar në përhapjen e zjarrit. Vënia e zjarreve është bërë nga

faktori njeri, sepse është pakujdesia ndaj zjarrit. Pra, nuk është reaguar konform kushteve klimatike për përhapjen e zjarreve. Po ashtu, për fat të keq, ka edhe zjarre të qëllimshme.

**PAQJA: Meqë disa zjarre kanë qenë në zonat kufitare, a ka pasur bashkëpunim ndërshtetëror për shuarjen e tyre?**

**KUÇI:** Më duhet ta pranoj se shtetet kufitare nuk kanë pasur një qasje të mirë



**Zjarrfikësi duke e bërë punën e tij!**



sa i përket zjarre-  
ve që iu kanë  
afru-  
a r  
e dhe  
kufijve  
tanë, me  
disa edhe për  
shkak të ra-

porteve politike,  
me përjashtim të  
Shqipërisë. Me  
autoritetet  
e Shq-  
ipërisë  
kemi pasur  
bisedime, kemi bërë disa  
para marrëveshje rreth  
shuarjeve të zjarreve.  
Së paku jemi përgat-  
itur për një nivel të r-  
ezikshmërisë së lartë, kemi  
menaxhuar së bashku pjesët  
kufitare ku Shq- ipëria ka ndihmuar  
prej ajrit, ndërsa ne me zjarrfikës prej  
tokës.

**PAQJA: Zotëri ministër, jo vetëm në  
kontekst të këtij zhvillimi, por edhe në  
kontekstin e përgjithshëm, cila është  
gjendja e sigurisë në vend?**

**KUÇI:** Vetë ky proces, i definimit të  
statusit përcjillet me shumë probleme  
në aspektin e sigurisë, sepse Kosova  
përveç se ka shumë miq, ka edhe jo miq  
të pavarësisë. Ne po mundohemi të me-  
naxhojmë sigurinë, por duhet të kemi  
parasysh se në aspektin e sigurisë në  
Kosovë, kompetent janë UNMIK-u dhe  
KFOR-i. Ne i kemi disa kompetenca të  
limituara në aspektin e sigurisë. Minis-  
tria e Punëve të Brendshme bashkë me  
Qeverinë bëjnë përpjekje maksimale  
dhe nuk i ikin përgjegjësisë, që e kanë  
para qytetarëve. Gjendja e sigurisë në  
vend është e qetë, por e brishtë.

**PAQJA: Cili është roli i qytetarëve në**

të organizuar, duke piketuar  
ndonjë pistë.

**PAQJA: Cili  
është bash-  
këpunimi i struk-  
turave të sigurisë në  
rajon në luftën kundër  
krimit?**

**KUÇI:**  
Kam pas disa vizita në  
rajon, kam pas një takim  
me ministreshën  
e Punëve të  
Brendshme  
të Maqe-  
donisë dhe me  
stafin e saj, me ministrin e  
punëve të Brendshme të  
Shqipërisë dhe të Malit të  
Zi, ku kemi hartuar disa  
para marrëveshje në  
aspek-  
të të bashkëpunimit  
në luftën e kimit të organizuar  
, jemi në pro- ces të implementimit  
të tyre marrëveshjeve.  
Megjithatë, kemi kontakte edhe në mes  
të homologëve dhe në nivel të policisë.

## kundër

**KUÇI:**  
disa sonda-  
i qytetarëve  
madh, ai be-  
ose është në  
të mëdha . Ne po bëjmë përpjekje ta  
rritim këtë besim, por shtyrja e statusit  
e ka çrregulluar besimin tek qytetarët,  
menaxhimi jo i mirë me data. Nëse do  
të kemi prapë shtyrje të statusit do të  
jetë vështirë të menaxhojmë situatën.

**PAQJA: Cili është bashkëpunimi i  
strukturave të sigurisë me mediat në  
luftën kundër krimit?**

**KUÇI:** Disa media e kanë edhe politikë  
ditore. Shpesh kjo për të kontribuar për  
situatë , për të luftuar krimin e organi-  
zuar, por edhe në aspektin e sigurisë .  
Disa media i ndihmojnë kësaj çështjeje,  
sidomos në çështjen e adresimit mediat janë  
prezentë çdo kund, janë nihatës të mirë , ndih-  
mojnë sektorin e hetuesisë dhe sektorin e krimit

## luftën krimit?

Në bazë të  
zheve, besimi  
në SHPK është i  
sim është në rritje  
në një rrafsh pa lëvizje  
të mëdha . Ne po bëjmë përpjekje ta  
rritim këtë besim, por shtyrja e statusit  
e ka çrregulluar besimin tek qytetarët,  
menaxhimi jo i mirë me data. Nëse do  
të kemi prapë shtyrje të statusit do të  
jetë vështirë të menaxhojmë situatën.

**PAQJA: Zotëri Kuçi mesazhi i juaj për  
qytetarët e Kosovës dhe për lexuesit e  
revistës "PAQJA"?**

**KUÇI:** Kosova ka institucionet e veta ,  
vendimet që do të merren nga Kuvendi  
i Kosovës do të jenë obligative për  
Ministrinë e Punëve të Brendshme.  
Qytetarët e Kosovës duhet të kenë be-  
sim tek MPB-ja dhe SHPK-ja, po ashtu  
duhet të bashkëpunojnë me ta.

**PAQJA: Për fund?**

**KUÇI:** Mediat i kisha lutur që të jenë  
më konstruktive në raport me sigurinë  
E falënderoj revistën "PAQJA", për  
mundësinë që ma dhatë t'i përcjellë  
këto informacione dhe mesazhe tek  
lexuesit tuaj.

Intervistoi  
**LULZIM AHMETI**

Dasmat kosovare

# Le të festojmë-çka!

Imazhi i dasmave të këtij viti sikur po jep një mesazh të harresës së MADHE. Akoma pa e përfunduar problemin madhor, jemi duke festuar. Serbia festoi fitoren e saj, ajo ia arriti në një mënyrë ta pengojë vendimin që do të dilte nga Këshilli i Sigurimit, ndërsa populli ynë feston martesën e dy të rinjve tanë. Ndërsa Qeveria jonë e 'stërlodhur' ka preferuar pushime me përjashtim të propagandës së re të ecjes së Veton Surroit.

Mergim LUSHTAKU

**K**ëto ditë pushimi, kur shumica e kompanive në shtetet perëndimore ka rezervuar pushimet vjetore, tek ne po vërehen lëvizje jo të zakonata! Mos vallë po protestohet, ç'ka ndodhur në rrugë? Pyesin shpeshherë shoferët e makinave të cilët me nxitim janë nisur për në qytet për hallet e tyre. Jo mor vëlla, janë dasmorë!

Shumëkush po ia vë fajin 'musafirëve të verës' por kujdes se mërgimtarët janë pjesë jona dhe, ata duhet trajtuar si më mirë të jetë e mundur. Ata nuk janë mysafirë në shtëpitë e tyre, por për hir se kanë kohën e qëndrimit të limituar duhet trajtuar me kujdesin më të madh të mundshëm. Ata janë viktimat e parë e shoqërisë sonë, prandaj kujdes me ta. Po dëgjojmë nëpër vende të ndryshme që mërgimtarët e kanë prishur qetësinë në vendin tonë sepse kanë shkaktuar kaos nëpër rrugë, me veturat e tyre ose edhe nëpër dasma. Jo. Kaosi nuk vjen prej tyre, por prej mos lëvizjeve të vetëdijshme të banorëve tanë, kaosi vjen prej policisë rrugore e cila ndalon makinat në rrugë në vende jo të përshtatshme për të ndaluar, kaosi vjen nga gropat e hapura nga ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve, kaosi vjen nga mos limitimi me ligj i zmadhuesve të zërit, përcaktimi i vendit dhe koha e mundshme për ahengej etj.

Mos i fajësoni mërgimtarët, ata kanë ardhur nga mërgimi dhe nuk duhet të kthehen të mërzhitur nga ne. Të gjithë janë të një mendimi, se mërgimtarët janë ata që më së shumti dëgjojnë ngjarjet se ç'po ndodh në Kosovë dhe më së shumti kontribuojnë për përmirësimin e vendit. Një qytetar mund të ankohet nga kaosi në rrugë, apo nga zerimi i stërzburmshëm në lagjet e banuara, por faji mbetet në organet e rendit dhe ndërgjegjia e dasmorëve. Nga mërgimtarët mërzhiten vetëm ata që kanë mbaruar punë me ta dhe duan të merren me 'lirinë' e tyre.

## Përfitimet ekonomike dhe dasmat


Nëse e shikojmë nga prizmi ekonomik, një dasmë mesatarisht kushton nga tetë mijë deri në dymbëdhjetë mijë euro. Nëse në Kosovë përafërsisht gjatë një muaji veror janë organizuar dy mijë dasma, kjo rezulton se janë harxhuar njëzet milion euro! Shumë jo e vogël për një popull shumë të vogël. Nëse shtrohet pyetja, cila do të ishte më e mirë për vendin tonë të organizoheshin dasmat ose të jepej për skamnorët që ditë e më shumë po shtohet numri i të vetëvlarëve, ose të ndonjë institucioni tjetër? Me siguri që përgjigja do të ishte e vështirë. Vendasit sikur janë mësuar që dikush tjetër tua evitohet problemet e tyre, ndërsa buxheti i shtetit duhet të harxhohet në organizimin e miss-ave dhe këngëtareve ose edhe mëditjeve enorme për 'politikanët'.

## Mesazhi

Por në këtë nuk duhet shtruar në këtë mënyrë, por ajo që është brengosëse është fakti se shumë shpejt po har-

rojmë, se cili është statusi ynë. Politikanët tanë treguan se janë të pa aftë të merren me diplomaci, por populli nuk duhet të harrojë aq shpejt se kush ishim dhe cila është detyra jonë. Populli (së bashku me mërgimtarët) mbetet forca kryesore për ndryshimin e gjendjes, si dhe ndryshimin e stilit të dasmave. Nuk është e nevojshme që krushq të shkojnë pesëdhjetë e më shumë vetura, por do të mjaftonin dy, eventualisht tri vetura, ndërsa të tjerët t'i presin në restorante ose nëpër shtëpi...

Por imazhi i dasmave të këtij viti sikur po jep një mesazh të harresës së MADHE. Akoma pa e përfunduar problemin madhor, jemi duke festuar. Serbia festoi fitoren e saj, ajo ia arriti në një mënyrë ta pengojë vendimin që do të dilte nga Këshilli i Sigurimit, ndërsa populli ynë feston martesën e dy të rinjve tanë. Ndërsa Qeveria jonë e 'stërlodhur' ka preferuar pushime me përjashtim të propagandës së re të ecjes së Veton Surroit.



Dasmat që kushtojnë shumë.

Përfundon Edicioni i Shtatë i Universitetit Veror

# Projekti më i suksesshëm i Universitetit të vetëm publik në Kosovë është UVP

Qëllimi kryesor i UVP-së është Evropianizimi i Universitetit të Prishtinës ndërsa Prorektorja për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës (UP), Syzana Manxhuka – Kërliu, ka thënë se UVP-ja konsiderohet si një ndër projektet më të mëdha në rajon, i cili rreth vetes mbledh më së shumti studentë dhe profesorë ndërkombëtar.



Gëzim QERIMI

**K**a përfunduar Edicioni i Shtatë i Universitetit Veror të Prishtinës – UVP-së, në të cilin kanë marrë pjesë rreth 400 studentë nga Kosova, rajoni dhe nga vendet e tjera të botës.

Me rastin e përfundimit të këtij edicioni të sivjetmë të UVP-së, drejtues të universitetit e kanë cilësuar si të suksesshëm organizimin dhe ecurinë e UVP-së. “Objektivi ynë është internacionalizimi dhe evropianizimi i Universitetit të Prishtinës. Kështu që ne

kemi menduar që përmes organizimit të UVP-së të arrihet një gjë e tillë, si dhe të rritet cilësia e mësimdhënies”, ka theksuar Prorektorja për Marrëdhënie me Jashtë në Universitetin e Prishtinës, Syzana Manxhuka-Kërliu .

Programin akademik të UVP-së, këtë vit, e kanë begatuar edhe një sërë aktivitësh sociale si: gjashtë forume publike me mysafirë politikanë e ekspertë, ekspozita, mbrëmje filmi dhe ahengje, pastaj ekskursione nëpër vendet me të vizituara të Kosovës si dhe një sërë turnirësh sportive.

Gjithashtu janë organizuar 15 kurse akademike nga fushat e shkencave sociale, juridike, ekonomike, kulturës fizikë, teknike, natyrore dhe nga shkencat e mjekësisë.

Kurse të veçanta mund të themi se kanë qenë kursi i artit, i cili ka rezultuar me hapjen e një ekspozite, pastaj kursi i

arkeologjisë, volejbollit në plazh, bukuria e Kosovës nga këndi i fotografisë etj.

Gjithashtu, risi e Edicionit të Shtatë të UVP-së, ka qenë përdorimi i gjuhës angleze, i cili ka qenë edhe kusht kryesor për praninë në Universitetin Veror të Prishtinës.

Studentët që i kanë vijuar kurset në këtë universitet, do t’u njihen kreditë, në bazë të të cilave janë vlerësuar. Njohja e këtij vlerësimi do të bëhet jo vetëm nga Universiteti i Prishtinës por edhe nga universitetet e tjera jashtë Kosovës.

Në këtë edicion kanë aplikuar mbi 1600 studentë nga mbarë bota, ndërsa janë pranuar 408, por 34 studentë pasi janë pranuar janë tërhequr, çfarë do të thotë se në këtë edicion kanë qenë gjithsej 374 studentë, nga të cilët 278 prej tyre janë certifikuar për suksesin e treguar në kurset e tyre përkatëse, ndërsa 96



Prishtina International Summer University  
2007  
16 JULY - 03 AUGUST 2007

studentë nuk janë certifikuar për shkak të mungesave të shumta dhe mos angazhimit të duhur në kurset përkatëse. Dhe ky

vlerësim e bënë edhe më serioz UVP-në, pasi kjo tregon më së miri se organizimi i UVP-së nuk është çështje formale por për tu certifikuar në këtë universitet duhet punë dhe angazhim për të arritur deri te suksesi. Në UVP, 258 studentë kanë qenë studentë vendor, 38 nga vendet e ndryshme të Evropës, 10 nga vendet e ndryshme të Botës, ndërsa 68 studentë kanë qenë nga vendet e rajonit, të cilët i janë ndarë edhe bursa nga organizatorët. Shtetet pjesëmarrëse të këtij edicioni kanë qenë: Kanadaja, Meksika, SHBA-të, pastaj nga Evropa: Austria, Estonia, Franca, Gjermania, Hungaria, Rumania, Italia, Latvia, Holanda, etj, nga vendet e rajonit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegov-

Kroacia, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi.

Edicioni i sivjetshëm ka kushtuar gjithsej 250 mijë euro. Donatorë kryesorë vazhdojnë të jenë Ministria e Jashtme e Hollandës, pastaj Universiteti i Prishtinës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, Pro Credit Bank, OSCE-ja, etj.

UVP-ja ka filluar punimet nga 16 korriku i këtij viti, me të vetmin qëllim që të stimulojë bashkëpunim akademik në Evropën Juglindore dhe të zhvillojë rrjetin rajonal profesional, të integrojë Arsimin e Lartë të Kosovës në sistemin evropian duke zbatuar linjat e kartës ose të veprimit të Bolonjës, pastaj të nxisë bashkëpunim të qëndrueshëm me profesorët vizitues dhe me universitetet e tyre dhe të përmirësojë kualitetin e arsimit.

Universiteti Veror i Prishtinës u organizua nga Bordi Drejtues i emëruar nga Senati i Universitetit të Prishtinës në këtë përbërje:

### **Bordi Drejtues i Universitetit Veror Ndërkombëtar në Kosovë:**

1. Jehona Lushaku – Drejtoreshë e Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë në UP
2. Gëzim Qerimi – Kryetar i Parlamentit të Studentëve të UP .
3. Prof. Dr. Luan Ahma – Prorektor i Universitetit të Prishtinës
4. Prof. Dr. Ferdije Zhushi – Etemi – Koordinatore e ECTS
5. Fidan Hamiti – Zyrtar i Programit të UVP-së
6. Carola Schimdt – Përfaqësues ndërkombëtar nga ATA- Amsterdam
7. Prof. Dr. Isa Elezaj – Dekan i Fakultetit të F.SH.M.N-së
8. Prof. Dr. Safet Merovci – Profesor në Fakultetin Ekonomik në UP
9. Guri Shkodra – Përfaqësues nga organizata ndërkombëtare ATA

Botohet nga O.J.Q. “Zëri Ynë”

### **Redaksia**

Redaktor përgjegjës: **Muhamed Jusufi - KAJOLLI**; Redaktor: **Flamur MALOKU**; Redaktor gjuhësor: **Mimoza SINANI**; Redaktor Teknik/Grafika: **Osman D. GASHI**; Anëtarët e redaksisë: **Arber ZEKA, Ilir DESKU, Shkelzen NUZA, Mergim LUSHTAKU, Gëzim QERIMI, Lulzim AHMETI, Sead UJKANI**; e-mail: [revistapaqja@gmail.com](mailto:revistapaqja@gmail.com), [revistapaqja@hotmail.com](mailto:revistapaqja@hotmail.com), [revistapaqja@yahoo.com](mailto:revistapaqja@yahoo.com); Adresa: **Xhavit Mitrovica, nr. 14 përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë**; Fusnotat e referencat e teksteve i mban redaksia. Kontakti: **+377 44 418 935, +377 44 637 111, +377 44 633 281**

Kampi arkeologjik "Ulpiana 2007"

# KËTË VIT DIREKT ME HULUMTIME ARKEOLOGJIKE

**Këtë vit për dallim nga vitet e tjera ka ndryshuar edhe mënyra e punës në gjurmimet arkeologjike". tha Kemajl Luci arkeolog pranë Muzeut të Kosovës njëherit organizator i kampit**

**Lulzim AHMETI**

“Edukimi i të rinjve kosovarë për trashëgiminë kulturore” ishte motoja e kampit multietnik arkeologjik “Ulpiana 2007” i cili u mbajt nga 18 korriku deri më 3 gusht.

Në këtë kamp morëm pjesë afro 40 të rinjë nga komuniteti shqiptar , serb dhe romë, nxënës të shkollave të mesme të cilët vinin nga Prishtina, Plemetini, Lipjani dhe Graçanica.

Kampi multietnik arkeologjik “Ulpiana 2007”, është organizuar nën patronatin e Ministrisë për Kulturë Rini dhe Sporte, Muzeu i Kosovës dhe OSBE-ja , ndërsa u mbështet nga KFOR-i dhe disa zyra diplomatike në Prishtinë.

Kampi multietnik Arkeologjik “Ulpiana 2007”, është tradicional me ç`rast ky është viti i katërt që organizohet. “Këtë vit për dallim nga vitet e tjera ka ndryshuar edhe mënyra e punës në gjurmimet arkeologjike”. tha Kemajl Luci arkeolog pranë Muzeut të Kosovës njëherit organizator i kampit “Ulpiana 2007”: “Në vitin e parë është bërë njoftimi me arkeologjinë si shkencë dhe arkeologjinë e Kosovës, në vitin e dytë është bërë pastrimi I lokalitetit Ulpiana ,ndërsa në vitin e kaluar dhe këtë vit kemi filluar të merremi direkt me hulumtime arkeologjike. Përveç kësaj anëtarët e kampit kanë rastin t`i vizitojnë edhe vendet fqinje në mënyrë që të njihen me kulturat e Ballkanit.

Një kontribut të veçantë në organizimin dhe mbarëvajtjen e kampit ka

dhënë edhe KFOR-I shtoi më tutje Kemajl Luci: Që nga viti i parë i mbajtjes së kampit KFOR-I na ka ndihmuar me logjistikë. Ata e kanë kontrolluar terrenin qysh vitin e parë të mbajtjes së kampit a është i minuar, për me qenë fëmija më të sigurt.

Pjesëmarrësit e kampit u shprehën të kënaqur që patën mundësi të merrnin pjesë në këtë kamp. Njëra ndër ta ishte edhe Aurora Kastrati nxënëse e gjimnazit “Sami Frashëri” në Prishtinë e cila po merr pjesë për të katërtën herë me radhë: “Për vetë faktin që gjendem për katër vjet më tërheq diçka për arkeologjinë sepse është një kulturë që më lidh me të kaluarën dhe të tashmen e qytetit tonë, kjo do të thotë që do të vazhdoj edhe më tutje”.

Po ashtu edhe nëntëmbëdhjetë vjeçari Avni Mustafa nga Plemetini tha se gjatë pjesëmarrjes në kamp kishte kaluar shumë mirë: “Ne kalojmë shumë mirë me shokët tanë shqiptarë, serbë dhe të etnive të tjera. Ky kamp më ka lënë përshtypje të mira. Dëshiroj të ftoj të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në kampin “Ulpiana”. Pjesën më të madhe të kohës e kalojmë duke gërmuar, duke zbuluar mure të vjetra, pasi që shumica prej tyre janë të rrënuara. Kemi gjetur shumë qeramikë (art poçarie) dhe vazo.”

Në fund, Aurora Kastrati pjesëmarrëse e kampit porositi të gjithë qytetarët: Ju lutemi ruani sa më mirë ato që i përkasin të kaluarës dhe sidomos ato që i përkasin të tashmes.

Me organizimin e kampit multietnik arkeologjik “Ulpiana 2007” bëhet vetëdijesimi i të rinjve për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike te Kosovës.



► Qyteti antik i Ulpianës!

Post-modernia te shqiptarët

# Deformimi i sensuales dhe banalizimi i saj

**Fotografia e sintetizuar, digjitalisht e gjeneruar, nuk është më përfaqësim i reales, por simulim i pseudorealitetit që nuk ekziston, por virtualisht është potenciale. Kjo domethënë se fotografia e sintetizuar më nuk i referohet ngjarjes të cilën e përfaqëson, por mundësinë, rastësinë, virtualitetin. Fotografia e sintetizuar është derealizim i botës dhe krijim i sërishëm i reales, hiper-reales.**




Avni AVDIU

**P**ornografia, kjo mbretëri e hiperseksualitetit që më parë ishte 'diamant' i pazbuluar në zgafellat e intimitetit dhe fshehtësisë ose vështirë për t'u gjetur, tani veçqë pushtoi revistat, televizionet private dhe faqet e internetit. Pas mesnate shumë të rinj mbetën deri në orët e hershme të mëngjesit pa gjumë ndër sy për t'i parë modelet e para të filmave që vinin nga Perëndimi. Ishte një etje e madhe për diçka që më parë ndalohej rreptësisht. Vërshimi i të folurit dhe imazheve për seksin në tërë hapësirën e komunikimit masiv, duket se ka arritur sot përpjesëtime aq të shumta sa më së shpeshti bëhet fjalë për stërngopje dhe neveri. Ndërkaq, omnipresenca e seksit në kohët e fundit është rezultat i një shpërthimi që ndodhi pas shumë shekujsh të ndalesave dhe shtrëngesave nga morali komunist dhe religjioz, të cilët predikuan ndrydhjen e manifestimit të aktivitetit seksual, duke e trajtuar seksin si diçka të turpshme. Mirëpo, gjithashtu ishte edhe një shkrim i madh për t'u stërngopur me imazhe që ofronin penetrimin e shigjetës së shikimit thellë në intimitetin e theksuar. Disa asociacione humanitare dhe kulturore filluan që në frymën e 'edukimit seksual' të shpërndajnë falas mjete prezervative, duke stimuluar dhe provokuar drejtpërdrejt përdorimin e tyre. Në këtë mënyrë të rinjtë e kuptuan mesazhin e tyre: 'just do it'. Pritej që ky shpërthim i furishëm i hiperseksualitetit t'i spërkas edhe shqiptarët me hiperfenomene të kësaj natyre. Tashmë 'skandalet te shqiptarët' ishin

gjërat më të këndshme që zgjonin kërshëri dhe sensacione. Revistat erotike (si psh: 'Erotika', 'Mollë e ndaluar'...) flisnin për skandale seksuale të fshehta të VIP-ve shqiptarë. Thuhej se qarkullonin edhe videoinçizime, të cilat më pas kërkoheshin me të madhe në videoklube. Në fund të revistave duke u mbajtur në konfidencë jepeshin karakteristika të vajzave që duan 'seks grupor' ose çifteve që duan lidhje të tilla. Thuhej se të interesuarit mund t'i marrin numrat në redaksi ose t'i drejtohen redaksisë. Në njëfarë mënyre formohej bastioni dhe rrjeti i seksualitetit. Pastaj jepeshin edhe reklamime për sex-shop-et që posedonin të gjitha gjërat erotike të nevojshme, të importuara nga jashtë. Tjetra revistë i tregon favorët e Viagres dhe i porosiste pleqtë që ta shkelin moshën e tyre me ndihmën e saj. Gjithashtu mund të shiheshin edhe foto erotike dhe pornografike, ku thuhej se janë të çifteve shqiptare, karakteris-

tikë e të cilave foto ishte mjegullimi i fytyrës ose mosshfaqja fare e saj. Mund të ishte fotomontazh, mund të ishte vetëm përhumbje e identitetit...gjithçka ishte e mundur. Por qëllimi ishte i vetëm...që të thyhet akulli edhe te shqiptarët. Në këso rastesh duket se mediat e gjejnë ekstazën e kënaqësisë: nga njëra anë rritet tirazhi i tyre dhe nga ana tjetër edhe lexueshmëria. Spekulumet s'kanë të ndalur. Është zor të kuptohet çka është reale e çfarë ireale... vetëm se imazhe ka sa të duash. Ndoshta mund të thuhet se po e jetojmë botën e imazheve, ku 'faktet' përcillen (ose montohen) me simbole dhe fotografi. Fotografia e sintetizuar, digjitalisht e gjeneruar, nuk është më përfaqësim i reales, por simulim i pseudorealitetit që nuk ekziston, por virtualisht është potenciale. Kjo domethënë se fotografia e sintetizuar më nuk i referohet ngjarjes të cilën e përfaqëson, por mundësinë, rastësinë, virtualitetin. Fotografia e sinteti-



Viagra, "ilaqi" për të moshuarit! ◀

zuar është derealizim i botës dhe krijim i sërishëm i reales, hiper-reales.

Në faqe të internetit automatikisht publikohen edhe xhirimet që s'dihet se si arrijnë deri te shpërthimi i tyre elektronik. Tashmë në faqe interneti mund të shihen edhe pamjet e deputetit Nikollë Lesi, artistes dhe këngëtares Inis Gjoni dhe pamjet nga një shkollë e mesme në Tiranë.

Këngëtarja Inis Gjoni lakuriq drogohet para se të bëjë seks me të dashurin e saj; Deputeti Nikoll Lesi bën marrëdhënie intime në WC me një vajzë; një nxënëse e shkollës së mesme "Petro Nini" në Tiranë në mes të klasës para nxënësve dhe kamerat bën seks oral me një shok të saj. Sfera private është çarë me ose pa dashje, me ose pa hirë. Sot në shumë rubrika të shtypit, në emisione radio-televizive (një prej tyre p.sh është emisioni në KTV "Kush asht ma i...", i cili ndalohet për t'u shikuar nga fëmijët) përmes 'lidhjeve të nxehta telefonike' përsëriten pareshtur rrëfimet për përvojat seksuale nga më të ndryshmet.

Kjo pamëdyshje të kujton trajtimin që i bën Mishel Fuko seksit në "Historia e seksualitetit" e ndarë në tri vëllime: "Vullneti për të ditur", "Përdorimi i kënaqësive" dhe "Brenja për veten", ku shtrohet statusi i seksit në qytetërimin perëndimor. Fuko i parashtron mekanizmat subtil që janë prodhuar në historinë e Evropës së krishterë për prodhimin e



Deputeti, Nikoll Lesi. ◀

të vërtetës për seksin. Në perëndim ka munguar arti i kultivimit të kënaqësive seksuale, gjersa ky ka qenë i pranishëm në Kinë, në Indi dhe në botën arabo-muslimane. Ky art ka gjurmuar mundësitë e shtimit të intensitetit të kënaqësive erotike duke zhvilluar njëherit përmes metodave ezoterike bartjen brez pas brezi të sekreteve për këto kënaqësi. Qytetërimi perëndimor, gjegjësisht krishterimi ka

zhvilluar një dije shkencore për seksin –scientia sexualis, që bazohet në kultivimin e vullnetit për të njohur të vërtetën për seksin përmes procedurave që përbëjnë nyjën pushtet-dije (pouvoir-savoir). Përmes rrëfimit, krishterimi aplikoi teknikën për të prodhuar të vërtetën për seksin. Kjo teknikë u zyrtarizua më 1215 në koncilin e Latranit. Besimtari duhet t'i rrefehet priftit në një atmosferë intime për aktet e ndaluara që ka bërë (psh: masturbimi...) Kjo praktikë e gërryerjes përbrenda të subjektivitetit për të ndriçuar qoftë edhe përmes rrëfimit të ëndrrave si shprehje e dëshirave të penguar, edhe skutat më të errëta të personalitetit të individit, ndikuan në individualizimin e tij. Ky vullnet për të njohur sekretet e subjektivitetit të individit drejtohej nën survejim të një institucioni të pushtetit – kishës. Në këtë mënyrë formohet boshti dije-pushtet. Pranimi ia lehtëson individit që të zbulojë brenda vetes ato barriera që e pengojnë të kuptojë dëshirat e tij. Pranimi e çliron individin, sepse ai e ndjen veten të shkarkuar nga barra e mëkatit dhe fajit. Ndërkaq në psikiatri dhe në psikoanalizë, pranimi i individit nuk është i përqëndruar më në temat e mëkatit dhe shpëtimit, vdekjes dhe përjetësisë, por përmes një diskursi shkencor ai flet për turpin dhe për dëshirat e tij të jetës. Për Fukon pranimi është bërë në botën perendimore njëra nga teknikat më të vlefshme për ta prodhuar të vërtetën në përgjithësi. Teoria e Fukos sqaron evolucionin e përfytyrimeve dhe të praktikave seksuale në qytetërimin perëndimor.



▶ Inis Gjoni.

## Dy dëmtuesit e mëdhenj

# DUHANI DHE ALKOOLI, DY VRASËS TË NGADALSHËM

**Ndërkohë, askush nuk ka vullnetin për të ndërmarrë diçka në drejtim të parandalimit të kësaj "murtaje". Përkundrazi, duhani ekspozohet nëpër sheshet e qyteteve tona në pano të mëdha dhe askush nuk i ndalon.**

### Fatos SHALA

**D**erisa në vendet e qytetëruara të botës miratohen ligje kundër duhanit, në Kosovë një ligj i tillë tash e një kohë të gjatë qëndron në sirtarët e Qeverisë, dhe nuk aplikohet. Duhani është bërë pjesëtar pothuajse i përhershëm dhe i pranishëm, një shok i keq, i bezdisshëm, por mbi të gjitha, i rrezikshëm i jetëve tona. Jo rrallë ndodhë që njerëzit ta fillojnë ditën me kafe, cigare dhe me një teke apo depo pijesh alkoolike. Njerëz të punësuar apo jo, të vjetër ose të rinj mbushin lokalet, kurse duhani është shoqëruesi i përhershëm i tyre, dhe në të shumtën e rasteve edhe alkooli ku pija e preferuar është sipas fuqisë së gjejit, raki, konjak, kampari ose uiski. Dhe ç'është më e keqja, deri dje, këto dy veti kanë qenë përgjithësisht "pronë" e meshkujve, por që pas viteve të '90-ta përdorimi i duhanit dhe alkoolit filloi të rritej në mënyrë të frikshme sa sot në Kosovë, ashtu edhe në botë, statistikat flasin për një barazim të përdorimit midis dy gjinive. Duhani dhe alkooli pothuajse janë dy dëmtuesit më të mëdhenj të shëndetit të njeriut. Po t'i pyesësh njerëzit për dëmet që sjellin këto dy vese, në përgjithësi përgjigjen se i dinë dëmet, por prapë vazhdojnë të konsumojnë duhan dhe alkool.

### Bota bënë strategji, ne bëjmë sehir

Po ta bëjmë një listë të dëmeve që shkaktojnë këta dy faktorë, atëherë do të del një listë mjaft e gjatë. Duhani është përgjegjës kryesor për epideminë e kancerit të mushkërive, si te femrat, ashtu edhe te meshkujt dhe është vërtetuar se për çdo 10 cigare të pira rreziku për kancer pesëfishohet dhe për çdo 20 cigare rreziku pesëmbëdhjetëfishohet. Kryesisht, te pirësit e duhanit, moshë kur shfaqet simptoma e kancerit është 50-60 vjeçare. Duhani gjatë djegies liron lëndë që nga nikotina dhe monoksidi i karbonit dhe deri te katrani. Edhe alkooli është i dëmshëm për trupin e njeriut dhe është shkaktar i disa sëmundjeve në aparatit tretës, mëlçit, pankreas dhe deri në dëmtim të pa kthyeshëm të sistemit nervor qendror.

Sot bota aplikon lloj strategjish për të luftuar përdorimin e duhanit dhe alkoolit, shpenzojnë sasi të mëdha parash për reklama kundër tyre, nxjerr ligje për mospërdorim të duhanit në vende publike apo për mospërdorim të alkoolit para moshës 21 vjeçare, shënojnë ditën botërore kundër duhanit, apo organizojnë kurse kundër alkoolit etj. Por, megjithëkëtë, varësia ndaj duhanit dhe alkoolit vazhdon e rritet.

Por çka ndodh në vendin tonë? Duhani shitet në rrugë, para hundëve të fëmijëve, prindërit pinë duhan në prezencë të fëmijëve, madje u kërkojnë shërbimin e tyre, apo ua servojnë paketën e duhanit si lodër. Po ashtu fëmijët blejnë duhan për prindërit e tyre në shitore dhe kjo nuk ndalohet, po ashtu në shkolla mësuesit pinë para nxënësve, apo edhe vetë fëmijët janë konsumues të duhanit. Ndërkohë, askush nuk ka vullnetin për të ndërmarrë diçka në drejtim të parandalimit të kësaj "murtaje". Përkundrazi, duhani ekspozohet nëpër sheshet e qyteteve tona në pano të mëdha dhe askush nuk i ndalon.




**I thoni ndal, duhanti dhe alkoolit!**

Kampingu i të rinjve "PAQJA 2007"

# Vazhdimësi e angazhimit

Organizata studentore "Paqja Studentore" në vazhden e implementimit të projekteve të shumta dhe organizimit të aktiviteteve të ndryshme edukativo-arsimore, kulturore e sportive që kanë për qëllim zhvillimin dhe avancimin e jetës studentore morri iniciativën për organizimin e një kampingu veror të të rinjve.

**Sead UJKANI**

Javën e fundit të muajit që e lëmë pas përkatësisht më 21-24 korrik nën organizimin e organizatës studentore "Paqja Studentore" e UP-së në objektin e medresesë së mesme "Alaud-din" u mbajt kampingu veror i të rinjve pjesëmarrës të cilit ishin mese njëqind e pesëdhjetë (150) student të fakulteteve të ndryshme.

Organizata studentore, "Paqja Studentore" në vazhden e implementimit të projekteve të shumta dhe organizimit të aktiviteteve të ndryshme edukativo-arsimore, kulturore e sportive që kanë për qëllim zhvillimin dhe avancimin e jetës studentore respektivisht të studentëve, si iniciues dhe bartës të proceseve pozitive, elita intelektuale e të ardhmes së një vendi në veçanti dhe të

rinisë në përgjithësi, si pjesa më vitale e shoqërisë, mori iniciativën për organizimin e një kampingu të tillë me qëllim që studentëve pjesëmarrës t'u ofrohet diçka më interesante, qetësim e argëtim pas një viti akademik të lodhshëm si dhe largim sadopak nga rutina e përditshme e jetës.

Duke marrë parasysh gjendjen momentale të rinisë kosovare, në këtë kohë kur dukuritë negative e kanë kapluar dhe vërshuar atë, me theks të veçantë: prostitucioni, alkooli e droga në njërën anë, si dhe vetëvrasjet e shumta në anën tjetër, në këtë kohë kur humbja e kotë e kohës është bërë trend, argëtimi, ndërsa puna asgjë, organizimi i një kampingu të tillë e kishte rëndësinë e vet të veçantë.

E veçantë e këtij kampingu ishte, se ky organizim mori karakter kombëtar për faktin se pjesëmarrës të këtij kampingu ishin edhe studentët nga vatrat tjera shqiptare, nga Shkupi, Tetova, Mali i Zi dhe Presheva.

Programi i kampingu të sivjetmë i përpiluar nga Këshilli Organizativ i këtij aktiviteti (njëherësh edhe personat përgjegjës të kampingu) karakterizohej nga tri aspekte

kryesore:

1. Aspektin kulturor-edukativ të cilin e karakterizoj mbajtja e ligjëratave për aktualitet dhe atyre në drejtim të udhëzimit dhe potencimit të rëndësisë së studentëve si dhe organizimi i kuizit të diturisë për shtimin e njohurive të pjesëmarrësve.

2. Aspektin sportive të karakterizuar me organizimin e garave në tri disiplina sportive: futboll, basketboll si dhe volejbol.

3. Aspektin argëtues i cili përbehej nga pjesa e programit argëtuese e humoristike në mënyrë që studentët pjesëmarrës të zbavitën sa më shumë përgjatë rrjedhës së këtij kampingu.

Qëllimet e organizimit të një aktiviteti të tillë të cilat njëherësh edhe e iniciuan këtë aktivitet ishin:

a) Njohja dhe komunikimi i drejtpërdrejtë dhe i vazhdueshëm i studentëve pjesëmarrës duke ndikuar kështu në ngritjen dhe forcimin e marrëdhënies mes tyre.

b) Zbulimi i energjive të reja përkatësisht personaliteteve me ide të reja.

c) Forcimi i lidhjeve në mes të studentëve dhe udhëheqësve të punës studentore.

d) Qetësimi dhe argëtimi, zhvillimi i aftë-



▶ Pjesëmarrësit në kampingu "PAQJA 2007".

sive trupore duke forcuar trupin dhe stërvitur atë me anë të programit ditor sportiv etj.

Këtë kamping e nderuan me pjesëmarrjen e shumë mysafirëve, personalitete të njohura fetare e shoqërore si: Mr. Naim ef. Tërnavë – Kryetari i BI-së së Kosovës, Prof.dr. Milazim Krasniqi - profesor universitar dhe publicist, z. Ferid Bedrolli - sekretar i shoqatës së shqiptarëve në Amerikë, Ekrem Simnica – drejtor i medresesë së mesme “Alaudin” etj., të cilët përveç fjalëve përsëritëse për organizimin patën edhe ligjërimet e tyre për studentët pjesëmarrës me temë nga aktualiteti jonë shoqëror.

Në fjalimin e tij z. Gëzim Qerimi-kryetar i organizatës studentore “Paqja Studentore” prezantoi para pjesëmarrësve aktivitetet e shumta të kësaj organizate dhe objektivat e saj për të ardhmen. Duke folur për organizimin e sivjetmë z. Qerimi theksoi rëndësinë e organizimit të një aktiviteti të tillë për studentët në drejtim të avancimit të jetës studentore në veçanti dhe të rinisë në përgjithësi.

Nikoqirët e sivjetmë të kampingut z. Tërnavë dhe z. Simnica në fjalët e tyre përsëritëse për organizimin pjesëmarrësve u uruan qëndrim të këndshëm dhe të rehatshëm si në shtëpitë e tyre si dhe potencuan gatishmërinë e tyre për mbështetje dhe bashkëpunim edhe herëve tjera. Po ashtu Kryetari i BI-së z. Tërnavë, vlerësoi lartë organizimin e Paqes Studentore dhe

theksoj së vazhdimësia e një organizimi të tillë është e domosdoshme.

Ndër pjesët e programit të kampingut të sivjetmë që zgjuan interesimin më të madh të studentëve pjesëmarrës ishin ligjërimet e Prof. Dr. Milazim Krasniqit në temën mbi shtyrjen e radhës së statusit të Kosovës dhe opsionet mbi te, pastaj ligjëratat e Profesorit z. Adnan Berbatovci në temën mbi rëndësinë e të rinjve në shoqëri dhe rëndësinë e kërkimit të dijes. Ligjëratat e prof. Krasniqit i parapriu organizimit të debatit interaktiv në mes të studentëve dhe profesorit lidhur me çështjet aktuale nëpër të cilat po kalon vendi ynë.

Në adresën zyrtare të organizatës „PAQJA STUDENTORE „kanë arritur dhjetëra letra me përshtypjet me të mira që kanë kaluar pjesëmarrësit në këtë seminar të organizuar nga Paqja Studentore. Për lexuesit e Revistës „Paqja„, po e publikojmë një pjesë të letrës së njërit nga studentet pjesëmarrës të kampingut veror “PAQJA 2007” . .

**Të nderuar anëtar të kryesisë së organizatës studentore “Paqja Studentore”!**

**Njoftimi ynë me njëri-tjetrin për tri net radhazi në kampingun veror “Paqja 2007” e organizuar nga vetë ju si organizatë studentore , fitova përshtypjet më të mira të jetës time nga të gjithë studentët pjesëmarrës e veçmas nga organizatorët e shkëlqyeshëm. Më besoni nuk dua t’ju bëj qejfin asnjërit prej jush, vetëm se fillimi dhe**

**finalizimi i kampingut ka qenë i mrekullueshëm nga ju.**

**Ju përgëzoj edhe një herë për punën që keni bërë dhe po bëni. Të gjithë kampionët jemi bindur se jeni organizatë studentore me plotëkuptimin e fjalës, të bashkuar në çdo situatë dhe të gatshëm të jepni maksimumin. Është fakt, shumë domethënës që këtë organizatë studentore po e drejtojnë student të dalluar dhe kjo rezulton pa dyshim në një rezultat të shkëlqyeshëm. Jeni bërë shembulli më i mirë i organizimit mbi bazat e etikës, moralit, drejtësisë dhe modestisë për të gjitha organizatat tjera dhe për gjithë organizimin e shoqërisë sonë.**

Me shumë dashuri dhe respekt:

Rexhep Dajçi –nga Prizreni

Student në në Universitetin e Prishtinës

Në përfundim të kampingut të sivjetmë udhëheqësit e organizatës “Paqja Studentore” patën një takim me drejtorin e medresesë së mesme “Alaudin” z. Ekrem Simnica të cilin e informuan për mbarëvajtjen e kampingut si dhe e falënderuan për mbështetjen e dhënë. Z. Simnica nga ana e tij ritheksoi edhe njëherë gatishmërinë e tyre për bashkëpunim të mëtutjeshëm.

Në përgjithësi ky aktivitet tregoi edhe njëherë punën të cilën janë duke e bërë anëtarët e organizatës studentore “Paqja Studentore” në drejtim të ngritjes, organizimit dhe zhvillimit sa më të mirë të jetës studentore në Universitetin e Prishtinës në veçanti dhe të rinisë në vendit tonë në përgjithësi.



Gjatë mbajtjes së kuizit të diturisë.

Dukuri të dëmtuara

# PROSTITUCIONI EPIDEMI E KOHËS, APO AFËR "LEGALIZIMIT" ...?

**Historikisht, trojet shqiptare kanë ditur të përballen me sfida të natyrave të ndryshme, meqë shumë herë u ka rënë në hisë të bashkëjetojnë me kultura dhe civilizime të ndryshme mirëpo, marrë në përgjithësi çdo dukuri negative është kundërshtuar dhe nuk e kanë përvetësuar ata që kanë qenë të denjë në moralin dhe edukatën që kanë trashëguar dhe mësuar goftë nga bindjet fetare, apo edhe kodifikimet kanonike.**

**Emine A. VEZAJ**

**P**avarësisht nga pabarazia në të drejtat e grave shqiptare, kundrejt burrave, apo pavarësisht padrejtësisve në trajtimin e tyre, pavarësisht nga paja, prika apo shpërblimet në rast martesash etj., gruaja (myslimane) shqiptare kurrë nuk është konsideruar si mall që mund të shitet e rishitet apo blihet e riblihet. Pra, trafikimi për qëllim prostitucionin "nuk ka histori", të paktën ai nuk është kurrsesi një fenomen tipik shqiptar. Nuk rezulton që ky fenomen të ketë pasur përhapje të krahëshme me shumë vende të tjera evropiane, siç është Greqia apo Italia fqinje, vende të tjera mesdhetare, Anglia etj., në të cilat prostitucioni dhe trafikimi i femrave ka lulëzuar në çdo fazë të qytetërimit të tyre. Trafikimi nuk përmendet në librat mbi historinë e Shqipërisë, në të drejtën zakonore shqiptare, në libra kronikash, gjeografësh, albanologësh, në folklorin shqiptar etj. Ky "përrjashim" lidhet me puritanizmin (lat. puritanism fr. puritanisme: lëvizje fetare politike angleze në shek. XVI-XVII që kishte si qëllim kryesor pastrimin e kishës anglikane nga ritet e ceremonitë e kishës katolike...), dhe përgjithësisht, me jetën tradicionale të institucionalizuar të shqiptarëve, një jetë të mbyllur, "në mbrojtje" (dhe në kuptim ushtarak të fjalës) në një familje të mbyllur, patriarkale, në të cilën gjithçka, përfshirë edhe jetën seksuale të pjesëtarëve të saj, ishte rreptësisht e koduar dhe e kontrolluar. Pohimi se trafikimi "nuk ka histori" duhet kuptuar si një fakt: Shqipëria, përgjithësisht, nuk ka prodhuar të tilla dukuri "së brendshmi". Por, megjithatë, historikisht nuk ka qenë një vend i izoluar. Përkundrazi ajo ka qenë në udhëkryqet historike e gjeografike apo në udhëkryq të interesave të fuqive ushtarake të kohëve të ndryshme dhe është "popullur" nga pushtues të kulturave të ndryshme... Prostitucioni është, pra një ndër dukurit më të dhimbshme e më tragjike të tranzicionit shqiptar, madje jo vetëm shqiptar. Por, ai është më i përfolur se i studiuar. Studimet empirike për prostitucionin mungojnë. Për më tepër, në Shqipëri prostitucioni është parë njëanshmërisht. Ai është identifikuar me dhunën dhe, nga ky këndvështrim, duket sikur shkakua i parë dhe i fundit i prostitucionit janë rëmbyesit, trafikantët, dhunuesit, deri vrasësit e femrave, të cilët gjithnjë janë vënë në rol in e viktimës.

## Fillet e prostitucionit ndër shqiptar, Shqipëri - Kosovë

Fenomeni i prostitucionit në shoqëri-në shqiptare, para dhe pas formimit të

shtetit kombëtar, nuk është bërë objekt trajtimi nga studiues dhe, si pasojë, fondi i studimeve për këtë temë është thuajse i zbrazët. Në mungesë të burimeve të mirëfillta, si burim informimi mbeten dokumentet zyrtare. Dokumentet e Arkivit të Shtetit dëshmojnë se në Shqipëri, prostitucioni i mirëfilltë, por ilegal, u shfaq në fund të dhjetëvjeçarit të parë të shekullit XX. Ai u shfaq duke filluar nga viti 1910, në qytetin e Shkodrës dhe, sidomos pas vitit 1920, në të gjitha qytete e mëdha të vendit. Edhe reagimi i parë zyrtar rreth këtij fenomeni përkon thuajse me fillimin e vetë shtetit shqiptar. Për disiplinimin e prostitucionit, shteti vendosi pa ndonjë hezitim të madh legalizimin. Ai fillimisht huazoi rregulloren e prostitucionit të Sarajevës. Më pas vijuan një varg analizash, të bazuara mbi raporte komisionesh të posaçme mbi prostitucionin, në organet vendore të Korçës, Durrësit, Elbasanit etj. Prej tyre u arrit në vendimet për të parat shtëpi publike në Shqipëri. Këto trajtesa lokale u pasuan nga rregullorja e re e prostitucionit, miratuar nga Këshilli i Ministrave, me vendim nr. 196, datë 10 shkurt 1922. pas miratimit në Parlament, kjo rregullore u shëndrrua në ligj. Në bazë të kësaj rregullore të aprovuar nga Parlamenti i atëhershëm Shqiptar, ky "biznes" është ligjësuar, dhe de facto dhe de juro, nuk mund të ndërhynte askush në zhdukjen e kësaj dukuri ç'moralizuese të popullatës shqiptare në tërësi. Edhe përmes dokumenteve të marra nga Arkivi i Shtetit Shqiptar, dëshmohet se prostitucioni profesionist ka ekzistuar ndër shqiptar edhe para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në një letër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë drejtuar Mëkëmbësish Mbretërore të Përgjithshme (9 janar 1942), thuhet se shtëpia publike e vendosur në Vlorë, në rrugën "Viktorio Emanuel", nr. 40, "rezulton e hapur që prej vitit 1919". Por ushtrimi i prostitucionit është vërtetuar në një hotel në Shkodër, qysh në vitin 1910. Sipas këtij dokumenti, mund të themi se zyrtarisht prostitucioni në Shqipëri është njohur edhe para njohjes së Shtetit Shqiptar si shtet të pavarur. Fakte sikurse këto provojnë ekzistencën edhe në Shqipëri të ushtrimit të prostitucionit nga gra e vajza profesioniste apo të tjerë që e ushtrojnë atë "partë time" krahas atyre që kanë hyrë në tregun e mistershëm të prostitucionit të vendeve të tjera. Pas viteve 1990, prostitucioni është favorizuar nga papunësia dhe, përgjithësisht, nga gjendja e vështirë ekonomike, si dhe etja e shfrenuar për para e fitim. Nga anketimet e kryera del se opinioni publik shqiptar është në masën 67.7% dakord me mendimin se varfëria është një ndër shkaqet e trafikimit të femrave dhe ushtrimit të prostitucionit.

Ndryshe nga shumica e vendeve të tjera, në Shqipëri, deri në vitet '90-t prostitucioni, sikurse droga, homoseksualizmi etj., nuk njihet si fenomen. Ky "përrjashim" lidhet, së pari, me jetën tradicionale shqiptare dhe të drejtën dokesore dhe, së dyti, me faktin se regjimi i hekurit komunist nuk lejoi përhapjen e tij. Këtu duhet shtuar ndoshta faktorin më relevant dhe më mbizotërues në këtë drejtim, fenë islame, e cila ka qenë, është dhe do të jetë mbrojtje më efektive krahas çdo institucioni edukativ arsimor.

Sa i përket Kosovës pjesë e këtij biznesi, nuk posedojë ndonjë dokument zyrtar se kur ka filluar ky zanat në Kosovë mirëpo, në fakt, për hir të së vërtetës duhet të behem reale dhe të pranoj, se atë që nuk posedojë unë nuk mund të them se nuk ekziston, së paku kështu është realiteti. Në Kosovë është folur e përfolura për këtë zanat si para luftës së fundit, ashtu edhe pas luftës së fundit, gjithandëj Kosovës janë organizuar seminare e tubime informative për këtë epidemi mirëpo, se nga kur rezulton kjo, nuk posedojë ndonjë dokument zyrtar i cili do të argumenton më bindshëm këtë "biznes" në Kosovë. "Në Kosovë ka prostitucion dhe ka edhe klientë", u tha me plot gojë nga aktivistë ndërkombehtarë e vendorë për të drejtat e njeriut. Qindra e ndoshta me mijëra vajza të reja po kalojnë në Kosovë kalvarin e "zanatit më të vjetër në botë". Moshë mesatare e tyre, sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM), është 23 vjet, ndërsa rrugëtimi i pjesës dërmuese të tyre është i ngjashëm me të gjitha rrugëtimet e shoqevë të tyre nëpër botë, vetëm se në Ballkan duket që shkalla e "egërsisë" së bosëve e makrovë është më e madhe. Policia e Kosovës, që drejtohet nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, ka zbuluar disa shtëpi publike nëpër qendra të ndryshme të Kosovës. Janë arrestuar, disa dhjetëra persona, ndërsa mbi 100 femra janë riatdhesuar me ndihmën e IOM-it. Pjesa më e madhe e tyre vjen nga vendet e varfra të ish bllokut socialist, ndërsa rrëfimet janë të ngjashme. Shumë prej tyre që janë kontrabanduar në Kosovë nuk kanë pasur as idenë më të përafërt se do të detyrohen ta ushtrojnë prostitucionin. Ato janë nisor pas premtimeve se do të gjejnë punë në Kosovë, sigurisht të mashtruara nga prania e madhe ndërkombehtarë. Migrimi, që shënon edhe fillimin e ferrit të jetës së tyre, sipas studimeve të IOM-it, nxitet nga luftërat dhe shkatërrimet ekologjike, por më së shumti nga kushtet e rënda ekonomike. Femrat që arrijnë në Kosovë më së shumti "rekrutohen" nga Moldavia, Ukraina, Rumania e Bullgaria. Disa syresh prapa vetes lënë edhe familjet dhe fëmijët e tyre. Tashmë në Kosovë më pothuajse nuk konsiderohen lajme rastet kur policia

ndërhyjnë në lokale të ndryshme dhe gjen se janë punkte të prostitucionit. Është indikativë gjithësesi që rastet më të shpeshta, policia i gjen në qytete tradicionale si Prizreni, Prishtina e Gjiçani. Por, Kosova nuk është e vetmuar në këtë shtëmti. Sipas një raporti më të fundit të Stejt departamentit, Shqipëria vazhdon të jetë vend ku "problem mbetet puna e fëmijëve të mitur, trafikimi i tyre dhe i cilat nuk janë të mbrojtura". Po ashtu, muajt e fundit është raportuar shumë shpesh për punkte të shumta të prostitucionit në Maqedoni, veçmas në zonat e banuara me shqiptarë, ku kanë ndodhur edhe raste të vrasjeve të disa prostitutave. Analist të ndryshëm kanë mblledh fakte rreth kësaj dukurie në Kosovën e pas luftës. Sipas një studimi të nxjerr nga Raufet Xavier & Quere Stefane në studimin e tyre "Mafia shqiptare një rrezik për Evropën" rreth prostitucionit në Kosovë kanë nxjerrur këtë përfundim, "Edhe prania e KFOR-it dhe UNMIK-ut në Kosovë, sipas tyre, vetëm e fuqizon mafian, pikërisht se kjo prani ka ndikuar në ngritjen e shkallës së prostitucionit, pra të nivelit të të ardhurave të mafiozve shqiptarë. Madje sipas tyre Raufet & Quere misioni i tyre në Kosovë është i paracaktuar të dështojë jo vetëm se në të ka përzierje kombësisht, një mandat i paqartë dhe kontradiktor, burime të ndryshme autoriteti, shpesh konfliktual, por ushtarakët e KFOR-it u thonë (pikërisht në shtat), prostitutave (pra mafiozeve), të fshehta të rrezikshme. Pra, drejtpërdrejt apo tërthorazi, këta autor të paskrupullt i thonë botës se prostitucionit dhe droga (dy gjymtyrët e mafias shqiptare), duhet të jenë kritere bazë për të vendosur për integrimin e Shqipërisë apo statusin e Kosovës.

## "Legalizimi" i prostitucionit

Meqë prostitucionit konsiderohet një ndër dukurit më të dhimbshme dhe më tragjike të tranzicionit shqiptar, tani a duhet "legalizuar" apo luftuar këtë epidemi që është duke shkatërruar më mija familje të cilat prej kohësh gëzonin një harmoni familjare të rregulluar jetën shoqërore me kritereve të dispozitave të fesë, dhe kritereve kanonike në të cilat prejka e moralit përcillej me shkurorëzim e menjëhershëm të gruas. Në vende të caktuara evropiane, legalizimi i prostitucionit u bë si rrjedhojë së pari i mospasjes së këtyre qeverive të një sfondi religjioz, pra duke qenë qeveri më tepër ateisto-sekulariste dhe, së dyti duke kërkuar të kontrollonin një fenomen që për ato kishte marrë përmasa shqetësuese. Nëse në Shqipëri - Kosovë nuk mundet të përcaktojmë qartë se çfarë janë qeveritë tona, ateisto - sekulariste apo religjioze, duke parë qëndrimet dhe prononcimet shpeshherë ekstra religjioze të krerëve të shtetit në favor të një besimi siç është ai kristian, mund të konkludojmë se një legalizim tillë do të pritej, ngase ne posedojmë identitet evropian dhe si mënyrë të vetme të integritetit ton në familjen e madhe evropiane një fenomen i tillë, do të jetë i mirëseardhur dhe jemi "pro" kësaj dukurie. Me çka do të favorizonim këtë biznes. Nëse me herët ka pasur raste sporadike të këtij fenomeni, legalizimi do ta shëndronte në një biznes duke krijuar edhe precedentin e përhapjes së tij. Legalizimi i prostitucionit prish kodin dhe etikën morale

shoqërore e cila e ka konsideruar dhe vazhdon ta konsiderojë prostitucionin si vepër të shëmtuar. Legalizimi i tij përbën edhe precedentin për brezat e ardhshëm që dalëngadalë të humbin kuptimin e të moralshmes.

Një "Jo" e fuqishme duhet të burojë nga shoqëria jonë, si për të treguar se ka shpresë për vazhdimësi vlerash, se ka garanci për brezat, për të treguar se me të vërtetë nuk e kemi humbur fare toruan dhe se dimë ta ndajmë vetveten nga e keqja. Mirë do të ishte kjo, sikur ne të vetëdijeshoheshim me kohë mirëpo, ende nuk është diskutuar mirfillë kjo dukuri ngase si ne në Kosovë, po ashtu edhe fqinjët tanë shqiptar, nuk i kushtojnë vëmendjen që meriton, kjo për faktin se prostitucionit, për krerët tanë qeveritar nuk është i "pranishëm" dhe "shqetësues", por ne kemi "halle shumë më të mëdha" dhe kjo nuk meriton një vëmendje të tillë. Ndërsa atë që dëgjojmë çdo ditë në lajme, prostitucionit dita ditës është duke "lulëzuar" në çdo qytet. Arsyet se pse prostitucionit nuk duhet të legalizohet dhe të konsiderohet si "normal" radhitet si vijon; shkatërron dinjitetin e femrës, komercializon qeniet e gjalla, zgjeron rrugët e imoralitetit dhe legalizon shtëpitë publike. Historikisht, trëjet shqiptare kanë ditur të përballen me sfida të natyrave të ndryshme, meqë shumë herë u ka rënë në hise të bashkëjetojnë me kultura dhe civilizime të ndryshme mirëpo, marrë në përgjithësi çdo dukuri negative është kundërshtuar dhe nuk e kanë përvetësuar ata që kanë qenë të denjë në moralin dhe edukatën që kanë trashëguar dhe mësuar goftë nga bindjet fetare, apo edhe kodifikimet kanonike. Raste të tilla kemi edhe nga e kaluara, por edhe sot, ku kjo dukuri fuqishëm kundërshtohet nga masa e gjerë. Sipas një studimi që ka bërë Lekë Sokoli në librin e tij "Analiza Sociologjike", sjellë fakte në të cilat kjo dukuri është kundërshtuar në mënyra të ndryshme. Citojmë: "Në shkurt 1922, në Shkodër ishte vendosur që të ngrihej një shtëpi publike. Por banorët e të gjitha lagjeve të qytetit protestuan për ta patur atë sa më larg vetes. Në janar 1942, drejtori i shkollës ekonomike të Vlorës kërkonte që të mbyllej shtëpia publike në rrugën "Benito Musolini", sepse vajzat që mësonin në atë shkollë duhej të kalonin çdo ditë përpara shtëpisë publike, duke u gjendur në situata të pahijshme. Në dhjetor 1928, 29 burra nga fshati Kashovicë, Gjirokastër, i shkruajnë një letër ministrit të shtetit shqiptar në Athinë, me lutjen që të dëbohej nga fshati i tyre një grua e ve me origjinë izraelite, ish gruaja e një bashkëfshatari të tyre, që prostituonte në shtëpinë e saj, duke rrezikuar siç shkruhej shprehimisht; nderin dhe namuzin e familjeve tona në Shqipëri. Ngjashëm me këtë reagim kemi edhe atë të kohëve të fundit në Kosovë. Në komentet e bëra nga Dr. Milazim Krasniqi thuhet se



Prostitucionit, dukuri tragjike. ◀

"banorët e lagjes Sadik Tafarshkiu në Ferizaj, me anën e një vetorganizimi, kanë mbyllur dhjetë kafeteri, për të cilat thonë se janë vende ku ushtrohet prostitucionit, me çka e kanë rihapur temën alarmante të trafikimit të qenieve njerëzore, e cila më të shumtën mbahet e fshehur nën rrogëz. Deklaratat e disa banorëve të kësaj lagjeje në televizionin publik të Kosovës, zbulojnë se ata kanë kërkuar nga organet e rendit që të intervenojnë, por ato nuk u janë përgjigjur në mënyrë adekuate alarmimeve të tyre. Kur janë shterur shpresat se do të intervenojë policia, ata kanë intervenuar vetë, duke i dëbuar shtetasit e huaja, që punonin në ato kafeteri si kameriere. Në një reagim të një zyrtari të komunës së Ferizajt, nuk demantohej ekzistimi i shtëpive publike të maskuara si kafeteri, por shprehej mospajtimi me mënyrën e reagimit të banorëve, duke i akuzuar ata se nuk kanë kërkuar intervenimin e organeve kompetente. Në Kosovë ka ekzistuar vetëm ligji që ndalonte prostitucionin, ndërsa tani nuk ekziston asnjë rregullorë që do ta legjitimonte apo ndalonte atë. Pa mbulesë ligjore, "bosët" e organizuajtë rrjetin e prostitucionit nëpër të ashtuquajturat "klube nate" e "bare" të ndryshme, ku në skenë paraqiten "valltarët profesioniste", të cilat mund t'ju shoqërojnë gjatë mbrëmjes nëse për këtë jeni të gatshëm të paguani (natyrisht, paratë i shkojnë bossit). Ushtrimi i "fshehtë" i këtij zanati krijon kushte "ideale" për shfrytëzimin maksimal të femrave të pambrojtura nga ligji. Torturat dhe rrahjet sistematike, si dhe përdhunimet, janë format e egra të "trajtitimit" të femrave, të cilat nuk guxojnë as të mendojnë për ikjen apo denoncimin e "pronarëve" të tyre. Thjesht, ato janë sklave që shiten herë të njëri e herë te pronari tjetër, në një shumë të madhe, varësisht nga mosha dhe gjendja e tyre fizike. Njëkohësisht, ato janë pa kurrfarë mbrojtjeje e përkujdes mjekësor, ashtu si edhe klientët e tyre.

Përgjatë historisë prostitucionit, ka përfshirë të gjitha shoqëritë dhe të gjitha civilizimet, edhe megjithëse si nga Bibla ashtu edhe Kurani kjo dukuri është cilësuar si më e ndyra, edhe me gjithë pasojat e pafundme për individin dhe shoqëritë ajo prapë se prapë vazhdon edhe sot të "konsumohet" nga njerëzit e pandërgjegjshëm. Feja islame shkon në ekstrem, ku në një hadith (thënie profetike) Pejgamberi a.s thotë: "Ai që bënë zina (prostitucion), nuk mund të jetë besimtar i vërtet derisa e bënë atë".

Prostitucionit përfaqëson një problem të cilin as shtetet perëndimore, megjithëse kanë krijuar institucione të qëndrueshme, nuk kanë mundur ta mposhtin. Po shoqërive shqiptare dhe ballkanike, me institucione të pakonsoliduara, me kriza të rënda ekonomike, ç'u mbetet të bëjnë? Para se gjithash një kuadër ligjor më rigoroz që do të shkurajonte kriminelët. Së dyti, një bashkërendim institucional i këtyre vendeve dhe i vendeve të tjera të rajonit në luftën kundër prostitucionit. Së treti, duket se është i domosdoshëm një proces i shpejtë dhe shumëplanësh i ringritjes morale të njerëzve.

Përfundimisht, uroj që ky shkrim të rris ndjeshmërinë e të rinjve në veçanti të vajzave, pa harruar edhe familjarët, zyrtarët, policët, prokurorët, tutorët, gjykatësit, politikanët dhe gjithë opinionin e gjerë. Duke arsyetuar shmagjien nga kjo dukuri me vet faktin se kjo është e ndaluar nga Krijuesi i çdo gjëje të gjallë; Allahu xh.sh, i cili ka paraparë për secilën krijesë elementet e të dobishmes dhe të dëmshmes.

Teoria e dështuar e evolucionit

# JETA, SI ERDHI AJO KËTU? Me evolucion apo me krijim?

Mundësia që çdo gjë të krijohet rastësisht qysh në orvatjen e parë është 1 në 3.628.800, pra të thuash se shkrimtari mundi t'i rendiste ngjarjet e para të ndodhura në renditjen e duhur, pa i marrë faktet nga dikush, do të thotë të mos jesh realist.

Fatos TURKAJ

**J**eta gjendet kudo përreth nesh. Ajo shfaqet në zukatjen e insekteve, në këngën e zogjve, në gumëzhimën e gjallesave të vogla nëpër barishtet. Ajo ekziston në zonat e akullta polare dhe në shkretëtirat përvëluese.

Ajo është e pranishme që nga sipërfaqja e ndriçuar e detit e deri në thellësitë e errëta të tij. Lart në atmosferë, krijesa shumë të vogla lundrojnë rreth e përqark.

Toka është e mbuluar me jetë në forma kaq të ndryshme e në numër kaq të madh, sa ta tronditë imagjinatën. Si filloj e gjithë


kjo? Planeti ynë dhe gjithë banorët në të, si ndodhën këtu? Dhe me tej, si filloi jeta njerëzore? A evoluoi ajo nga kafshët si majmunë?

Apo është krijuar? Vërtetë, si erdhëm ne këtu? Dhe ç'kuptim përmban përgjigja e kësaj pyetjeje në lidhje me të ardhmen? Pyetje të tilla janë bërë prej kohësh dhe akoma nuk kanë gjetur përgjigje në mendjet e shumë njerëzve, përveç në Libra qiellore. Duke konsideruar pyetjet që lidhen me origjinën e jetës, opinionet apo ndjenjat e njerëzve të thjeshtë janë shumë të lëkundura e të ndryshme. Që të shmanget kjo dhe që të arrihen konkluzione të sakta, duhet të shqyrtojmë pa paragjykim faktet. Është interesante të vërehet gjithashtu, se edhe mbrojtësi më i njohur i evolucionit, Çarls Darvini, tregohet i vetëdijshëm për kufizimet e teorisë së tij. Në konkluzionin e librit të tij *"Prejardhja e llojeve"* ai shkruan për madhështinë e kësaj mënyre "të vështrimit të jetës, me një sërë forcash të saj që fillimisht iu dhanë nga Krijuesi disa formave ose një forme të vetme", duke vënë kështu në dukje qe tema e origjinës së jetës mbetet e hapur për shqyrtim të mëtejshëm.

Termi Evolucion që përdoret në këtë temë i referohet evolucionit organik, teorisë që organizmi i parë i gjallë u zhvillua nga materia inorganike. Më tej, thotë kjo teori, ndërsa ky organizëm riprodhohej, pësoi ndryshime qeniesh të gjalla, që më në fund dhanë të gjitha format e jetës që kanë ekzistuar ndonjëherë në Tokë, duke përfshirë edhe formën njerëzore. Dhe e gjithë kjo behet te jetë kryer pa një drejtim inteligjent apo ndërhyrje të mbinatyreshme. Ndërsa Librat e shenjta flasin të kundërtën.

## Evolucioni nën goditje

Fransis Hiçing, evolucionist dhe autor i



► Çarls Darvin

librit *“Qafa e Gjirafës”* ka thënë: **Mbasi u pranua në botë shkencore si principi i madh unifikues i biologjisë, tani, pas një shekulli e një çerek, darvinizmi ndodhet në një vështirësi të madhe të papritur.**

Paleontologu Nils Eldrixh, një evolucionist i shquar, ka thënë: Dyshimi që ekzistonte qysh herët, me gjithë sigurinë dhe vetëkënaqësinë e biologëve për evolucionin, këta njëzet vjetët e fundit i ka ftohur pasionet.

Mbi librin e Darvinit, *“Prejardhja e llojeve”*, një shkrimtar londinez i Times që pranon evolucionin shkroi: **Ne këtu kemi ironinë më të madhe, që një libër i cili ka fituar famë se shpjegon prejardhjen e llojeve, në fakt nuk bën asgjë për llojin.**

Edhe revista britanike *New Scientist* vërente se: Një numër gjithnjë e më i madh shkencëtarësh, më saktë një shumicë evolucionistësh sjellin prova se teoria evolucioniste e Darvinit nuk është vërtet shkencore, shumë prej kritikëve kanë një nivel intelektual nga më të lartët.

Astronomi Robert Xhestrou ka thënë: **Për zhgënjimin e tyre të thellë, shkencëtarët nuk kanë një përgjigje të saktë, sepse kimistët nuk kanë mundur kurrë të kenë sukses në përsëritjen e eksperimenteve të natyrës për krijim e jetës nga materia inorganike. Shkencëtarët nuk e dine se si ndodhi kjo. Ai ka shkruar: Shkencëtarët nuk kanë prova që të mohojnë se jeta është rezultat i një akti krijimi.**


Por vështirësitë nuk mbarojnë me origjinën

e jetës. Ta marrim në konsideratë një organ të trupit, si p.sh. syrin, veshin, trurin. Kushdo shtanget nga kompleksiteti i tyre që është jashtëzakonisht më i madh nga ai i pajisjes më të ndërlikuar që ka ndërtuar njeriu. Për evolucionin ka qenë problem fakti se pjesë të ndryshme të këtyre organeve duhet të punojnë të koordinuara së bashku, në mënyrë që të realizohet shikimi, dëgjimi apo të menduarit. Këto organe do të ishin të pavlefshme nëse të gjitha pjesët përbërëse të tyre nuk do të ishin të kompletuar. Këtë del pyetja: A mund të jetë një element i rastit, i pa drejtuar, forcë lëvizëse e evolucionit, që të këtë harmonizuar të gjitha këto pjesë në një të tërë, në kohën e duhur, për të realizuar një organizëm të tillë kaq të ndërlikuar?

Xhestrou ka thënë: **Duket se syri është projektuar dhe asnjë projektues teleskopësh nuk do ta kishte bërë dot më mirë.**

Astronomi Robert Xhestrou tha: **Është e vështirë të pranohet evoluimi i syrit të njeriut si produkt i rastit; është akoma më e vështirë të pranohet zhvillimi i inteligjencës njerëzore si produkt i ndarjeve të rastit në qeliza trunore të paraardhëseve tanë.**

Çandra Uikremasinge, profesor në University College në Kardif, thotë : **Nga edukimi im i hershëm si shkencëtarë, kisha bindjen e fortë se shkencën nuk mund të pajtohet me asnjë lloj krijimi të para mendshëm. Rrëzimi i këtij nocioni ka qenë shumë i dhimbshëm. Unë ndihem shumë keq në situatën kur e shikoj tani veten. Por, nuk**



**Robert Xhestrou**

**ka asnjë rrugë të logjikshme. Që jeta të ketë qenë një aksident kimik në tokë është sikur të kërkosh një kokrrizë të veçantë rëre në të gjitha plazhet e gjithë planetëve të universit dhe ta gesh. Më fjalë të tjera, është me të vërtetë e pamundur që jeta të ketë lindur nga një aksident kimik. Kështu, Uikremasinge përfundon: **Nuk ka asnjë rrugë tjetër me të cilën mund të kuptojmë radhitjen e saktë të lëndëve kimike të jetës, përveçse të pranojmë krijimin në një përmasë kozmike.****

Mundësia që çdo gjë të krijohet rastësisht qysh në orvatjen e pare është 1 në 3.628.800, pra të thuash se shkrimtari mundi t'i rendiste ngjarjet e para ndodhura në renditjen e duhur, pa i marrë faktet nga dikush, do të thotë të mos jesh realist.



**Evolucioni dhe realiteti, dy gjëra të kundërta!**

## Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

## DËSHTON KËSHILLI I SIGURIMIT...

## Demir RESHITI

**F**alë kundërshtimit këmbëngulës të Rusisë, kanë dështuar radhazi pesë projektrezoluta të paraqitura në Këshillin e Sigurimit të OKB-së nga ana e SHBA-së dhe vendeve të BE-së.

Të përballur me paralajmërimin e vetos ruse, vendet anëtare të Këshillit të Sigurimit kanë pezulluar bisedimet për Ko-



James Appathurai

sovën duke ia kaluar çështjen Grupit të Kontaktit, të përbërë nga SHBA-ja, Britania e Madhe, Gjermania, Italia, Franca dhe Rusi, i cili ka rënë dakord që të vazhdohej edhe për 120 ditë të tjera bisedimet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Këto bisedime, të parapara që të nisin në formë të së ashtuquajturës "diplomaci fluturuese", do të udhëhiqen nga treshja SHBA-BE-Rusi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t'i përfaqësojë ambasadori Frank Wisner, BE-në, diplomati gjerman Wolfgang Ischinger, ndërsa Rusinë, diplomati Aleksandar Kaharchenko.

Në vazhdim po e paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit korrik 2007.

**(1 korrik) Portugalia merr kryesimin e BE-së – Kosova prioritet**

**Lisbonë/Bruksel** - Portugalia nga 1 korriku e ka marrë kryesinë e radhës së Bashkimit Evropian. Zyrtarët e Portugalisë kanë kërkuar unitet nga Bashkimi Evro-

pian lidhur me Kosovën.

**(3 korrik) Ahtisaarit i përtërihet kontrata edhe për gjashtë muaj**

**Vjenë** - Të dërguarit të posaçëm të KB për Kosovën, Martti Ahtisaari, dhe zëvendësit të tij, Albert Rohan, iu është përtërirë kontrata edhe për gjashtë muaj të tjerë, deri në fund të vitit 2007.

**(4 korrik) Scheffer: Rusia dhe Serbia, të mos e refuzojnë rezolutën për Kosovën**

**Romë**, 4 korrik - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jaap De Hoop Scheffer, i ka bërë thirrje Rusisë dhe Serbisë, të heqin dorë nga rezistenca ndaj rezolutës për pavarësinë e Kosovës, që duhet të miratohet në OKB.

**(5 korrik) NATO mbetet në Kosovë edhe pa rezolutë të KS-së**

**Bruksel** - Zëdhënësi i NATO-s, James Appathurai, ka thënë se qëndrimi i NATO-



Karen Pierce

së për Kosovën është shumë i qartë, ajo përkrah planin e Ahtisaarit për zgjidhjen e statusit, por edhe pa ndonjë vendim nga Këshilli i Sigurimit, forcat e Aleancës do të mbeten këtu.

**(6 korrik) Barroso: BE-ja e mbështet opsionin pavarësi e mbikëqyrur për Kosovën**

**Bruksel** - Presidenti i Komisionit Evropian, Jose Manuel Barroso, ka thënë se Bashkimi Evropian e mbështet opsionin pavarësi e mbikëqyrur për Kosovën, ashtu siç është paraqitur në pakon të dërguarit

të posaçëm të OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari. Këto komente, diplomati Barroso i ka bërë gjatë takimit me presidentin e Serbisë, Boris Tadiq.

**(8 korrik) Wisner: SHBA-ja dhe BE-ja kanë konsensus për Kosovën**

**Uashington** - "Kosova do të jetë e pavarur dhe për këtë janë pajtuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian", ka deklaruar i dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për statusin e Kosovës, Frank Wisner.

**(9 korrik) Në Këshillin e Sigurimit është mbajtur seancë konsultimesh për Kosovën**

**Nju Jork** - Në Këshillin e Sigurimit është mbajtur seancë konsultimesh për Kosovën, ku kanë marrë pjesë edhe kryeministrotori i Kosovës, Joachim Ruecker dhe komandanti i KFOR-it, Roland Kather, të cilët kanë raportuar për situatën në Kosovë.

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Moon, ka bërë thirrje që Kosova të mos ndërmerr hapa të njëanshëm, derisa në OKB po vazhdon diskutimi për rezolutën për statusin e Kosovës.

**(10 korrik) Ban Ki Moon takon Solanën dhe Sejdiun**

**Bruksel**-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki Moon, ka biseduar në Bruksel për Kosovën me shefin e diplomacisë evropiane, Javier Solana, dhe kryetarin e Kosovës, Fatmir Sejdiu.

**(11 korrik) Sarkozy dhe Putin bisedojnë për Kosovën**

**Moskë** - Presidenti francez Nikolas Sarkozy, i ka telefonuar homologut të tij



Condoleezza Rice

rus Vladimir Putin, për një shkëmbim mendimesh lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, ka bërë të ditur zyra e

shtypit e Kremlinit.

**(12 korrik) Grupi i Kontaktit, pa Rusinë, ka diskutuar për Kosovën**

**Nju Jork** - Përfaqësuesit e vendeve anëtare të Grupit të Kontaktit kanë mbajtur në Nju Jork, konsultime për versionin e ri të rezolutës për statusin e Kosovës. Mësohet se në këtë takim të Grupit të Kontaktit, nuk ka marrë pjesë përfaqësuesi i Rusisë.

**(13 korrik) Anderson i zhgënjyer me shtyrjen...**

**Bruksel**- Përfaqësuesi i Grupit Ndërkombëtar të Krizave në Prishtinë, Alex Anderson, është shprehur i zhgënjyer me fuqitë perëndimore që kanë rënë dakord të shtyjnë edhe më tej vendimin për të ardhmen e Kosovës. Ai ka vlerësuar se vonesa mbart me vete rreziqe shtesë.

**(15 korrik) SHBA: Rusia të mos vërë veton për rezolutën e Kosovës**

**Uashington** -SHBA-ja i ka bërë thirrje Rusisë, të heqë dorë nga vënia e vetos gjatë votimit të rezolutës së re për Kosovën. "Përndryshe Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara nuk mund të luaj më rol në konfliktin e territorit të banuar në pjesën dërrmuese me shqiptarë", ka deklaruar ambasadori amerikan në OKB, Zalmay Khalilzad.

**(16 korrik) Këshilli i Sigurimit i OKB-së mban konsultime për Kosovën**

**Nju Jork**- Në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në Nju Jork, janë mbajtur konsultime të mbyllura lidhur me projektrezolutën më të re për Kosovën, të propozuar nga SHBA-ja, Britania e Madhe dhe Franca. Ndonëse propozuesit e kanë "zbutur" për të pestën herë draftrezolutën, me qëllim që ta bindin Rusinë për të mos e përdorur veton, as kësaj radhe nuk ia kanë arritur qëllimit.

**(17 korrik) Pierce kritikon Rusinë për përkrahjen që po i jep Beogradit**

**Nju Jork** - Zëvendësambasadorja britan-

votohet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

**(18 korrik) Shefat e diplomacive të vendeve të BE-së diskutojnë për Kosovën**

**Luksemburg** - Ministrat e Jashtëm evropianë kanë bërë thirrje për intensifikim të përpjekjeve në drejtim të miratimit shumë shpejt të një rezolute të OKB-së për statusin e Kosovës. Në një deklaratë miratuar njëzëri, 27 vendet anëtare kanë ripohuar se propozimet e të dërguarit të posaçëm të OKB-së, Martti Ahtisaari për një pavarësi të mbikëqyruar përbëjnë bazën e një zgjidhjeje me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të çështjes së Kosovës.

**(19 korrik) Rice: Pavarësi edhe pa Rusinë**

**Uashington** - Sekretarja amerikane e Shtetit, Condoleezza Rice është shprehur se Kosova do ta fitojë pavarësinë nga Serbia "në një mënyrë apo në një tjetër" pavarësisht kundërshtimeve të Rusisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

**(20 korrik) Përzulohen bisedimet për Kosovën në Këshillin e Sigurimit të OKB-së**



**Wolfgang Ischinger**

**Nju Jork** - Këshilli i Sigurimit ia ka kaluar drejtimin e procesit për zgjidhjen e statusit të Kosovës, Grupit të Kontaktit. Kjo është njoftuar nëpërmjet një deklaratë të përbashkët të vendeve sponsorizuese të projektrezolutës për Kosovën. "Na vjen keq, por ka qenë e pamundur të sigurojmë një rezolutë në Këshillin e Sigurimit. Në këto kushte ne ndalojmë diskutimet për rezolutën", ka deklaruar ambasadori francez në OKB, Jean Marc de la Sablierre.

**(22 korrik) Bullgaria kundër shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës**

**Sofje** - Ministri bullgar i Punëve të jashtë-

me, Iwajlo Kalfin, ka tërhequr vërejtjen se është kundër shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Ai i ka thënë radios shtetërore të Bullgarisë se shpallja e njëanshme e pavarësisë do të sillte tensione të reja në rajonin e Ballkanit.

**(23 korrik) Rice kërkon durim...**

**Uashington** - Sekretarja amerikane e Shtetit, Condoleezza Rice ka kërkuar nga udhëheqësit e Kosovës që të tregojnë durim në synimin e tyre për pavarësinë e Kosovës, pas pezullimit të rezolutës nga



**Aleksandar Kharchenko**

ana e OKB-së. Rice gjatë një takimi me anëtarët e "Ekipit të Unitetit" ka kërkuar nga ata që të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga negociatat intensive të periudhës shtesë prej 120 ditësh.

**(26 korrik) Polt: Kosova e pavarur, edhe pa pëlqimin e Rusisë**


**Beograd** - Shtetet e Bashkuara të Amerikës në koordinim me BE-në dhe me Rusinë, (nëse ajo këtë e dëshiron por edhe pa të), pas 120 ditësh të negociatave do ta gjejnë zgjidhjen për statusin e Kosovës, që do të jetë pavarësi e mbikëqyruar dhe e cila nuk do ta destabilizoj rajonin, ka deklaruar ambasadori amerikan në Serbi, Michael Polt, në një intervistë ekskluzive për agjencinë Beta.

**(27 korrik) Wisner-Ischinger-Kaharchenko do t'i udhëheqin bisedimet...**

**Uashington/Berlin/Moskë** - Diplomati gjerman Wolfgang Ischinger, do të jetë përfaqësues i BE-së në ekipin ndërmjetësues SHBA-BE-Rusi, në bisedimet e ardhshme për statusin e Kosovës.

Përfaqësuesi i SHBA-së në "treshen" ndërmjetësuese do të jetë diplomati Frank Wisner, i cili ka përfaqësuar SHBA-në edhe në ekipin e Ahtisaarit.

Ndërkaq, për përfaqësues të Moskës në "treshë", është caktuar diplomati rus, Aleksandar Kharchenko.



**Frank Wisner**

ike në OKB, Karen Pierce, ka kritikuar Moskën për shkak të përkrahjes që po i jep Beogradit në zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe ka vlerësuar se projektrezoluta e re për Kosovën së shpejti do të

Bukuritë e Stambollit

# STAMBOLLI, PORTË PËR TË HYRË NË AZI

Nëse Toka do të ishte një shtet i vetëm, Stambolli do të duhej të ishte kryeqyteti i saj. (NAPOLEON BONAPARTA)



Osman D. GASHI

**S**tambolli është qyteti më i famshëm në Turqi si dhe është qendër kulturore dhe financiare e saj. I njohur si në të kaluarën edhe në të tashmen, Stambolli në bazë të pozitës së tij strategjike duket se do të jetë i njohur edhe në të ardhmen. Stambolli apo Konstatinopoja si e ka pagëzuar themeluesi i saj ishte kryeqendër e dy perandorive të mëdha: Perandorisë Bizantine dhe Perandorisë Osmane. Konstatinopoja (greq. Konstantinopolis - "Qyteti i Konstantinit), u themelua nga grekët në vitin 660 p.e.s. me emrin Vizantion (shqip Bizanti), dhe e mbajti këtë emër deri në vitin 1930, vit në të cilin Ataturku kreu reforma kombëtare turke duke e quajtur Istanbul (Stambolli i sotëm).

Qyteti i përfshin 25 regjione të provincës së Stambollit.

## Emrat e Stambollit

Qyteti i Stambollit ka pasur shumë emra gjatë historisë varësisht nga kultura, gju-

ha dhe feja e sunduesve të këtij qyteti. Konstantinopojë, Bizantium, Stamboll dhe Carigrad janë disa shembuj që ende disa shtete e përdorin për emërtim të këtij qyteti. Po ashtu është quajtur edhe Roma e re ose Roma e dytë. Gjithashtu është quajtur edhe si "Qyteti i Shtatë Kodrave". Pjesa e vjetër e qyteti është ndërtuar nga Mbreti Konstantin në shtatë kodra për ti ngjarë 7 kodrave të Romës. Një emër tjetër i Stambollit është edhe Vasileousa Polis (Mbretëresha e qyteteve).

Gjurmët e para të njerëzve në Stamboll datojnë qysh prej 5500-3500 p.e.s. Vetëm pak mure dhe nënstruktura që i përkisnin kësaj kohe i kanë mbijetuar kohës afër Sarayburnu ku qëndron tani pallati i famshëm "Topkapı".

Stambolli ka qenë qendër e Perandorisë së Bizantit në të cilin ka sunduar mbreti Konstantin prej të cilit edhe qyteti është quajtur në emër të tij si "Qyteti i Konstantinit - Konstatinopolis", pastaj me 29 Maj 1453 Sulltan Mehmedi II ka hyrë në Stamboll pas një rrethimi 53 ditësh, dhe kështu që Stambolli u bë kryeqyteti i ri i Perandorisë Osmane. Është me rëndësi të ceket se Sulltan Mehmedi II pas hyrjes në Stamboll për të ripërtërirë qytetin ekonomikisht e formoi Pazarin e Madh dhe ftoi qytetarët ortodoks dhe katolik të Stambollit të kthehen në qytet dhe të jetojnë dhe të zhvillojnë jetën e



tyre. Robërit e luftës i liroi që të jetojnë në qytet pastaj urdhëroi guvernatorët e Rumelisë dhe Andadolisë që t'i kthejnë katër mijë familje që të vendosën në qytet, çfarë do qofshin ata Muslimanë, Krishterë ose Hebrenj, duke formuar kështu një shoqëri multireligjioze. Sulltan Mehmedi II financoi që qyteti të pasurohet me monumente arkitekturale, përfshirë këtu Pallatin Topkapı dhe Xhaminë Ejup Sulltan (Ku gjendet varri





**Pozita e Stambollit në Turqi** ◀

i shokut të Pejgamberit a.s. Ejub Ensariut). Gjithashtu në atë kohë janë ndërtuar shkolla, spitale dhe banjo publike.

Kur u formua Republika e Turqisë më 1923, kryeqyteti i vendit kaloi prej Stambollit në Ankara. Edhe pse kryeqyteti tashmë ishte në Ankara, Stambolli prej viteve të 1950-ta rezultoi me një ndryshim të madh strukturor, si rrugë dhe fabrika të reja, bulevarde dhe shëtitore të gjëra e moderne.

Sot, Stambolli është qyteti më i madh i vendit si dhe qendra financiare, kulturore dhe ekonomike e Turqisë.



**Lagja e Shqiptarëve** ◀

nxeha dhe rrallëherë me lagështi e me dimra të ftohtë e me shi e ndonjëherë edhe me borë.

### Biblioteka

Biblioteka e Universitetit të Stambollit ku një prej themeluesve ishte edhe shqiptari Hoxhë Tahsini.

### Maltepe

Në varrezat publike të Maltepe-së, në pjesën aziatike të Stambollit, prehet edhe



**Kulla e vajzës (Kiz kulesi)** ◀

pagëzuar edhe stacioni lokal i policisë dhe zyra e postës.

### Kiz Kulesi

Legjenda thotë që një Sulltan e ka pas një bijë të cilën e ka dashur shumë. Një ditë, një parashikues fati ka parashikuar që ajo do të vdes nga një kafshim i një gjarpri helmues në ditëlindjen e saj të 18-të. Sulltani, për të parandaluar këtë, urdhëroi që të ndërtohet një shtëpi larg tokës për vajzën e tij, për ta mbajtur atë larg ndonjë gjarpri. Kulla u ndërtua në mes të Bosforit dhe bija e dashur e Sulltanit banoi aty, dhe vizitohej vetëm nga babai i saj. Në ditëlindjen e 18-të, Sulltani i solli vajzës së saj një shportë me fruta ekzotike dhe të kushtueshëm si dhuratë ditëlindjeje, duke u gëzuar që ai po e ndalonte parashikimin. Mirëpo një nepërkë ishte e fshehur në gjethet e frutave, kështu që kur vajza afrohet të marrë fruta, nepërka e kafshon vajzën e Sulltanit dhe ajo vdes në duart e të atit të tij ashtu siç kishte parashikuar fallxhori. Ka edhe tregime të tjera për këtë kullë por ky thuhet që është më i sakti.

### Aja Sofia

Aja Sofia (Greq: Menquria e Shenjtë, Turq: Ayasofya) është ish bazilikë patriarkale, më vonë një xhami kurse tashti një muze. Në kohën e Bizantit ka qenë katedralja më e madhe dhe ka vazhduar të jetë më e madhja për mija vjet, deri sa është ndërtuar katedralja në Sevillë të Spanjës më 1520. Kisha është ndërtuar gjatë viteve 532 dhe 537 gjatë kohës së Perandorit Justinian. Në vitin 1453 ajo u shndërrua në xhami. Në vitin 1935 u shndërrua në muze nga Republika e Turqisë. Afër ndodhet Xhamia e Kaltër (Xhamia e Sultan Ahmetit).



**Biblioteka e Hoxhë Tahsinî** ◀

Stambolli zë vend në veri-perëndim të regjionit të Marmarasë. E përfshinë jugun e ngushticës së Bosforit (Boaz turqisht) gjë që e vendos qytetin në dy kontinente. Pjesa perëndimore e qytetit është në Europë, kurse ajo lindore është në Azi. Kufijtë e qytetit mbulojnë një sipërfaqe prej 1539 km<sup>2</sup> kurse si regjion Stambolli zë një sipërfaqe prej 6220 km<sup>2</sup>. Stambolli ka një klimë kontinentale me verëra të

Rexhep Mitrovica, një prej kryeministrave të fundit të Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

### Arnavutkoy

Tabela rrugore marasë tregon "Lagja e Shqiptarëve", emër me të cilin

buzë detit të Mardrejtimin për tek "iptarëve", aty është



**Varrezat e Maltepes** ◀



**Xhamia e Aja Sofisë** ◀

## Kulturë gjuhe

## TË FLASIM PAK SHQIP!...

Po t'i qëndronim besnik gjuhës sonë me të gjitha strukturat gramatikore dhe leksikore, aq sa i qëndrojmë gjuhëve të huaja, e në veçanti gjuhës serbosllave (meqë me të edhe jemi mishëruar), me siguri se gjuha jonë, jo vetëm se do të ishte një gjuhë e pastër kombëtare, e si të tillë do ta fliste çdo shqiptar, por do ta zhvillonte traditën e një gjuhe që do të lakohej në mesin e shumë gjuhëve që sot konsiderohen si mbretëresha.

## Ekrem A. KRYEZIU

Jo rrallëherë ndeshemi në struktura të gabuara ndërtimesh fjalish, periudhash, e madje edhe të konteksteve dhe teksteve në përgjithësi. Edhe pse në logjikën tonë sundon një bindje se këto ndërtime fjalish janë të pastra dhe të drejta, e madje dikush ndoshta edhe mburret me to, duke ia mveshur vetes epitelin e një njohësi të shkëlqyeshëm të gjuhës shqipe, ato jo vetëm se nuk janë të natyrës së shqipes së sotme, por e shthurin dhe e çoroditin edhe më gjuhën tonë. Të tillët, duke menduar së thonë shumë, s'thonë asgjë. Duke u paraqitur para të tjerëve si mbretër të gjuhës me lloj-lloj shprehjesh të "bukura" të paqarta (panjohura), që me siguri as vetë nuk ua dinë domethënien, edhe më vazhdojnë të ngjallin huti tek brezat e rinj që sapo kanë filluar ta njohin, flasin apo

studiojnë gjuhën e sotme shqipe.

Këto shprehje, jo vetëm se nuk e pasurojnë fjalorin e autorëve që i përdorin, por mbjellin edhe anomali tjera në gjuhë. Ndoshta në mesin e tyre mund ta thotë ndonjë fjalë të mençur, por ç'e do kur me fjalë të tjera e prish tërë strukturën e fjalisë. Kjo është sikur era që "shuan një zjarr dhe ndez shumë të tjerë".

Po t'i qëndronim besnik gjuhës sonë me të gjitha strukturat gramatikore dhe leksikore, aq sa i qëndrojmë gjuhëve të huaja, e në veçanti gjuhës serbosllave (meqë me të edhe jemi mishëruar), me siguri se gjuha jonë, jo vetëm se do të ishte një gjuhë e pastër kombëtare, e si të tillë do ta fliste çdo shqiptar, por do ta zhvillonte traditën e një gjuhe që do të lakohej në mesin e shumë gjuhëve që sot konsiderohen si mbretëresha.

Në këtë artikull do të trajtohet një nga kalimet sllave i cili vazhdon të jetë shumë i

(pa)njuhur në të folurit tonë të përditshëm (rrugë, familje, institucione), media (të shkruara, elektronike) madje edhe shumë i përdorur - vend e pa vend.

... përgjigjem në këtë pyetje... nga sllavishtja ...odgovoram na onu pitanje...


Edhe pse fjala përgjigjem (jap përgjigje) edhe në shqip shpesh ngatërrohet me fjalën përgjigjem (jap përgjegjësi), këtu do të trajtohet vetëm si kalk dhe jo si anomali brenda shqipes. Këtu nuk kemi të bëjmë me huazimin e njëres apo tjetres fjalë të kësaj strukture, por komplet fjalinë. Ngase huazuesi nuk është lodhur shumë të përshtatë në gjuhën shqipe, por ka shkuar sipas modelit "copy-paste", dhe gradualisht kjo strukturë është bërë e jona, ku edhe sot vazhdon të trajtohet si e jona.

Po ta analizojmë këtë strukturë fjalie, "... përgjigjem në këtë pyetje...", sigurisht se do të ngjallnim një huti dhe një pasiguri në vetvete se ç'kuptim në të vërtetë ka kjo

fjali. Lind pyetja, si mund të përgjigjemi në pyetje (meqë këtu përdoret parafjala e kallëzores 'në?!..') Këto dhe variante tjera sigurisht se do të zgjonin ngatërime dhe huti të panevojshme. Në shqip ne asnjëherë nuk mund përgjigjemi në pyetje, (kjo mund të ndodhë vetëm atëherë kur flasim sllavisht), në shqip, kujtoj se do të duhej të përdornim shprehje tjera që do të përputheshin plotësisht me natyrën e gjuhës shqipe normative.

P.sh. në vend se të themi "... ne u përgjigjem në pyetjen e profesorit...", ne pa ndonjë vështirësi do të mund të thoshim se "... ne iu përgjigjem pyetjes së profesorit..." apo "...ne i dhamë përgjigje pyetjes së profesorit (apo kujtdo qoftë tjetër)..."

Pra ne i përgjigjemi, apo i japim përgjigje pyetjes dhe asnjëherë nuk përgjigjemi në pyetje.



► Gjuha shqipe, prej gjuhëve më të vjetra.

## Dukuria e vetëvrasjes

# Për gjashtë muaj 33 të vetëvrasarë!

Llojet e vetëvrasjeve më të shpeshta në Kosovë janë: vetëvrasja si akt i mohimit dhe mospajtimit me gjendjen ekzistuese. Vetëvrasja si protestë ndaj gjendjes ekzistuese, vetëvrasjet si akt dëshmie ndaj një përkushtueshmërie të caktuar (në këtë rang bëjnë pjesë edhe vetëvrasjet për shkaqe dashurie), vetëvrasjet si akt i shprehjes së pamundësisë për arritjen e objektivave të caktuara dhe më së shpeshti ekonomia shtyn njeriun të bëjnë vetëvrasje.



Arber ZEKA

**R**rënqethëse, në një vend me sipërfaqe shumë të vogël, për gjashtë muaj, tridhjetë e tre të vetëvrasarë! Ishte ky raporti i Shërbimit Policor të Kosovës.

Komuna e Prishtinës kryeson me listën e rajoneve të Kosovës, gjashtë vetëvrasje dhe tridhjetë e shtatë raste të tjera që fatmirësisht përfunduan si tentim vetëvrasje. Rajonet e tjera, sikur Peja, shtatë vetëvrasje dhe shtatëmbëdhjetë tentim vetëvrasje. Nga Gjlani janë lajmëruar gjashtë vetëvrasje dhe dymbëdhjetë të tjera tentim vetëvrasje. Ferizaj, kishte tri vetëvrasje dhe tetë raste tentim vetëvrasje. Rajoni i Mitrovicës me tri vetëvrasje dhe dymbëdhjetë tentim vetëvrasje.

Shuma e përgjithshme e të vetëvrasarëve dhe tentim për t'u vetëvrasarë arrin në 139 raste vetëm për këto gjashtë muajt e fundit. Nëse krahasojmë me vitet e kaluara, kjo shifër është më e madhja. Nga rastet e lartpërmendura gjithsej janë tridhjetë e tre persona që janë vetëvrasarë dhe 106 të tjerë për fat të mirë kanë shpëtuar nga kjo vepër e shëmtuar.

Sipas statistikës së dhënë, del se numri i femrave është më i madh që përpiqen të vetëvriten, por fatmirësisht përpjekja tyre mbetet në tentim vetëvrasje sepse nuk arrijnë t'ia marrin jetën vetvetes për arsye të ndryshme. Ndërsa ajo e gjinisë mashkullore është më e vogël numri për tentim vetëvrasje por që rezulton me numrin më të madh që ia arrijnë të vetëvriten. Moshë për tentim për vetëvrasje mesatarisht është njëzet e pesë vjeç.

### Pse ndodhin vetëvrasjet, raste të depresionit apo ...?

Studimet e fundit, tregojnë fakte rrëqethëse për numrin e vetëvrasjeve,

fatkeqësisht ky numër deri tani është më i larti. Shpeshherë njeriu pyet pse ndodh kjo, por, nuk arrihet në përgjigjen e duhur. Sikur të kuptojmë brengën e tyre, më siguri do të gjendej edhe forma e evitimit. Kjo dukuri, duhet të hulumtohet shumë nga ekspertët e kësaj fushe dhe të ndihmohet popullata. Secili i vetëvrasarë me siguri ka përfunduar së gjykuari dhe atij i ka rezultuar se jeta për të më nuk ka kuptim, sepse çdo përpjekje tjetër për të do të ishte edhe më e vështirë.

Deri në ditët e sotme nuk është gjetur ndonjë faktor i cili shkakton këtë gjykim të shëmtuar. Me këtë vetëgjykim janë marrë shumë ekspert të fushave të ndryshme në vendet tjera por më kot, shkak-tari mbetet i panjohur.


Vetëvrasjet, e përcjellin njerëzimin që

nga paraqitja e tij në tokë. Ato kanë ndodhur edhe në oborre mbretërore dhe ndodhin edhe sot nëpër hierarki të larta politike apo shtetërore.

Ekzistojnë faktorë të ndryshëm të cilët mund ta nxisin këtë fenomen. Më i rëndësishmi është ai ekonomik.

Jeta e re moderne, ka kërkesa të shumta të cilat, një njeri i rëndomtë është shumë vështirë t'i arrij, prandaj edhe krijohet ndjenja e disfatës dhe mos dëshira për të luftuar më tutje.

Vetëvrasjet, kanë ndodhur edhe ndodhin, edhe në mesin e të varfërve, dhe në mesin e të pasurve. Ndodhin, siç kanë ndodhur në vazhdimësi, edhe te të dashuruarit dhe te ata që nuk ishin apo nuk janë të dashuruar. Dhe më gjithë shpjegimet (nga ana shkencore) të këtij



Vetëvrasja, një dukuri tragjike. ◀

fenomeni, megjithatë, akoma nuk është arritur zbrëthimi i tërësishëm dhe komplet, në kuptimin e shkaqeve që shpijnë deri në aktin makabër të vetëvrasjes.

Por, megjithatë, në shumë raste, vetëvrasjet janë pasqyra e socialitetit, ato tregojnë gjendjen ekonomike të një populli, shtetit, grupit etj.

Mirëpo vlen edhe kjo, se në Zvicër ka vetëvrasje të shumta të rinjtë. Pra, pse ndodh një gjë e tillë në shtetin Zvicrës? Kur dihen standardet ekonomike të cilat i ka.

Pra, shkak i një vetëvrasje s'është çdo herë te paratë, por ka edhe shumë faktorë të tjerë që mund të bëjnë një njeri të mendoj të i jap fund jetës.

Sidoqoftë faktorët janë të përditshëm, shumë herë kompleks dhe njerëzit që mendojnë në vetëvrasje duhet të jenë shumë ndjeshëm.

Shtetet si Suedia, Hungaria, Sllovenia, Vojvodina etj, janë shtete më nivelin më të lartë të jetesës dhe vetëvrasjeve njëkohësisht, por këtu, dukuria e vetëvrasjes nuk është e nuk lidhet më shkaqet si ato të Kosovës.

Llojet e vetëvrasjeve më të shpeshta në Kosovë janë: vetëvrasja si akt i mohimit dhe mospajtimit me gjendjen ekzistuese. Vetëvrasja si protestë ndaj gjendjes ekzistuese, vetëvrasjet si akt dëshmie ndaj një përkushtueshmërie të caktuar (në këtë rang bëjnë pjesë edhe vetëvrasjet për shkaqe dashurie), vetëvrasjet si akt i shprehjes së pamundësisë për arritjen e objektivave të caktuara dhe më së shpeshti i faktorit ekonomik e shtyn njeriun të bëj vetëvrasje.

Në kriminalistikë, vetëvrasësit janë kategorizuar si njerëzit më trima, sepse është më së vështiri është të ngritët dora mbi vetveten.

### Simptoma e një vetëvrasësi

Zakonisht, personi i cili dëshiron të bëj vetëvrasje, kalon një kohë të gjatë, duke menduar për të bërë vetëvrasje, duke u matur, të bëj apo të mos e bëjë, duke planifikuar: si, kur, dhe ku. Shumë më rëndësi është të dihen shenjat e këtij procesi, për të kërkuar dhe ofruar ndihmën.

Hulumtimet kanë treguar që rreth 80% te personave, të cilët e bëjnë vetëvrasjen, një kohë para vdekjes tregojnë këto simptoma:

**NDRYSHIMET TE PERSONI:** janë të pikëlluar, të mbyllur në vetveten, ndihen nervoz, të lodhur, të pa vendosur, pa vullnet, ndonjëherë të shqetësuar.

**NDRYSHIMET E SJELLJËVE:** s'munden të koncentrohen në punë, shkollë, obligimet e rëndomta.

**NDRYSHIMET TË TJERA:** nuk kanë oreks dhe dobësohen, ose tepër e konsumojnë ushqimin, humbin interesim për shoqërinë, seksin, hobin, humbja e dëshirës për aktivitetet në të cilat kanë gjetur kënaqësi më herët, mërzi të shumë për paratë, sëmundjet (të vërteta ose të paramenduara), frikohen nga humbja e kontrollit që do t'i lëndojnë tjerët ose vetveten, ndihen fajtor, vetëurrejtës, nuk kanë shpresë për ardhmëri, nder të tjera i kryejnë punët e veta, borxhet, përshëndeten më shokët, familjen, të afërmit, falin gjërat personale, të çmueshme, kanë ide vetëvrasëse, deklarata, plane, tentime të më hershme për vetëvrasje etj.



▶ Vetëvrasja, akt i ndjeshëm dhe i shëmtuar!

Muslimanët dhe shqiptarët

# Cili është diskursi i shqiptarëve?

**Çdo gjë që vjen nga Qielli për besim drejtit pranohet ashtu siç është, e për ata që hamendësohen dhe duan të jetojnë sipas kërkesave të miqve të tyre mund të gjejnë besime tjera, ku çdo gjë ndryshon nga dita në ditë.**

**Fitim FLUGAJ**

**P**ër popullin tonë flitet shumë dhe gjithçka lidhur me atë se a janë apo nuk janë mysliman të vërtetë, ose janë mysliman të evropianizuar.

Kjo është një temë e cila pak a shumë shtjellohet në meset e ndryshme të shoqërisë shqiptare por thënë qartë ende nuk është trajtuar sa duhet dhe nuk shihet racionalizëm dhe objektivitet i duhur në trajtimin e kësaj teme mjaft delikate, e sidomos kur marrim parasysh se ne jemi popull euforikë, përplot emocione dhe pa kurrfarë strategjie dhe për fat të keq edhe pa identitet të saktë e frikacak dhe mburraveçë të mëdhenj.

Dikur, kur shqiptari ende ishte analfabet, ishte i varfër materialisht por i pasur në shpirt dhe i dashur me të tjerët, ishte i njohur për moral sepse e shenjtëronte moralin dhe e donte atë mbi të gjitha.

Në disa artikuj publicistikë të gazetave tona ditore e javore hasim aty këtu të flitet për një islam të evropianizuar ose ndryshe thënë një islam të lokalizuar në aspekt të zbatimit dhe praktikimit të

tij në një stil të veçantë evropian. Diçka shumë të moderuar! Apo thënë troç një islam që i përshtatet jomuslimanëve dhe që largohet nga fundamenti dhe origjina e islamit të vërtetë. Rruga e devijimit... Njashtu siç ndodhi me dy fetë tjera, baza e të cilave ishte e pastër qiellore, por që fatkeqësisht morën trajtë dhe emër krejtësisht tjetër.

Kërkohet një islam i cili do të lejojë dukuri negative, të bëhet sikur nuk i sheh shoqëritë që janë të dirigjuara nga emocionet, epshet me një fjalë shoqëri pa kritere. Që është e degraduar në një shkallë më të ulët se sa kafsha. Kërkohet një islam i cili nuk ndërhyt në jetën e përditshme të njeriut, pa obligime ndaj Krijuesit apo që i përngjanë dy besimeve të sipër theksuara ku do të shkohej vetëm një herë në javë në faltore.

Por një gjë e tillë nuk mund të ndodhë. Islami është ashtu siç është, Hyjnor. Çdo gjë që vjen nga Qielli për besim drejtit pranohet ashtu siç është, e për ata që hamendësohen dhe duan të jetojnë sipas kërkesave të miqve të tyre mund të gjejnë besime tjera, ku çdo gjë ndryshon nga dita në ditë. Islami është jetë e kompl-

etuar me ligjet e tij, njashtu sikur jeta që zhvillohet në këtë botë në bazë të ligjeve që i ka vendosë Krijuesi në natyrë. A ka ndodhë ndonjë herë që njeriu, njëherë të vdes e pastaj të paraqitet si plak, e pastaj të rinohet dhe më në fund të bëhet fëmijë e të kthehet në spermë apo ujë të ngjizur. Jo. Assesi dhe as që mund të ndodhë. Islami është jeta, me ligje të përkryera dhe urdhra të Krijuesit të universit dhe nuk ka mundësi të ndryshojë. Sado që shkruhet dhe flitet për një islam të evropianizuar, pa shami e pa petk të përcaktuar në trupin e besimtares do të ishte e kotë, sepse ato gjëra i ka caktuar Krijuesi dhe jo njeriu. Abrogimi tyre, mund të vjen vetëm nga ai që i ka paracaktuar, e assesi njeriut.

Nuk do të veçoja ndonjë media, qoftë të shkruar apo elektronike, mirëpo thujtë në të gjitha mediat tona vërehet një frymë kundër islamit, qoftë me vetëdije ose pa vetëdije. Kjo frymë nuk i shërben demokracisë reale të cilën po e dëshirojmë dhe po kërkojmë që ta kemi në vendin tonë. Në demokracinë reale secili duhet ta pranojë njëri tjetrin ashtu siç është e jo siç ka dëshirë të jetë.



Islami nuk është vetëm në xhami, por edhe jashtë saj. ◀

Histori Islame

# Muhammedi s.a.v.s., lideri muslimanëve

**Megjithatë Muhammedi kërcënimet e mekasve i mori seriozisht dhe filloi të mos flinte qetë natën, nga ndonjë sulm befasues në shtëpinë e tij. Disa nga shokët e tij filluan të bëjnë roje dhe të kujdesen për shtëpinë e Pejgamberit s.a.v.s. Kështu vazhdoi derisa nuk u shpall ajeti, me të cilën Muhammedi i thotë se ishte nën mbrojtjen e drejtpërdrejtë të All-llahut xh.sh. Që prej momentit të zbritjes së këtij ajeti e deri në vdekjen e tij, ai s.a.v.s. nuk kishte truproje.**



**Muhamed Jusufi  
- KAJOLLI**

**N**atyrë e secilit njeri, kur të shpërngulet nga një vend në një vend tjetër si veprim fillestar për të është si të sigurojë ushqimin, pastaj vendbanimin e më pastaj, të mendojë për shoqërinë. I dërguari All-llahut nuk veproi sipas natyrës së rëndomtë njerëzore, ai nuk mendoj fare për këto dy veprimet fillestare. Ai, me të arritur në Jethrib lëvizjen e parë e bëri kur përcaktoi vendin se ku do të ndërtohet xhamia. Ky objekt fillimisht nuk ishte vetëm faktore, pas çdo namazi ai përdorej për evitimin e problemeve të qytetarëve, pra, konsiderohej edhe si Bashkia e qytetit. Ky objekt pas një kohe të shkurtër, themi se luajti rolin e Presidencës dhe të Qeverisë së shtetit islam. Shoqërisë së re i duhej një lider dhe, pa hamendje ajo bashkësi e zgjodhi Muhammedin si prijësin e tyre fetar e politik. Ai nuk kishte kohë për të humbur, para vetes kishte shumëçka për të bërë. Vendi kishte një pamje krejtësisht të re dhe atë e pritnin një duzinë rregulloresh e ligjesh të gjitha duhej të regjistroheshin me shkrim. Në Medinë, u pa, pamja e parë e shtetit të njerëzimit. Shpallja e Kur'anit në Medinë kishte ndërruar stilin e zbritjes, thujse të gjitha ajetet i dedikoheshin besimtarëve, e jo sikur ajetet e zbritura në Mekë që këshillonin njerëzimin. Ditë e më shumë besimtarët e vërenin se Kushtetuta po përpilohej. Njeriu, jeton jetën e vet të shkurtër prej një udhëtari dhe ai duhet të përgatitet për ahiret, prandaj nuk ka kohë për humbje. Atje, njeriu do t'i shijojë kënaqësitë e vërteta, prandaj Muhammedi s.a.v.s. menjëherë u mor me platformën e ummetit të islamit. Kjo platformë mund të themi është paraqitur derisa xhamia po ndërtohej. Xhamia përfundoi gjashtë muaj

pas hixhretit, ose gjatë prillit të vitit 623.

**Pikat referuese mund të përcaktohen si më poshtë vijon:**

**1. Bashkoi besimtarët musliman në një vëllazëri.** Nuk ka dallim midis arabit dhe jo arabit, përveç atyre që janë më të devotshëm dhe më të përkushtueshëm për të ndihmuar nevojtarët. Ky lloj bashkimi, vëllazërimi dhe liria e shprehjes nuk ishte njohur më herët në praktikën e asaj kohe. Pra, kemi të bëjmë me kohën kur njerëzit trajtoheshin në kasta të ndryshme, si skllevër dhe, të mos harrojmë, ishte koha e gladiatorëve etj.

**2. Formuloi Kartën e Medinës,** në të fillimisht u përfshinë besimtarët e fisit Evs, Hazrexh, Kurejsh, Çifutë dhe pakica të tjera. Këtë pikë e trajtuam gjerësisht në numrin e kaluar.

**3. Caktoi emrin e këtij ummeti-islam** (të bindurit paqësor), ndërsa pasuesit ose ithtarët e këtij ummeti u quajtën musliman (ithtarët e të bindurve paqësor). Me këtë emërtim varrosi të gjitha ekstremizmat nacionaliste, si dhe përdorimin e çfarëdo lloj dhune. Tani e tutje ua bëri të qartë popujve se pushteti nuk mbahet vetëm me anë të përdorimit të forcës fizike, por atij, i duhen ligje të shëndosha të cilat nuk e cenojnë askënd-të gjithë janë të barabartë tek All-llahu. Ummeti islam i përket njerëzimit, prandaj edhe thirrja ishte e karakterit ndërkombëtarë.

**4. Caktoi formën e flamurit të ummetit,** mbishkrimin me ngjyrë të zezë-La ilahe Il-lallah, Muhammedun Resulullah (Nuk ka hyjni tjetër përveç All-llahut, ndërsa Muhammedi është i Dërguari All-llahut) me sfond të bardhë.

**5. Ezani** - Menjëherë pas ndërtimit të xhamisë u caktua forma e thirrjes së besimtarëve për në xhami-ezani. Pesë herë në ditë besimtarët thirreshin në lutje të përbashkët, dhe këto takime njëkohësisht shfrytëzoheshin për konsulta ditore. Fillimisht Muhammedi s.a.v.s., kërkoi nga Bilali që t'i thërret njerëzit në namazin e përbashkët, prandaj ai konsiderohet edhe muezini parë, ai i ftonë njerëzit në lutjen

e përbashkët, duke ju thënë: hyri koha e namazit të përbashkët, ejani në xhami. Për formën e thirrjes në ezanin kështu siç thirret edhe në ditët tona të sotme, janë dy transmetime: a. Abdulla ibn Zejd, si gjysmë i zgjuar kishte dëgjuar një njeri të thërriste ezanin. Pastaj ia tregoi Muhammedit s.a.v.s. se ç'kishte dëgjuar në gjumë. Muhammedit s.a.v.s. i pëlqeu dhe i tha Bilalit na thirr këtë ezan. Derisa po thërriste Bilali ezanin, besimtarët e vërejtën Omerin r.a. duke vrapsur dhe me të arritur i tha Muhammedit s.a.v.s.: të njëjtën gjë e kisha dëgjuar derisa isha në gjumë b. Muhammedi s.a.v.s. e kishte mësuar Bilalin se si duhej t'i thërriste besimtarët në lutjen e përbashkët. Derisa ai po thërriste ezanin, e panë Omerin r.a. duke vrapsur dhe me të arritur i tha pejgamberit s.a.v.s. Të njëjtin zë e kisha dëgjuar derisa isha gjysmë i zgjuar. Shumica e historianëve anojnë për transmetimin e parë. Ezani thirret si më poshtë vijon: "Allahu Ekber-All-llahu është më i madhi, katër herë. Eshhedu en la ilahe il-lallah-Unë dëshmoj se nuk ka hyjni tjetër përveç All-llahut, dy herë. Eshhedu enne Muhammeden Resulullah-Unë dëshmoj se Muhammedi është i Dërguari All-llahut, dy herë. HajjalesSalah-Ejani në namaz, dy herë. Hajjalel Felah-Ejani në shpëtim, dy herë. Allahu Ekber, Allahu Ekber, Lailahe Il-lallah, Nuk ka hyjni tjetër përveç All-llahut".

## Kërcënimet e mekasve

Xhamia derisa ishte në ndërtim e sipër, banorët e qytetit mund të themi kushimisht se të gjithë merrnin pjesë në ligjëratat e Muhammedit s.a.v.s. Në këto ligjëratat nuk mungonin as jo besimtarët, e as çifutët. Kështu vazhdoi edhe pas përfundimit të xhamisë. Një ditë derisa po ndërtohej xhamia, politeistët e Mekës të dëshpëruar për mossuksesin e tyre për ta likuiduar Muhammedin s.a.v.s. derisa ishte vendlindjen e tij, i kishin dërguar një letër kërcënimi parisë Medinase. Letra i ishte dorëzuar Abdullah.b.Ubej. b. Selul edhe pse ky kishte pranuar islam

si fe të tij: "Ju e keni gostitur dhe pranuar njeriun tonë, e ne, betohemi me zotin, ose do ta mbysni ose do ta përzhini, ose ne do t'ju sulmojmë. Do të luftojmë me ju deri në luftëtarin e fundit, e pastaj do të shnderojmë gratë tuaja" Mendohej se ky njeri luante rolin e kryesuesit të Jethribit, në një mënyrë konsiderohej i pari i jethribasve. Ndërsa ardhja e Muhammedit në këtë qytet, bëri që populli vendas ta harronte Ibn Selulin si të parin e tyre. I ndikuar nga letra, morri iniciativën për t'u spastruar me Muhammedin s.a.v.s., morri disa njerëz me vete dhe shkoi tek Muhammedi s.a.v.s. dhe kërkoi prej tij të diskutohet rreth letrës kërcënuese që i kishte arritur prej mekkasve. Si duket ai kishte vërejtur se mekkasit në çdo formë e duan Muhammedin të vdekur, prandaj ishte rast ideal për të që të rikthehet në qendër të vëmendjes të medinasve. Edhe pse kishte pranuar fenë islame, i etur për të sunduar Medinen, Ibn Seluli do të kalojë në aleanca të fshehta me çifutët të cilët kishin filluar të talleshin me muslimanët dhe me mekkasit armiqët e kahershëm të Muhammedit dhe islamit. Gjendja ditë e më shumë sa vinte e tensionohej. Besimtarët të cilët ishin besatar se do t'i qëndrojnë prapa Muhammedit s.a.v.s. deri në besimtarin e fundit ishte e qëndrueshme, prandaj morën qëndrim të prerë. Muhammedi dhe të gjithë emigrantët nuk largohen nga Medineja, ndërsa çifutëve u ndalohet të dëgjojnë ligjëratat në xhami, për shkak të mos seriozitetit dhe talljeve të tyre. Orvatja e mekkasve për ta larguar, ose vrrarë Muhammedin rezultoi pa sukses, prandaj i dërguan një letër tjetër, por tani drejtpërdrejtë myslimanëve: "Mos u dall-disni se keni ikur prej nesh në Jethrib do të vijmë atje, do t'ju çrrënjosisim dhe do t'ua shkullim perimet në oborret tuaja".

### Muslimanëve u lejohej lufta

Pas stabilizimit të vëllazërimit, dhe pas kërcënimeve të pa reshtura që vinin nga politeistët mekkas Muhammedit s.a.v.s. po i lejohej lufta nga All-llahu, ai dhe besimtarët të përgatiten për vetëmbrojtje, besimtarët do të mësohen edhe me norma të tjera të xhihadit. Kujtojmë se kjo vetëm-

brojtje gjatë qëndrimit të besimtarëve në Mekke nuk ishte e lejuar për ta. Disa herë muslimanët gjatë qëndrimit të tyre në Mekke, kishin bërë përpjekje të mbroheshin fizikisht nga torturuesit, por Muhammedi s.a.v.s. atëherë u kishte kërkuar durim, sepse një gjë e tillë nuk ishte e lejuar. Islami si fe gjithëpërfshirëse duhej që njerëzimit t'ua mësonte rregullat e luftës, kur atyre do t'ju bëhej e paevitueshme. Ata do të duhej të mësonin si të sillen edhe kur provohen me gjendje luftime. Me paraqitjen e këtyre normave, njerëzimi filloi të emancipohet dhe të kuptojë se lufta nuk është zgjidhja përfundimtare e problemit.

Megjithatë Muhammedi kërcënimet e mekkasve i morri seriozisht dhe filloi të mos flinte qetë natën, nga ndonjë sulm befasues në shtëpinë e tij. Disa nga shokët e tij filluan të bëjnë roje dhe të kujdesen për shtëpinë e Pejgamberit s.a.v.s. Kështu vazhdoi derisa nuk u shpall ajeti, me të cilën Muhammedi i thotë se ishte nën mbrojtjen e drejtpërdrejtë të All-llahut xh.sh. Që prej momentit të zbritjes së këtij ajeti e deri në vdekjen e tij, ai s.a.v.s. nuk kishte truproje.

Seriozitetin e kërcënimit dhe, kujdesin e tyre e vërtetojnë patrullimet e akteve kryesore rrugore midis Mekkes dhe Medinës. Muslimanët morën hapin tjetër, filluan të bëjnë marrëveshje mirëkuptimi me banorët që jetonin përgjatë kësaj rruge. Ata po bënin miq. Pas një kohe relativisht të shkurtër muslimanët filluan të kontrollojnë rrugët edhe në veri të gadishullit. Tani pozicioni ndryshoi, mekkasit nga një popull kërcënues kaluan në popull i frikësuar. Atyre po i kërcënoheshin seriozisht karvanet që ju vinin nga veriu i gadishullit, gjegjësisht nga Bizanti.

Të gjithë ata që e kanë lexuar biografinë e Muhammedit s.a.v.s. dhe historinë e hershme të çlirimtarëve të islamit në botë, nuk mendojnë ashtu siç paraqiten sot islamikët në mediat botërore. "Shpesh herë ne në Perëndim, e imagjinojmë Muhammedin si zotërues i luftës, duke vringëlluar shpatën në një botë kundërshtare për të

imponuar Islamit me forcën e armëve. Realiteti ka qenë krejt ndryshe. Muhammedi dhe myslimanët e parë luftonin për jetën e tyre, prandaj ata kishin ndërtuar një strategji në të cilën dhuna ishte e pashmangshme." Autori vazhdon të thotë: "Islami është pagëzuar si fe e shpatës, një fe që e ka abandonuar spiritualitetin e vërtetë duke përligjur dhunën dhe intolerancën. Ky është një imazh i perëndimit të krishterë që e ka ndjekur Islamit këmba-këmbës qysh në kohërat e Mesjetës, megjithëse vetë të krishterët po luftonin të ashtuquajturat luftëra të tyre të shenjta në Lindjen e Mesme. Shpesh sot libra dhe programe televizive masive si pa gjë të keq titullohen Zemërimi i Islamit, Shpata e Islamit, Egërsira e Shenjtë ose Terrori i Shenjtë. Por ky është një shpërfytyrim i së vërtetës". Ky shembull dhe shumë shembuj të tjerë vërtetojnë se islami nuk posedon asnjë element intolerant. "Bile edhe sot fundamentalistët të krishterë po inkurajojnë segmente të caktuara të kishës amerikane që të predikojnë këto pjesë të ungjillit në Amerikën Qendrore dhe Jugore. Por ka gjithashtu të krishterë që e ndjejnë për detyrë të jetojnë pranë të shtypurve e të varfërve dhe të angazhohen me përkushtim në luftë për një shoqëri të drejtë e të ndershme. Në këtë prizëm duhet ta shohim edhe xhihad-in islamik, të cilin perëndimorët e përkthejnë si 'luftë e shenjtë'."

Xhihadi nuk është luftë klasike në plotë kuptimin e fjalës, ixhihad-i nënkupton luftën e një njeriu brenda vetvetes, e jo me të tjerët. Kur po ktheheshin luftëtarët e islamit si fitimtarë nga beteja e Bedrit, në Medinë u pritën nga qytetarët me dolli dhe gëzim. Njëri i tha Muhammedit s.a.v.s. Sot keni bërë xhihad (sakrifikuar shumë) të madh. Muhammedi s.a.v.s. ia ktheu: Ka xhihad edhe më të madh se lufta. Cili është ai xhihad-sakrificë o i Dërguari All-llahu? Iu përgjigj: xhihadi me vetveten.

Në numrin tjetër Betejat e Pejgamberit s.a.v.s.



Homazhe urbane

# URA E GURIT – PESË VITE PA MIHRAB

## 22.07.2002 – 22.07.2007

Në '25-tën qytetarët e Shkupit e përjetuan rrënimin e Burmalisë nga Jugosllavia e Vjetër ose Serbia si e quanin atëbotë, në '75-tën e përjetuan rrënimin e Jelen Kapanit nga pushteti komunist, në '89-tën menduan se Faik Pasha ishte e fundit që po rrënohej, por fatkeqësisht “rrënuesit” akoma ishin midis nesh – në 2002-shin u rrënuo mihrabi i Urës së Gurit.


### Zekerija IBRAHIMI

**N**ë vitin 1930 qytetarët e moçëm të Shkupit, po sikur ne sot, kishin shënuar se u bënë pesë vite qëkur u rrënuo Burmali xhamia në sheshin e qytetit të Shkupit. Madje, disa sosh i kishin dërguar nota proteste Mbretërisë së SKS-së. Por, kot – Burmalia nuk u kthye “kurrë më”. Në vendin e saj ata të Krlevinës e ndërtuan një pallat që pati jetë vetëm deri në tërmetin e '63-tës. Ishin këto kujtime të hidhura nga Jugosllavia e vjetër për qytetarët e Shkupit. Në vitin 1975 me urdhër të komiteteve

ekzekutive e “të skupshtinave” të tjera u rrënuo xhamia e Jelen Kapanit që ishte e vendosur aty ku sot “ndahet” drejtësia – në Gjykatën Themelore Shkup 2. Ishin këto kujtime të hidhura nga Jugosllavia e re, nga pushteti komunist, për qytetarët e Shkupit. Edhe atëbotë me zë të ulët pati reagime, por Jelen Kapani nuk u kthye “kurrë më”. E fundit që u rrënuo nga ky pushtet ishte xhamia e Faik Pashës, në Maxhir mëhallë, pranë Bankës Popullore të Maqedonisë, që u rrafshua me tokë në vitin 1989. Edhe kjo nuk u kthye “kurrë më” (kështu këndonte korbi i Edgar Alan Posë). Në 1990-tën ra Muri i Berlinit dhe komunizmi perëndoi. Për të gjithë popujt që e kishin shijuar atë sistem u


zgjua shpresa se tash e tutje në sistemin e ri pluralist demokratik nuk do të ketë më raste kur me vendime politike, si në inkuizicionin mesjetar, vendoset për objekte të kulturës dhe të historisë. Por, ishim zhgënjyer.

Ura e Gurit në Shkup, për historinë e së cilës ka shumë të dhëna, herë-herë edhe kontradiktore, sipas të gjitha fakteve shkencore dhe arkitektonike është ndërtuar në shek. XV nga Sulltan Murati II. Kështu ka qëndruar edhe në pllakën e vënë në vitin 1909 në mihrabin e Urës. Megjithatë ka edhe të tillë që ndërtimin e urës e lidhin me Mehmet Fatihun dhe e quajnë “Ura e Fatihut”. Sidoqoftë viteve 1430-1440 kjo urë ka qenë në Shkup. Me



► Ura e gurit në Shkup!


të ka qenë aty edhe mihrabi që faktikisht paraqiste vazhdim të njëres nga shtyllat e Urës. Gjatë historisë kronikat kanë shënuar riparime të saj, zgjerime a dëmtime, por askush nuk vëren se kjo urë është rrënuar. Sepse, sado që dikush mund të mos e ketë dashur osmanliun, e ka pasur patjetër të kalojë mbi këtë urë osmane. Andaj aq më pak pritej që kjo urë ta pësojë në erën demokratike. Por, shenjat e para se edhe ajo mund të lëkundej na erdhën prej Mostari. Atje e rrënuan urën më të bukur të ish-Jugosllavisë. Dhe, kështu ndodhi edhe te ne. Në vitin 1998 në Urën e Gurit kishin filluar të bëhen restaurime për gjoja fuqizimin e themeleve të saj dhe njëherazi studime për historinë e saj. Me fjalë të tjera kërkohej “qime në vezë”. E kur këto punë përfunduan, rezultati ishte ky – ura nuk ishte ajo që ka qenë. Tash ishte një urë me shkallë që asnjëherë nuk është shënuar si e tillë dhe, më e keqja, ura ishte pa mihrab. Më 22 korrik të vitit 2002 gjatë këtyre restaurimeve, gjoja se me gabim, u rrënuar si pa të keq mihrabi i Urës së Gurit. Një arkitekt të cilin shk-upjanët do ta mbajnë mend vetëm për të keq, quhej Vasil Ilov, këtë e arsyetoi sikur fëmijët në lojë ta kenë plasur një top – në stilin “punë e madhe, e bëjmë një tjetër”. E vitet po kalonin. Punët rreth restaurimit të Urës përfunduan, ndërsa mihrabi nuk po kthehej “kurrë më”. Kjo bëhej me arsyetimin se nuk ka mjete. Ndërkohë në Qeverinë e parë VMRO-PDSH me buxhet shtetëror u ndërtua një kryq i madh në Vodno, çmimin e të cilit përditë do ta paguanin qytetarët e Shkupit, ndërkohë ishte djegur xhamia e Prilepit, ndërkohë ishte nëpërkëmbur xhamia e Manastirit, ndërkohë në themele të xhamisë po me



**Shkupi i vjetër**

arsyetimet e kërkimit të gjurmëve ortodokse ishte ndërtuar Pllaoshniku në Ohër, ndërkohë me mjete buxhetore do të ndërtohet Universiteti i Shën Klimentit në Ohër, ndërkohë ndahen mjete buxhetore të kthehet Teatri i Jugosllavisë së vjetër, ndërkohë synohet të kthehet Pallati i Oficerëve, ndërkohë..., vetëm për mihrabin nuk ka mjete. Sepse, atë nuk e do asnjë pushtet, asnjë kryebashkiak i Shkupit, asnjë ministër i Kulturës, asnjë kryeministër, asnjë president. Fundi i këtij homazhi të zyrtë do të ishte ky: në të '25-tën qytetarët e Shkupit e përjetuan rrënimin e Burmalisë nga Ju-

gosllavia e Vjetër ose Serbia si e quanin atëbotë, në '75-tën e përjetuan rrënimin e Jelen Kapanit nga pushteti komunist, në '89-tën menduan se Faik Pasha ishte e fundit kur u rrënuar minarja e saj, por fatkeqësisht “rrënuesit” akoma ishin midis nesh – në 2002-shin u rrënuar mihrabi i Urës së Gurit. Dallimi i vetëm është që tash Maqedonia me këtë bagazh është nisur drejt Evropës. Asgjë më shumë. E nëse Evropa pranon shtete të këtilla, vërtet është për t'u pyetur edhe për vlerat evropiane. E kënga e kobshme e korbit vazhdonte - “Kurrë më!”. Bëje Zot hajr.



**Ura e gurit mbi lumin Vardar në Shkup!**

Leximi i tekstit

# FIGURSHMËRIA NË RELACION ME KODIN TEMATIK

Subjektiviteti gjen trajtën e vet statusore në relacion me figurën, duke gjetur e theksuar dramën e gjakosur.



**Flamur MALOKU**

**P**oema “Vaji i bylbylit”, është njëra ndër krijimet para të Ndre Mjedës, të cilën e shkroi kur i kishte vetëm 20 vjet. Ndërsa kishte rreth shtatë vjet që ishte larguar nga vendlindja. Poema u botua për herë të parë në vitin 1887 në “Shahiri elierz”, bashkë me disa vjersha të tjera të autorit. Prandaj, poema si në aspektin e


kodit strukturor e tematik ka zgjuar interesim të veçantë për shumë studiues. Andaj, struktura tekstore e poemës në relacion me kodin tematik, ka bërë që diskursi shtresor e tekstor të ngreh në vete një filozofi të veçantë, si në aspektin e figurës, ashtu edhe në strukturimin ideor. Strukturimi tekstor e motivor i shtresave e nënshtresave, e rikthen shkrimin të statusi personal. Shkrimi personal, hap brendinë gjakuese përballë vetmisë – mallit, pra, vetmia dhe malli shtrihen në shtresën e figurës. Figura bëhet shprehje e trishtimit, një trishtim i cili është i bashkëthurrur që nga fillimi i poemës. Tani, ky trishtim autorial merr emrin vaj. Vaji, si sintagmë i përshtatet gjakimit personal përballë vetmisë njohëse. Kështu, trishtimi së bashku

më gjakimin njohës, çdoherë më një përjetim të thellë, fatalisht të përkufizuar në strukturën e tekstit, shqiptohet e shënjohehet përmes figurës së bilbilit. Mirëpo, figurën e bilbilit duhet parë vetëm si alterego të vetë subjektit lirik, më konkretisht autori i rikthehet vetvetes dhe nga ky pozicion e thur diskursin tekstor. Pra, bilbili merret vetëm si mundësi e komunikimit për të fshehur vetën autoriale edhe pse ajo krejt haptazi del në fund të poemës. Atmosfera e jashtësisë kohore, pa një ndryshim të brendësisë personale, dëshmon edhe më shumë se autori gjakimin e trishtuar e të artikuluar në vaj, prapë e ruan shkallëzimin e gjendjes dramatike. Koha e ndërruar, që paraqitet nga fillimi i poemës e rëndon edhe me shumë gjendjen personale, e cila tani shprehet në katrenat me vargje 5 – rrokësh e

skemë të rimit abcb. “Figura esenciale e tekstit në strofën e parë, ku shtresohet jashtësia si ndërrim i stinës dhe brendia si e mos ndërruar, si përhershmëri përjetimi, prej ku shkrimi ndërtohet si krahasim i zgjeruar”, Kujtim Shala. Pra, krahasimi i zgjeruar, gjatë përshkrimit të natyrës, më theksim të figurave, si: bora, dimri, varfëria, etj. jepen përbrenda krahasimit me një dëshpërim autorial. Andaj, subjektiviteti gjen trajtën e vet statusore në relacion me figurën, duke gjetur e theksuar dramën e gjakosur. Si shenjë e kësaj esence, duke mos rrezikuar asnjëherë kodin nacional edhe pse figurshmëria kërkohet vazhdimisht, qoftë edhe në shprehimësinë autoreferenciale. Kodi nacional, theksohet e mbitheksohet, duke qenë edhe synim kryesor i autorit. Përngjasimi i figurës kryesore në figurë personale, shtrihet në sistemin, duke u nisur si figurë e duke përfunduar si vetmi personale, çdoherë përballë kodit nacional e moduesit të shkrimit simbolik. E themi simbolik, sepse moduesi shkrimor në shprehjen e në artikulimin e gjendjes, herë nga vetmia e herë nga malli, autori shenjat tekstore i rikthen në simbol. Të gjitha shenjat tekstore e shtresore, përbëjnë konotacionin dytësor, si përfaqësim e reflektim i dëshpërimit. Ky reflektim shprehet e shënjohehet sidomos në pjesën e dytë të poemës, ku diskursi figurativ kalon në shqiptim të subjektit, duke u njohur kështu jashtësia përballë brendësisë, tani në vargje katërshe po në 8-rrokësh me skemë rimit abcb. Gjëmimi-vajtimi subjektiv, duke iu referuar herë kohës, e herë vetvetes, nëpër trajtën e përjetimit e përmallimit, vije deri të njëjtësimi, po edhe kërkimi i vajit:

*Me at zanin t'and t'permallushe  
ndoshta ti anko këto t'vështira:  
deri sa t'kthejn' e mira ,  
Bylbyl, po pra gjimo.*

Kërkesa subjektive, çdoherë në relacion ngjashmërie, karshi kohës dhe vështirësive kohore, e shtynjë subjektin që të kalon edhe konventën personale. Sepse, kërkimi i vajit dhe shtresimi përgjatë diskursit, deri të identifikimi, na mundëson edhe përcaktimin e statusit kategorial të shkrimit. Pra, si shkrim i plotë personal siç shënjohehet në vargjet:



► **Ndre Mjeda**

*Pra njaj vaj qi pe tui lëshue,  
bylbyl, zemrën m'a copton;  
dit 'e nata rrij tui pirqe,  
vaj per mue kush mund t'ngushllon?*

Pothuajse, figura e bilbilit shkrihet, apo njëjtësohet me subjektin, njëjtësim ky që shprehet që nga fillimi. Prandaj, përjetimi i rëndë që lidhet me largimin, ku tani ky largim sjell mallin e familjes, mall ky që është i pashoq në strukturën e tekstit. Tani, vetmia, malli e dëshpërimi kalojnë edhe më shumë duke e thelluar kështu gjakimin shpirtëror:

*vajin t'and ju kishin prue,  
t'kishin kjaë per jet'e mot.*

Strukturimi mbi principin e vajit e të mallit është temë themelore nëpër të cilën gjakohet subjekti. Gjakimi ruhet edhe në pjesën e fundit të poemës, e cila është shkruar në strofa sofike me përjashtim të strofës së fundit që ka pesë vargje me rimë aabb. Prandaj, leximi i shenjave autoriale nuk shképuten, po vetëm sa vjen e përforcohen. Këtu, ndërrohet natyra, ndërrohet çdo gjë, tani subjekti fillon me shpresë. Shpresa autoriale bëhet esencë kërkimi, për një qetësim shpirtëror e njerëzor:

*Porsi motmoti ndërrojmë na vetë,  
Herë herë gazmohna, here rrijmë te  
shkret*

Tani, subjekti sikur bëhet njësoj me gjakimin e me dhembjen. Pra, shkrimi në figurë kalon në identifikim të plotë, me një emocionalitet. Emocionaliteti, e bën edhe më shumë personal shkrimin, që hapet e shënjohet krejt në fund. Mirëpo, hapja vije nga malli, sepse përshkrimi i natyrës, te autori zgjon mall, andaj, malli është krejtësisht gjakues, përballë kujtim-it. Por, subjekti shpreson siç e thotë edhe vet autori "kam per t'u gëzua".



**Bilbili i cili këndon, bëhet figurë vajtimi.** ◀



**Kënga e bilbilit, vaji i poetit.** ◀

## Poezi

**FLUTURO MATANË LUMENJVE****Mehas ALIJA****Bota së prapthi kërkonte rrugën e saj**

Trishtimi i avitej si nata kur vjen pa  
yjet e hënën  
Një imazh i zymtë e i thyer  
Kapërdihej nën atë qiell  
Që si trarë i vjetruar e i lagur  
Lëshonte riga mllefi

Bota së prapthi kërkonte rrugën e saj  
Ajo rrinte si e mërguar në shpirtin e vet

Në vendin e saj  
Luhej si në fushë futbollit  
Të gjithë vraponin pas një topi  
Pas një qëllimi  
Si të rritej avantazhi

Sitën që sillte beharin  
E kishin mbërthyer duart e botës  
Ndonëse nga ajo binin gurrës  
Brenda saj  
Fshehur diku  
Ruhej një copë shprese  
“Gjaku që nuk falet”

Bota së prapthi kërkonte rrugën e saj  
Ajo rrinte si e mërguar në shpirtin e vet

**Iku koha kur binin kumbonat**

Edhe kësaj here  
Kalova matanë ëndrrës  
Shkela botën me frustrim  
Ushtrinë do ta rekrutoj  
Po, po ushtrinë ...

Ti eja  
Si asnjëherë më parë  
Me petalet e xhenetit

Fluturo matanë lumenjve  
Eja e bëje safin tek keutheri  
Do ta luftojmë së pari mashtrimin  
Rrëshqanas do ta ruajmë imanin

Edhe kësaj here  
Kalova matanë ëndrrës  
Kërkova poemën e fitimit  
Kërkova kryengritësin  
Nuk i dua ushtarët që i ngjajnë natës

Ti eja  
Si asnjëherë më parë  
Ta ruajmë plisin e imanit  
Keutheri të mos na turbullohet

Iku koha kur binin kumbonat....

**Të shohësh si duket kodra e imanit**

eja  
të lundrojmë  
me barkën e devotshmërisë  
në detin e pafund  
të pa skaj  
aty ku sosen drunjtë  
aty ku ngjyrat nuk mjaftojnë  
aty ku sipër tij  
mblidhen zogjtë  
dhe festojnë lirinë  
jetojnë kaltërsinë  
e duan thellësinë  
e detit pafund...

eja  
të gjejmë shërimin  
aty ku fshehur gjendet  
dermani i çdo gjëje  
eja, e mos u tkurr  
eja të njohim gjuhën  
e shpirtit  
pse po serohesh me lëvoren  
e mëkatit  
e të të rrjedh pelini  
gojës...

eja zhytu në  
Kur'an  
tek drita e dritave  
të shohësh si duket kodra e imanit  
me lulet e bardha

**Bujqit e kohës**

Zëri i bilbilit pushoi të këndo  
Lumenjtë u thanë  
Pranvera tkurri bukurinë  
Ne u bëmë bujq të kohës  
Lëvruam djersën e huaj  
Mbollëm zjarre  
Dhe me lot i vaditëm  
Që nesër t'i korrnim stinët  
Stinët plot zjarrmi

Ju o bijtë e bujqve të kohës që iku  
Të lëvroni mendjen tuaj  
Që e nesërmja  
T'ju mbijë lule gëzimi

**Dëshmi**

Hapin e kemi dëshmi  
Sa rrugë të gjatë  
Paskemi bërë

Buzëqeshjen mijë vjeçare  
Në grusht e kemi  
Si u bëmë kaq  
Të zymtë

Tokë e qiell trishtuam  
Me ngecjen tonë

**Kanë ardhur fytyra të reja**

Kanë ardhur pranvera  
Që s'duan tu flet pushka  
Që s'duan tu shkelet bari


Kanë ardhur fytyra të reja  
Nga do botë  
Nga do kohë të mira  
Kanë ardhur duke krehur zvarrë  
Ujëvarat e syve  
Barqet e mbushura me gurrës

Ata pushkën s'e kanë gjuhë  
As memecë nuk janë  
Dhe s'kanë pse të ikin prej tyre  
Si në dasëm kanë ardhur

Kanë ardhur me diellin e hënën  
Me stinët  
Me të djeshmet  
Me të sotmet  
Me të nesërmet e ndritshme

Kanë ardhur për të mbjell lule  
Për t'i pasur sytë e bukur  
Zemrat e hapura

Rrjedha që kërkonjë shtigje  
Kanë ardhur



Leximi i tekstit

# TAT TANUSHI I BUBUTIMËS, MITRUSH KUTELI

**Kuteli përmes këtyre dy karaktereve jep përsosmërinë bashkëshortore, dashurinë ideale, jetën e pastër shpirtërore e fizike, njëtrajtësinë e ndjenjave dhe nevojën e njeriut.**

**Valmira PEÇI**

**N**ovelën “Tat Tanushi i Bubutimës” të Mitrush Kutelit e karakterizon diskursi legjendar dhe diskursi biblik duke paraqitur dashurinë e pastër, harmoninë familjare dhe përsosmërinë morale. Këto virtyte njerëzore duhet të jenë fitimtare ndaj botës materiale, shfrenimit dhe mëkatit. Ideja e veprës letrare, dënimi i Zotit për mëkatarët me pavdekësi, vjen nga legjenda dhe brendh nëpër tokën e lashtë ilire deri buzë liqenit të Ahridës.

Personazhi kryesor, Tat Tanushi, bashkëdyzon ngritjen shpirtërore nga mësimet e shenja dhe nga rezistenca e fisit ilir.

“E madhe është gjëma e mëkatit, po e madhe edhe fuqija e hirit të priftërisë. Sepse hiri mburon nga Zoti. Edhe ndaj Zoti të pamundurat bëhen të mundura, me anë të hirit e të fjalës.”

Esenca e veprës e deklamuar në fillim, vazhdon me dy trajta të rrëfimit: të naratorit dhe të plotësimit autorial. Hyrja ka nuanca përrallore.

Tat Tanushi i Bubutimës nga Iliria ishte njeri i dijshtëm dhe i devotshëm. Ai rronte në gjirin e kishës së Lindjes, i edukuar nga Shkronja dhe nga fjalët e etërve të shenjtë, lutet vazhdimisht për faljen e mëkateve. Jeta për Tat Tanushin ishte e lumtur, dashuria pa kufij. Ai jetonte për dy dashuri: Zotin dhe të shoqen Kalijen, të cilën e dashuronte me thellësinë e zemrës. Dashuritë fillojnë të grinden brenda qenies së tij, ngase ndihen rivale në shpirtin plot dritë.

Kuteli përmes këtyre dy karaktereve jep përsosmërinë bashkëshortore, dashurinë ideale, jetën e pastër shpirtërore e fizike, njëtrajtësinë e ndjenjave dhe nevojën e njeriut për dashuri. Mbesëlënësja janë fjalët shprehëse të dashurisë ndaj njëritjetrit, që janë të përafërta me Këngët mbi Këngët të Solomonit:

*Sa të ëmbëla janë përkëdheljet  
e tua, o shoqeza motra ime;  
Më të këndëshme se vera janë  
përkëdheljet e tua,  
Dhe era e shtatit tënt i kalon  
të gjitha aromat.*

Strukturimi i garniturës jetësore: Imzot, burri dhe gruaja përshkohet nga zëri filo-

zofik i ëndrës që sheh Tat Tanushi, i cili zë është njëherit edhe ligji i jetës së përkohshme:

“Cili gëzim i jetës mbetet i pa përzjerë me hidhërim? Cila lavdi qëndron mbi dhe e paçvendosur? Të gjitha janë më të dobëta se hija. Të gjitha janë më të rreme se ëndrrat, një çast e të gjitha këto i mëkëmbëson vdekja. Si lule fishket dhe si ëndërr shkon e përmdahet njeriu...”

Pason sprova qiellore. Sëmundja e Kalijes fillon ta gërryejë bukurinë e saj bashkë me shpirtin e Tanushit.

Ideja e autorit është se e bardha dhe e zeza janë të pashmangshme nga ekzistenca e njeriut. Ngritja e shkëlqimi në novelë pëson rënie marramendëse që në pjesën e parë. Gjithçka që ishte e përkryer dhe e dashur për Tanushin nuk ekziston më. Kalija vdes.

Tanushi nga besimi bie në dëshpërim, nga besa bie në mëkat. Fillimisht mëkaton më krijimin e ikonave me fytyrën e Kalijes që shpreh mospajtueshmërinë totale ndaj vendimit të Zotit.

Si pasojë ai dënohet me dënimin më të rëndë, pavdekësinë që prodhon shkatërrimin e përhershëm, jetesën e hidhur dhe dhemben e amshueshme.

Tanushi bie në mëkat më të madh pas tri vjetësh nga kontakti fizik me botën femërore. Atëherë përjashtohet edhe nga kisha për shkak të padrejtësisë.

Autori dëshiron të theksojë labilitetin njerëzor përgjatë historisë, pasigurinë e përhumbjen shpirtërore. E gjitha i takon çastit. Mëkatin e lindur nga çasti e pason dhimbja dhe dënimi.

“Çdo njeri, edhe ai më i mençuri, ka pesë minuta çmendurie në jetën e tij” -ka thënë Sh. Bodler.

Në fund triumfon e drejta dhe arsyeja që shuan fuqinë dehëse mëkatore e përfundon me spastrimin shpirtëror nga pendimi i sinqertë.

Tat Tanushi ndonëse vuan nga humbjet, nga dënimi me pavdekësi, kalon hapësirat, kohërat, ndërton gjeneratat, ai zbuloi rrugën shpëtimtare përmes udhëtimit me dymbëdhjetë veta për në Apolloni ku edhe vdiç.

Përfundimi i këtillë i novelës përçon idenë kuptimplote se natyra njerëzore sa e ndieshme e komplekse aq e devotshme, nuk mund t'i shmangët mëkatit të nxitur nga rrethanat e jashtëzakonshme sprovue. Njeriu është në luftë të përhershme me mëkatin. Fitorja dhe humbja janë relative.

Përcaktuesi e sfiduesi në këtë luftë është Zoti. Ai që mbron e fal shumë.



Harrimi në kohë! ◀

Jeta studentore

# Problemet e studentëve gjatë studimeve

**Ekzistojnë edhe shumë probleme që kanë të bëjnë me natyrën e studimeve si streset që ndikojnë relativisht direkt në studentin; vonesa e profesorëve, pritja e gjatë para sporteleve të referentëve dhe shumë probleme tjera.**

**Shkelzen RRECAJ**

**N**jeriu gjatë jetës së tij përballët me vështirësi të natyrave të ndryshme por, shpeshherë është i paafte që t'i menaxhoj ato. Në të shumtën e rasteve nevojitet që vështirësive t'i qasemi në mënyrë akademike, por jo të gjithë e kanë këtë aftësi. Mirëpo, për të ngritur intelektualin tonë, ne duhet që të ndjekim shkollim të mëtutjeshëm përveç atij fillor dhe të mesëm, që do të thotë fillimin e studimeve universitare. Dihet, se studimet kanë vështirësitë e veta, andaj studentët kosovar përballen me shumë probleme të ndryshme, duke filluar nga mungesa e parave që vije si shkak i kushteve të rënda sociale që janë krijuar kohëve të fundit në Kosovë. Mirëpo, ekzistojnë edhe shumë probleme që kanë të bëjnë me natyrën e studimeve si streset që ndikojnë relativisht drejtpërdrejtë në studentin; vonesa e profesorëve, pritja e gjatë para sporteleve

të referentëve dhe shumë probleme tjera. Natyrisht se për të filluar dhe mbaruar studimet duhet që studenti të siguroj një shumë të madhe parash. Gjendja ekonomike, nëpër të cilën po kalon populli i Kosovës, shpeshherë e pamundëson sigurimin e mbështetjes financiare, sepse papunësia është e madhe, dhe në qoftë se ndonjë nga anëtarët e familjes se ndonjë studenti është në punë ai nuk arrin që t'ia mbuloj të gjitha shpenzimet të familjes e lerë më që t'i ndihmojë djalit apo vajzën që e ka në studime. Sepse, standardi në vendin tonë është mjaft i ulët, andaj studenti që nuk arrin të siguron mbështetjen nga familja, ai ose duhet të punojë me punë krahu, ose duhet t'i ndërpres studimet. Një student ka shumë harxhime, duke filluar nga ushqimi, fjetja, udhëtimi dhe blerja e literaturës, të gjitha këto që i përmendem me lartë janë mjaft të shtrenjta, për kushtet që posedon studenti. Nuk janë vetëm këto vështirësi që has studenti gjatë studimeve, ai has edhe në shumë probleme që ndikojnë drejtpër-

drejtë në të, si vonesa e profesorëve të cilët mjaft shpesh mungojnë në ligjërata e kjo e shqetëson, apo e streson studentin se ai gjatë ditës planifikon që të lexoj ose ka edhe punë të tjera për të bërë. Mirëpo në fakt nuk është vetëm mungesa e tyre, por, ata shpeshherë i shtyn edhe provimet por edhe rezultatit e provimeve dhe kjo ndikon psikikisht të studenti i cili lodhet në mënyrë psikike. Studenti kosovar, përballët me këto vështirësi, të cilat ndikojnë edhe në rezultatit e mësimit, andaj nuk mund të këtë sukses studentit kur sfidohet e sprovohet me këto gjëra të panevojshme.

Për të studiuar nuk është lehtë, por, studentët ose duhet pajtuar, ose jo me kushtet që kanë në fakultet, sepse Kosova po kalon nëpër fazën e vështirë, andaj edhe studentit duhet që të mos brengoset, se një ditë do të jetë me mirë. Le të durojë, për hir të së ardhmes së afërt që na pret, e ai vetë le të kontribuojë për t'ua lehtësuar studentëve të tjerë.



► Jeta studentore, jetë plot stresse!

Psikologji

# Ç'ËSHTË FOBIA?

Shoqata psikiatrike e Amerikës, fobinë e sheh si pjesë të frikës irracionale, që rezulton nga objekti, situata, aktivitet ose nga ndonjë person. Në të shumtën e rasteve, fobia ngërthen një ndjenjë të rrezikuar, të frikës nga lëndimi, p.sh. ata që vuajnë nga "agrofobia", frikësohen nga të qenurit të mbyllur, ose të futur në një vend apo situatë, ku dalja për ta është e pamundur.



Bujar SEJDIU

**S**imptomi kryesor i këtij çrregullimi, është një lloj dëshire tepër e madhe dhe e paarsyeshme për t'iu larguar objektit apo situatës, nga e cila një person mund të frikësohet. Simtomet e fobisë mund të paraqiten, përmes ekspozimit ndaj objektit apo situatës së cilës i frikësohemi, apo ndonjëherë thjeshtë vetëm të menduarit për objektin apo situatën prej të cilës frikësohemi, mund të shtyjë deri te reagimi apo paraqitja e fobisë.

Simtomet që zakonisht i shoqërojnë fobitë janë:

- Marramendje
- Mbetje pa frymë
- Neveria apo mundimi
- Ndjenjë e irealitetit
- Frika nga vdekja

Në disa raste, këto simtome mund të arrijnë në një sulm ankthi të shkallës së plotë.

Si pasojë e këtyre simtomeve, disa individë fillojnë të vet izoloohen, duke shkuar drejtë vështirësive në jetën e përditshme. Në rastet tjera, individët mund të kërkojnë kujdes mjekësor lidhur me një brengosje konstante për sëmundje të imagjinuara apo për vdekje të pashmangshme.

## Llojet

Ekzistojnë tri lloje të fobive:

- a. Sociale – frika nga situatat sociale
- b. Agorofobia – frika nga mbyllja në vende të pakalueshme
- c. Specifike – frika nga ndonjë objekt specifik (p.sh. gjarpërinjtë).

Po ashtu fobitë klasifikohen edhe në katër grupe tjera të fobive specifike, si:

1. Fobia nga ambienti ose rrethi natyror – këtu hyjnë frika nga vetëtima, frika nga uji, frika nga stuhitë, e të tjera,
2. Fobia nga kafshët – frika nga gjarpërin-

jtë, frika nga merimangat, frika nga insekte, e të tjera.

3. Fobia medicinale – frika nga shikimi i gjakut, frika nga injeksionet, frika nga vizita e doktorit, e të tjera, si dhe

4. Fobia nga situatat – frika nga urat, frika nga largimi prej shtëpisë, frika nga ngasja e automjeteve, frika nga lartësitë, e të tjera.

## Mbizotërimi i Fobive

Në fakt, fobitë janë mjaftë të zakonshme, vetëm në SHBA janë të prekur më shumë se 10% e popullatës. Fobitë janë çrregullimi mental më i përhapur në këtë vend, por numri grave është më i theksuar se i burrave. Në shumë raste njerëzit janë në gjendje ta kuptojnë që frika e tyre është irracionale dhe kështu arrijnë të ndërmarin hapa për ta tejkaluar fobinë e tyre. Sipas Udhëzuesit Diagnostik dhe Statistik të Çrregullimeve Mentale, vetëm rreth 10% nga rastet e raportuara bëhen fobi për tërë jetën.

## Trajtimi i fobive

Ekzistojnë më shumë se një numër i trajtimit për fobitë. Efektiviteti i trajtimit varet nga individit dhe tipi i fobisë. Më poshtë janë vetëm disa nga trajtimet potenciale të fobive:

**Trajtimi me ekspozim** në të cilin pacienti i ekspozohet objektit të frikës në mënyrë që të ndihmohet për ta tejkaluar frikën e tij ndaj objektit frikësues. Një lloj i trajtimit me ekspozim është **përmbytja**. Pacienti ballafaqohet me objektin e frikës për një gjatësi më të madhe të kohës me pamundësi për të ikur. Qëllimi i kësaj metode është që të ndihmohet individit, ta ballafaqojë frikën e tij dhe ta kuptojë

që objekti i frikës nuk do ta lëndojë atë. Një tjetër metodë e përdorur shumë shpesh në trajtimin e fobisë, është forma kur pacientit i mësohet një përgjigje apo reagim i ri ndaj objektit të frikës. Në vend të panikës në ballafaqimin e objektit të frikës, pacienti mëson teknika të relaksimit për ta zëvendësuar ankthin dhe frikën. Kjo formë e re e sjelljes është në kundërshtim me reagimet e mëherëshme të panikes, kështu, reagimi fobik gradualisht fillon të zbehet.

Kjo metodë që në gjuhën angleze quhet "counter-conditioning", shpesh përdoret te pacientët të cilët nuk janë në gjendje t'u bëjnë ballë trajtimeve të ekspozimit.

Në numrin tjetër: Llojet kryesore të fobive.



Fobia, frika irracionale!

## Dobitë e ullirit

**ULLIRI – THESARI BREGDETAR**

Ulliri një fryt i mirë dhe i shijshëm, rritet në vendet bregdetare, përmban një përqindje të lartë të karbohidrateve (16.7 %), yndyrave (13.5 %), proteinave (1.5 %) dhe kripërave minerale e po ashtu përmban edhe përqindje të madhe të vitaminës A dhe D. Ulliri dhe vaji i tij nuk përdoret vetëm si ushqim natyral, por nga ky fryt përdoren edhe gjethet e tij kundër shumë sëmundjeve (kundër temperaturës së lartë dhe tensionit të lartë arterial etj).

Artan BEJTA & Iliriana ALLOQI

**P**ërdorimi i vajit të ullirit mbron nga shumë sëmundje

Vaji i ullirit është mbrojtës i shumë sëmundjeve të zemrës, sistemit të tretjes e shumë sëmundjeve tjera. Është i vetmi vaj i cili fitohet nga frytet e ullirit drejtpërdrejt pa përpunime kimike e kështu ai ruan përbërësit e vetë duke u paraqitur si mbrojtës i mirë i shumë sëmundjeve. Shumë studime janë bërë në lidhje me vajin e ullirit prej të cilave është ardhur në përfundim se roli i vajit të ullirit është mjaft i madh në mbrojtjen nga shumë sëmundje. Ndër to vlen të përmenden studimet që janë bërë nga studiues në Spanjë dhe SHBA, sipas të cilëve njëri prej përbërësve të

vajit të ullirit e ul përgjysmë nivelin e substancave të cilat shkaktojnë kancerin e gjirit.

Për rolin e madh dhe të rëndësishëm në përdorimin e vajit të ullirit më së miri e tregon Agjencia Amerikane për ushqim dhe Barna (FDA), e cila vitin e kaluar u lejoi prodhuesve që në etiketat e vajit të ullirit të vendosin edhe mbishkrimin "Shëndeti i qëndrueshëm", për arsye se yndyrat e pangopura të vajit të ullirit zvogëlojnë rrezikun nga sëmundjet e zemrës dhe të gjakut.

Shumë me rëndësi është studimi i bërë nga Dr. Wilsoni nga Britania e Madhe është vërtetuar se acidi oleik i cili gjendet në përbërjen e vajit të ullirit i mbron qelizat nga oksidimi si faktor që ngadalëson plakjen e njerëzve.

Vaji i ullirit i cili ka një ngjyrë të gjelbërt të mbyllët, ka aromë specifike, në për-



bërjen e vetë ka vitamina, acide yndyrore esenciale dhe antioksidant, dhe pikërisht për këtë ka një rol të madh. Me çdo pikë të vajit të ullirit i marrim mbi 30 përbërës të rëndësishëm të këtij vaji të cilët na mbrojnë nga sëmundjet e zemrës si sëmundje shumë të shpeshta dhe me rrezikshmëri të lartë, mplaçja e hershme dhe shumë sëmundje të tjera.

Ajo që e bën shumë të rëndësishëm këtë vaj dhe veprimin e tij është prania e acideve yndyrore të pangopura e prej këtyre acideve më së tepërmi gjendet acidi oleik i cili përbën 55% - 83% të acideve yndyrore të përgjithshme. Këto acide yndyrore në mënyrë të përgjithshme veprojnë në metabolizmin e yndyrave në mëlçi (d.m.th. e rregullojnë kolesterolin), e mbrojnë zemrën nga sëmundjet e ndryshme të saj, zakonisht nga ato që paraqiten me ngurtësimin e enëve të gjakut siç janë: angina pectoris, infarkti kardial, tromboza, rregullimin e tensionit të gjakut, etj. Po ashtu testet laboratorike mbi qelizat kanceroze të gjirit kanë treguar se acidi oleik e bën më të efektshëm medikamentin që përdoret kundër kancerit dhe rrit prodhimin e proteinave që lufton tumoret.

Përpos acideve yndyrore ky vaj përmban edhe një numër të madh të vitaminave të tretshme në yndyra siç janë vitaminat: A, D, E, K. Nuk ka vend për frikë nga mbipe-sha nëse përdoret ky vaj pasi që ai përkundrazi vepron si zbritës i mbipeshës.



Po ashtu ky vaj ka ndikim edhe në sistemet e tjera të trupit të njeriut e një prej këtyre sistemeve është ai i tretjes: të përtypurit e gjetheve të ullirit ndihmon në rastet e inflamacionit të mukozës së gojës, pirja e vajit të ullirit është i dobishëm kundër helmimit. Ky vaj lehtëson dhimbjet në lukth dhe zorrë dhe mbyl parazitët në zorrë, pastaj zvogëlon rrezikun nga ithati në lukth, lehtëson gastritisin (inflamacionin e lukthit), e po ashtu vepron edhe si laksativ duke ndihmuar në këtë mënyrë problemet me jashtëqitje, lehtëson kapsllëkun. Mendohet se vaji i ullirit ndikon edhe te disa sëmundje të veshkave, eliminon gurët në veshkë, në fshikëzën e tëmthit, e po ashtu mendohet se ka përbërës që mbrojnë nga sëmundjet e kancerit. Gjithashtu për të sëmurët me diabet, çaji i përgatitur me gjethet e ullirit e ul sasinë e sheqerit në gjak. Diabetikët këshillohen të hanë kokrra jeshile ulliri, të cilat ulin etjen që shkakton diabeti.

Po ashtu është shumë e rëndësishme se ky vaj përdoret në shumë medikamente mjekësore si tek format orale (nga goja) ashtu edhe te ato parenterale (me gjilpëra).

Ky vaj gjen një shfrytëzim të jashtëzakonshëm si tek fëmijët pasi që lehtëson mineralizimin e eshtrave, e po ashtu edhe te personat

e moshuar pasi që shumë prej tyre kanë problem me osteoporozën.

### **Vaji i ullirit ndikon në rregullimin e lëkurës**

Që prej kohërave të lashta është ditur që ky vaj ndikon në lëkurën e thatë dhe i jep asaj shkëlqim. Prandaj, është përdorur atëherë dhe përdoret edhe sot për këtë qëllim, pasi që në industrinë kozmetike përdoret si përbërës i shumë sapunëve, shamponëve, kremrave, etj. Nga pomadat dhe preparatet e tjera që përgatiten me vajin e ullirit, mjekohen plagë të ndryshme, djegie të lëkurës, duke ndihmuar në ripërtëritjen e indeve të dëmtuara. Flokëve ju jep fortësi dhe i mbron nga të thinjurit e parakohshëm.




Këshilla për karrierën tuaj

# DEPËRTIMI NË KARRIERË

Njohja e të gjitha punëve nuk është mënyrë më e mirë për filluar një punë. Këtu po i japim 10 këshilla që në punën tuaj këshillat e juaja të vlerësohen.


**Shkelzen NUZA**

**J**u sapo ju keni bashkangjitur një kompanie të re dhe e shihni se të gjithë janë ngritur në këmbë që të bëjnë ndryshime në kompani. Përderisa entuziazmi juaj për punë është lavdëruar dhe ju mezi prisni ta tregoni veten. Lexoni më poshtë se si ju të mos jeni punëtor i ri dhe shumë fyes edhe pse ju e njihni punën dhe për çdo gjë keni kritika.



**1. Shko në modin konsultues**

Janë dy punëtor të rinj, njëri nga McK-insey dhe tjetri nga Booz Allen. Ata



duke shëtitur nëpër kompani ku po punojnë shohin 20 gjëra (punë) që nuk po bëhen në mënyrën e duhur, por ata nuk po flasin sepse po vërejnë mundësinë e përmirësimit të tyre. Për muajin e parë në punë edhe pse ju pyeteni direkt si p.sh.: “ Se si ju do ta kishit përmirësuar këtë proces?”, kursejini opinionet



e juaja në vetvete.

**2. Studioni historinë e asaj kompanie**

Për gjashtë muajt e parë në punë, ju duhet të pyesni si i çmendur për punën ku jeni caktuar: p.sh., si është arritur ky plan apo ai tjetri, çfarë keni provuar në fillim për ta realizuar këtë dhe cilat janë përpjekjet e juaja tani për këtë? Mësimi



i historisë së kompanisë dhe mësimi i logjikës së marrjes së vendimeve në atë kompani do të ju mundësoj juve të mos bëni kapërcime në konkluzionet e juaja para kolegëve të cilët i shohin gjërat ndryshe nga ju.

**3. Rikujtoni rregullin e “flokut të borës”**

Kompanitë janë si flokët e borës: Nuk mund t'i gësh dy kompani të ngjashme. Vetëm se kompania që së fundi keni



punuar e ka dashur sistemin softuerik XYZ nuk do të thotë se sistemi XYZ është zgjidhja më e mirë për dyqanin tuaj të ri. Që t'i shtoni vlera punës suaj të re, ju duhet të jeni në gjendje të dalloni se çfarë është ndryshe dhe unike në punën tuaj. Betohuni të mos sugjeroni ndonjë intervenim ose zgjidhje që është dhënë në kompaninë e vjetër ku ju keni punuar kur e kuptoni se ai vend i punës dhe ky tani ku jeni janë të ndryshëm.

**4. Sigurohuni se ekziston problemi para se ju të sugjeroni zgjidhjen**

Para se ju të jepni zgjidhjen perfekte, sigurohuni se punëtorët tjerë e perceptojnë problemin. Në të kundërtën, ju do të njiheni si punëtor i cili dëshiron që perdet e kaltra t'i zëvendësoj me ato të kuqe dhe këtë ndryshim e dëshiron vetëm që t'i figuroj emri i tij se ka thënë diçka. Bëhu shumë kokë ulur kur është nevoja për përmirësimin e kompanisë



dhe fokusohu në këtë fushë në fillim.

**5. Mbani rolin mbështetës**

Është mençuri për punëtorin e ri që si fillestar në punën e tij të luaj rolin mbështetës më mirë sesa udhëheqës në iniciativat e departamenteve. Kështu, ju do të mësoni më shumë, do të krijoni lidhje më të forta me bashkëpunëtorët dhe do të fitoni kredibilitet që do të ju nevojitet në të ardhmen në mënyrën që më shumë të dëgjoni e më pak të flisni.

**6. Gjeni një mentor**


Organizata ku ju po punoni mund të



jetë ajo ku punëtorë të rinj pranohen të gatshëm ose ku ata pritët të paguajnë për atë trajnim dy ose tri herë përderisa të bëhen anëtar me të drejta të plota në grup. Gjetja e një të punësuar veteran që të ju këshilloj në procesin fillestar do të ju ndihmoj juve që të dëgjoni se cilat elemente të qasjes suaj funksionojnë e cilat jo.

**7. Balanconi "zgjidhjen brilante" me rolin tuaj mbështetës në grup**

Ju tashmë dëshironi që të bëni depërtime të rëndësishme që të funksiononi si grup. Pyete vetveten fillimisht: a është diçka me të vërtetë kataklizmatike që do të ndodh nëse unë nuk do t'i nda-



jë idetë e mia në çdo minutë? Nëse jo, merrni parasysh se ju veç jeni punëtor i ri dhe do të kuptoheni edhe si euforik në punën e juaj. Ruajeni qetësinë se do të ju vi edhe juve koha që të dëshmoni aftësitë e juaja.

**8. Para se të jepni sugjerime, testoni ato diku jashtë**

Ju tashmë keni krijuar kredibilitet te anëtarët e grupit, pyete njërin prej tyre se si po tingëllon sugjerimi që ju e keni ndërmend ta jepni në mënyrë që të ju ndihmoj juve se si do të pranohet rekomandimi juaj. Kjo shumë mirë do të ju ruaj juve që të mos jepni sugjerim të sëmurë.


**9. Prioritizoni listën e punëve**


Roma nuk ishte ndërtuar brenda një

dite, dhe të gjitha idetë e juaja të mëdha nuk do të pranohen e aq më pak do të implementohen brenda një periudhe të shkurtë kohore. Prioritizoni sugjerimet që ju dëshironi që të implementohen dhe drejtoni listën tuaj të prioriteteve me menaxherin tuaj para se të ja tregoni botës.

**10. Kërkoni feedback**

Pasi e keni kryer një punë, pyetni për feedback: "Si mendoni, a ja dola në prezentim?" Ose "A mendoni se kam arritur mjaft për gjatë kësaj periudhe?" Pyet se çka ju duhet të bëni më mirë që të përmirësoheni dhe çka duhet të angazhoheni më shumë. Gjashtë muajt e parë në punë janë kritik.





## HORIZONTALISHT

1. Gaus – Sulfur, 2. Një kontinent, 3. Pallati i Papës në Romë, 4. Lëndë plasëse, 5. Komponimet kimike me Nitrogjen, 6. Vend në Kamerun – Regjisori Qosja, 7. L.N. – Degë e Danubit, 8. Dashuria (tur.) – Përemër vetor, 9. Strofull e disa kafshëve në pyll të dendur – Tempo, 10. Ato që hajnë mishin e njeriut – Lloj ëmbëlsire si pelte, 11. Lloj sallate me kos – Flori, 12. Çminim – Jetësore, 13. Ato që jetojnë nga kamata – Aktori Aflek, 14. Boksieri legjendar Muhamed, - Poezia e dashurisë – Amper, 15. Tina Turner – Kalë shale – Qytet i vjetër në Argolidë, 16. Lëndë djegëse aeroplani – Emri i Balzakut, 17. Bakri – Bëj anim – Kubëz bixhozi, 18. Ato që merren me ushqim – Një shkencë natyrore, 19. Këngë djepi (shq.) – Industria e naftës nga Zagrebi – Ismail Kadare, 20. Mbledhje e nivelit të lartë (shq.) – Bëra me stoli.

## VERTIKALISHT

1. Azot – Kalium – Gjermania – Kapital – Volt – Syprina, 2. Futbollisti shqiptar në Foto – Gjymnastja hungareze Sabo, 3. Aktori i njohur amerikan – Keqtrajtım, 4. Regjisori italian Skola - Të bërit si tjetri (shq.) – Sulltanat në Arabi (shq.), 5. Aktorja Garbo – Aranzhim japonez i luleve – kënd navigacioni, 6. Sëmundje e syrit – Rrallësia (lat.) – L.L.I., 7. Vend ku kalohet – Aktorja e vjetër amerikane Hedi – Roman i Zolës, 8. Shëndetësi – Emër i huaj femre – Syprina, 9. Ish atleti anglez ,Stiv, - Pezmatim i veshit, 10. Bëj kritikë – Jo (ang.), 11. Ritual – Ish boksieri Norton, - Kalori, 12. Energjia – Dru i vendeve të nxehta (shq.) – Intensitet, 13. Pyje – Një muskëtar i Dimës, 14. Aktorja Papas – Skitarja zvicerane Hes.

# Shtojcë 1 PAQJA



## KONCEPTI POLITIK I DEMOKRACISË PËRFAQËSUESE SHQIPTARO – MAQEDONASE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Dr. Nazmi MALIQI

**M**arrëveshja kornizë e Ohrit, në masë të konsiderueshme e ndryshoi kornizën demokratike të sistemit të mëparshëm të vendit. Si pasojë e konfliktit të armatosur të vitit 2001, dhe nën presionin e bashkësisë ndërkombëtare, në marrëveshjen e Ohrit është rivendosur modeli i cili duhet të krijojë paqë ndëretnike, më tepër stabilitet dhe siguri në vend. Me këto ndryshime u krijua rasti, që edhe teoria shoqërore tek ne, të merr hapin me kohën në sqarimin e fenomeneve politike, ekonomike, sociale të sigurisë etj. Kjo marrëveshjeje e pranuar ndërkombëtarisht, me të drejtë njihet si dokument i paqes dhe e kompromisit, me vizion për mirëqenien e qytetarëve të Maqedonisë, si pjesë e dialogimit që jetësoi vlerat diplomatike si kontribut për kthimin e paqes.

Në kohën pas konfliktit, përkaj shumë aktiviteteve diplomatike, dialogimit të përfaqësuesve ndërkombëtar dhe me ata vendor, të dialogimit të udhëheqësve të partive nënshkruese të marrëveshjes së Ohrit (SDSM, PPD, VMRO-DPMNE dhe PDSH), nga përcjellësit e kësaj situatë më 16 nëntor të vitit 2001, mbetet i shënuar disponimi i ndryshëm, i deputetëve që votuan amendamentet për ndryshimin e Kushtetutës së RM-së. Për këtë disponim, të deputetëve dhe udhëheqësve partiak ndaj marrëveshjes kornizë, dëshmojnë edhe raportet e gazetarëve, që ishin prezentë në seancën e ndryshimeve kushtetuese, ku edhe fillon një politikë për ndërtimin e shtetit. E natyrshme do të ishte që ai moment, të ndiqej me një ambient solemn, edhe koncensual, për implementimin kushtetues të një dokumenti që solli paqen, por në këtë rast, atmosfera në sallën e kuvendit, në orën një pas mesnate, për deputetët e përbërjes të VMRO-DPMNE-së, ky ndryshim i kushtetutës u kuptua si moment i pikëllimit. Sa u takon deputetëve të tjerë maqedonas

dhe të gjithë deputetëve shqiptarë dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare, ata e përshëndetën vendimin e kuvendit për miratimin e marrëveshjes kornizë si vendim "historik" dhe si vendim "për paqe dhe pajtim".

### I. Implementimi kushtetues i marrëveshjes së Ohrit

Ndryshimet më të rëndësishme në marrëveshje kanë të bëjnë me: të drejtën e vetos të deputetëve shqiptarë në parlament; decentralizimin e pushtetit; përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë e dytë zyrtare në shtet, statusit më të avancuar kushtetues të shqiptarëve (por jo edhe të barabartë me maqedonasit) si dhe për përfshirjen e drejtë të bashkësive etnike në organet e pushtetit dhe në administratën publike.

Sipas një kronologjie, brenda katër viteve implementues, kjo marrëveshje karakterizohet me ndryshimin e kushtetutës së R.M (në nëntor të vitit 2001), me implementimin e amendamenteve kushtetuese (I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII,

IX, X, XI, XII, XIII dhe XIV), të parapara në aneksin A, për ndryshimin e neneve: 7, 8, 19, 48, 56, 69, 77, 78, 84, 86, 104, 109, 114, 115, 131 të Kushtetutës së RM-së.

Me këto ndryshime kushtetuese u mundësua edhe implementimi i Aneksit B, duke filluar me sjelljen e rregullores së re për punën e parlamentit dhe ndryshimin e ligjeve siç janë: ligji për pushtetin lokal, ligji për financimin e pushtetit lokal, ligji për ndarje territoriale, ligjin për amnisti, ligjin për nëpunësit shtetëror dhe administratën publike (që precizon masat të cilat sigurojnë përfaqësimin e drejtë të bashkësive në të gjitha organet qendrore dhe lokale), ligjin për prokurorin publik, ligjin për gjyqet, ligji për avokatin e popullit, ligji për njësitë zgjedhore, ligji për zyrtarizimin e Universitetit të Tetovës, ligji për përdorimin e simboleve (ku mes tjerash precizon përdorimin e flamurit shqiptarë) etj. Brenda kësaj periudhe pesë vjeçare, mbeti pa u sjellë ligji që ka të bëjë me përdorimin e gjuhëve, ku saktësisht do të definohej përdorimi ligjor i gjuhës shqipe.

Kur bëhet fjalë për shumicën e dyfishtë, me këto ndryshime kushtetuese veçmas vlen të theksohet se, për vendimin për ndryshimin e preambulës të kushtetutës, cilado dispozitë që ka të bëjë me të drejtat e bashkësive etnike, duke përfshirë nenet 7, 8, 19, 48, 56, 69, 77, 86, 104 dhe 109 si dhe për vendimet për plotësime të cilësdo dispozitë të re që ka të bëjë me materien e atyre dispozitave dhe të atyre neneve, që do të jetë e nevojshme të votohet me shumicën prej dy të tretave të votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, në raste e tilla duhet të jetë edhe shumica e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve që pohojnë që i takojnë bashkësisë e cila nuk është shumicë e popullatës në Maqedoni.

Nëse i vështrojmë më përse afërmi funk-





sionimin e shumicës së ashtuqajtur të Badenterit, dhe nëse një parim i tillë kushtetues respektohet me përpikëri, atëherë shihet qartë se kjo është një risi e demokracisë koncensuale funksionale që edhe do të pengon majorizimin ndaj deputetëve shqiptar në parlamentin e Maqedonisë. Kjo shumicë koncensuale bëhet për vendime shumë të rëndësishme, që kanë të bëjnë me interesin e bashkësive nacionale në Maqedoni. Ky interes, mund të shihet në nenin 7 të kushtetutës së RM-së, që precizon përdorimin e gjuhës zyrtare në nivel qendror dhe lokal, ndërsa neni 8 precizon vlerat themelore të rregullimit kushtetues të Maqedonisë. Mandej, përmes nenit 19 ku rregullohet garantimi e lirisë së besimit, neni 48 dhe rregullon materien ku pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë të kultivojnë, të zhvillojnë identitetin dhe veçantitë e bashkësive të tyre dhe për përdorimin e simboleve, neni 69 ka të bëjë me ligjet që drejtpërsëdrejti rregullojnë materien që ka të bëjë me kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale dhe shfrytëzimin e simboleve. Në raste të tilla, kuvendi sjell vendime me shumicën e votave të deputetëve, që janë të pranishëm, ku duhet të jenë të siguruara edhe votat e shumicës së deputetëve, që deklarohen se i përkaasin bashkësive që nuk janë shumicë e popullatës në Maqedoni. Në rast të kontestit, në kuadër të kuvendit kjo marrëveshje do të zgjidhet me ndihmën e komitetit për marrëdhënie midis bashkësive. Duke e pasur parasysh se një komitet i tillë tani për tani, është krejtësisht partiak (dhe veprojnë partiakisht), mund të ndodh që në momente për interesa partiake, jo vetëm që do të

minimizoj por edhe të devolvojë rolin kushtetues të Komitetit. Roli disfunksional i komitetit mund t'i imponohet nëse në përbërjen e tij mungojnë personat me autoritet, nëse mungojnë njerëz të ngritur në pikëpamje arsimore dhe shkencore, nëse mungojnë njerëz të cilat do të jenë mbrojtës të interesave nacionale të bashkësisë së vet etnike. Vlen të shqyrtohet edhe procedura zgjedhore brenda parlamentit, ku rregullon mënyrat procedurale të votimit të shumicës me votat nga numri i përgjithshëm i deputetëve ku duhet të sigurohet edhe shumica e deputetëve që i takojnë bashkësive që nuk janë shumicë. Neni 77 që rregullon materien juridike për zgjedhjen e avokatit popullor me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, ku duhet të jetë edhe shumica e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve që deklarohen se i takojnë bashkësive që nuk janë shumicë e popullatës në Maqedoni. Neni 78 rregullon çështjen e zgjedhjes të komitetit për marrëdhënie midis bashkësive. Ky komitet, në një farë mënyre duhet të luan rolin e një "mini Senati", të cilin e përbëjnë 7 anëtarë nga radhët e maqedonaseve dhe të shqiptarëve dhe 5 anëtarë që janë nga një nga radhët e turqve, vllahëve, romëve dhe të dy bashkësive tjera.



Neni 86 rregullon problematikën shtesë, po ashtu e dalur nga marrëveshja kornizë e Ohrit, që ka të bëjë me Këshillin e Sigurisë së Republikës, duke filluar nga përbërja e tij dhe sidomos me rastin e emërimit të tre anëtarëve, ku kryetari i shtetit do të sigurojë, që Këshilli i Sigurimit, si tërësi të përbajë në mënyrë të drejtë dhe të shprehë edhe përbërjen e popullatës së Maqedonisë. Vlen të sqarohet, së Këshilli i Sigurisë së Republikës së Maqedonisë, duke u bazuar edhe në marrëveshjen e Ohrit, përbëhet nga Kryetari i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Qeverisë, Ministri që i udhëheqin organet e administratës shtetërore nga sfera e sigurisë, mbrojtjes, e të punëve të jashtme, dhe tre anëtarë të tjerë të cilët i emëron Kryetari i Republikës

Sipas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2001, neni 104 rregullon përbërjen e Këshillit Gjyqësorë republikan. Kuvendi zgjedhë 7 anëtarë të tij, ku tre prej tyre do të jenë të zgjedhur me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, nga të cilët duhet të ketë shumicë votash edhe të numrit të përgjithshëm të deputetëve, që deklarohen se i takojnë bashkësisë që nuk është popullatë shumicë në Maqedoni. Por në vitin 2005 u aprovuan amendamentet e reja kushtetuese për ndryshimin e mënyrës të zgjedhjes të gjykatësve dhe të përbërjes të këshillit gjyqësor. Tani, këshilli gjyqësor RM-së, duke u bazuar në amendamentin XXVIII, është në përbërje prej 15 anëtarëve. Tetë anëtarë të këshillit i zgjedhin gjykatësit nga radhët e tyre, prej të cilëve tre janë anëtarë të bashkësive etnike jo maqedonase. Pesë anëtarë të këshillit gjyqësor i zgjedh parlamenti, me shumicë të ndryshme. Nga ata, tre anëtarë të Këshillit, zgjidhen me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm deputetëve, ku duhet të sigurohet edhe shumica e votave të deputetëve që i takojnë bashkësive jo shumicë. Dy anëtarë, i propozon Kryetari shtetit, por, që i zgjedh parlamenti, nga të cilët, njëri duhet të jetë pjesëtarë i bashkësisë jo maqedonase. Për këta anëtarë të këshillit nuk kërkohet shumicë e veçantë në parlament. Në harmoni me amendamentin X, kryetari i Gjyqit suprem në Republikës së Maqedonisë dhe ministri i drejtësisë, sipas funksionit janë anëtar të Këshillit gjyqësor. Me këto ndryshime, duke e avancuar pavarësinë e gjyqeve, këshilli i jepen edhe ingjerenat për zgjedhjen dhe shkarkimin e gjykatësve.

Neni 109 rregullon çështjet rreth zgjedhjes të anëtarëve në gjykatën kushtetuese që e përbëjnë 9 gjykatës. Ku-

vendi zgjedh 6 gjykatës me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve dhe 3 prej tyre zgjidhen me sigurimin e shumicën e votave të deputetëve që i takojnë bashkësisë e cila nuk është shumicë.

Neni 114 që rregullon politikat e pushtetit lokal që sillen me shumicën e votave prej 2/3 të numrit të përgjithshëm të deputetëve, ku duhet të sigurohet edhe shumica e votave të deputetëve, që deklarohen se i takojnë bashkësisë e cila nuk është shumicë e popullatës në Maqedoni. Po ashtu, në këtë nenë rregullohen edhe problematikat që kanë të bëjnë me sjelljen e ligjeve për financim lokal, për zgjedhjet lokale, për kufijtë komunal dhe për qytetin e Shkupit, që sillen me shumicën e deputetëve të pranishëm, ku duhet të jetë edhe shumica e votave të deputetëve të cilët deklarohen se i takojnë bashkësisë e cila nuk është shumicë e popullatës në Maqedoni.

Mungojnë dispozitat kushtetuese për instalimin e demokracisë funksionale përfaqësuese shqiptaro - maqedonase. Duke e analizuar Kushtetutën e RM-së, duke mësuar edhe nga përvojat e që dalin nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit, tani pas 5 viteve, imponohet edhe një rishikim funksional, për një ndryshim të mundshëm kushtetues, që ka të bëjë me shumicën ashtuquajtur të Badinterit, që shteti të karakterizohet me një stabilitet politik, institucional, duke e precizuar demokracinë përfaqësuese shqiptaro – maqedonase, që do të zbatohet me zgjedhjen e kryetarit të parlamentit dhe për zgjedhjen e Qeverisë. Nëse i analizojmë më detajisht procedurat zgjedhore brenda parlamentit, mangësi e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, paraqitet mos konkretizimi i zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, dhe të anëtarëve të qeverisë, ku mungon parimi i demokracinë konsensual, apo parimi i shumicës së ashtuquajtur të Badenterit.

Nëse kemi parasysh faktin, se për shumë çështje që kanë të bëjnë me sjelljen e vendimeve, dhe për zgjedhjen e disa anëtarëve në organe vitale për vendin, edhe qeveria dhe parlamenti duhet të zgjidhen konformë deklarimit të deputetëve që nuk i takojnë popullatës shumicë. Me këto ndryshime, do të ndërpritet praktika në të ardhmen, që nga mandatarit të mos respektohet vullneti i shumicës së votuesve shqiptarë, siç ndodhi në zgjedhjet parlamentare të 5 korrikut të vitit 2006. Kuptohet, sipas kushtetutës aktuale, është e drejtë e pakontestueshme që mandatarit të bëjë zgjedhjen dhe përzgjedhjen e part-



nerëve të koalicionit.

Për hir të dhënies, kuptimin funksional të demokracisë përfaqësuese, përmes legjitimitetit zgjedhor, mund të kërkohet arsyeja, se ku duhet të përfshihen këto propozime për ndryshimin e kushtetutës. Nëse sistemi kushtetues i Maqedonisë i takon demokracisë parlamentare, si shtet unitar, me siguri se alinenë 1 të nenit 90 të kushtetutës që rregullon procedurat, ku kryetari shtetit ka obligim që në afat prej 10 ditëve nga konstituimi i kuvendit, mandatarin për përbërjen e Qeverisë t'ia besojë Kandidatit (një mandatar) të partisë apo të partive të cilët kanë siguruar shumicën në parlament, këtu edhe ndoshta nuk do të gjendej vend adekuat për rregullimin procedural kushtetues të demokracisë përfaqësuese, në mes dy etnive më të mëdha në Maqedoni. Megjithatë, nëse partitë politike dëshirojnë të ruajnë karakterin unitar të shtetit, atëherë kjo problematikë mund të rregullohet me alinenë 3, të nenit 90, ku në mes tjerash precizohet se “Qeverinë, me propozim të mandatarit dhe në bazë të programit, e zgjedh parlamenti me shumicën e numrit të përgjithshëm të votave të deputetëve”, këtu mund t'i shtohet një pjesë e obligimit kushtetues si dispozitë vazhduese, si vijon “për zgjedhjen e

anëtarëve të qeverisë duhet të sigurohet edhe shumica e votave të deputetëve të cilët deklarohen se i takojnë bashkësisë e cila nuk është shumicë e popullatës në Maqedoni”.

Për t'iu shmangur mohimit të sistemit kushtetues unitar me demokraci parlamentare, ose kalimit në shtet federalist, partitë politike në Maqedoni, duhet të mendojnë që në një të ardhmen, të grisin procedurat për ndryshimin e kushtetutës për plotësimin e alinesë 3 të nenit 90, apo për shtimin e një neni të veçantë, ku do të precizonte mënyrën e zgjedhjes të anëtarëve të qeverisë, të cilët edhe ashtu zgjidhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, por do të ishte në dobi të demokracisë funksionale ndëretnike të precizohet edhe sigurimi i shumicës së votave të deputetëve, që deklarohen se i takojnë bashkësisë e cila nuk është shumicë e popullatës në Maqedoni.

Përpos dispozitave kushtetuese për zgjedhjen e qeverisë, sa i përket zgjedhjes të Kryetarit të parlamentit, partitë politike parlamentare duhet më tepër të angazhohen për ndryshimin e alinesë së parë të nenit 67, ku përskaj shumicës së votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, duhet të parashihet edhe domosdoshmëria e sigurimit të votave të deputetëve që deklarohen se i takojnë bashkësisë e cila nuk është shumicë e popullatës në Maqedoni. Ky ndryshim i kushtetutës është mase i nevojshëm, (ku ndoshta edhe do të evitohet ndryshimin e nenit 90), ku edhe duhet të paraqet një realitet të organizimit politik të partive politike të bllokut maqedonas dhe shqiptar, për demokracinë funksionale, që do të krijoj një stabilitet institucional qeveritar të demokracisë përfaqësuese



shqiptaro – maqedonase, që në fillim të konstituimit të parlamentit.

Duhet të pranojmë faktin, se këto iniciative për momentin duken si të parealizueshme, duke u bazuar në disponimet kolicionuse partiake, por megjithatë ndërtimi i ardhmërisë së shtetit nuk duhet të ndërtohet në disponimet apo në interesat momentale partiake. Kup-tohet, se këto ndryshime kushtetuese kërkojnë kohë dhe pjekuri politike, ku përveç angazhimit të partive politike për këto ndryshime, nuk duhet të mungojnë edhe ndihma e shoqatave joqeveritare dhe e ekspertëve të vendit, si dhe sugjerimet dhe ndihma e faktorit ndërkombëtar, të cilët janë të interesuar për një balancim institucional afatgjatë ndëretnik shqiptaro – maqedonas në Maqedoni. Këto ndryshime do të grisinin domethënien e kuptimit të drejtë të kohezionit të brendshëm ndëretnik, për një stabilitet të brendshëm institucional qeveritar. Me këto ndryshime, do të respektohet edhe legjitimiteti zgjedhor

shumicë. Nuk ka vende të garantuara për deputet në parlament dhe Ministria në Qeveri, nëse bashkësitë në zgjedhje të drejtpërdrejta me votat e tyre nuk sigurojnë deputet. (Ligji për njësitë zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve, i sjellur në prill të vitit 2002).

## Mospërfillja e mundshme e partive shqiptare

Me këtë Kushtetutë, mund të ndodh që në të ardhmen, mandatar i partive politike që siguron shumicën në parlament, që mos të përfshijë fare partinë, apo në partitë politike që i tubojnë shqiptarët. Apo mund të ndodhë diferencimi i pakuptimit dhe përçarës brenda shqiptarëve, duke i llogaritur një pjesë të tyre të përshtatshëm dhe të papërshtatshëm, apo të atyre që janë “besnik” për shtetin apo për subjektin politikë që e përbënë shumicën parlamentare të bllokut maqedonas etj. Apo

zgjerruar ose multi etnik që parasheh që të gjitha partitë politike relevante që të ndajnë pushtetin; 2. Reprezentimin proporcional respektivisht modelin proporcional zgjedhor; 3. Raport më të balancuara në mes trupit të ekzekutivit dhe legjislativit. 4. Veto për pakicat për çështje të caktuara që kanë të bëjnë me identitetin, kulturën dhe arsimin e pakicave etj.

Në rrethanat e sotme, me një periudhë të stërzgatur të tranzicionit që po e kalon Maqedonia, parimi i përfaqësimit dhe krijimit të një stabiliteti institucional që do të largonte dozat e servilitetit dhe të politikës korruptive, mund të ndodhë vetëm me avancimin e vlerave demokratike, ku do të ngritje kuptimi për votën e lirë. Edhe pse me keqardhje mund të konstatohet se në elektoratin zgjedhor shqiptar, edhe në zgjedhjet e 5 korrikut 2006 kishte shkelje të rënda ligjore, të cilat u servuan nga udhëheqësit e BDI -së dhe të PDSH -së. Por, këtë çështje mund ta analizojmë në kontekst tjetër. Këto sjellje të politikave elektorale, në shkeljen e vlerave demokratike, me keq përdorime në ditën e votimit, në kutitë e votimit, me sjellje jodemokratike të partive politike shqiptare, duhet të pranojmë faktin se devalvuan pozicionin shqiptar. Por në këtë vështrim anomalitë e tilla nuk janë lëndë e hulumtimit, duke e pasur parasysh se për momentin gjendja faktike tregon një shifër me 27 deputet shqiptar. Një numër të tillë nuk e kemi pasur asnjëherë më parë. Ky numër, po të ishte funksional, për demokracitë parlamentare dikton rregulla për veprimin politik, apo për mbajtjen dhe renjën e qeverisë. Por kjo të detyron të dyshosh se, nëse nuk respektohet gjendja faktike e shumicës së votuese, nëse nuk kuptohen drejt vlerat e pluralizmit partiak për shoqëritë multi-etnike siç është Maqedonia, atëherë mund të pajtohem me analizat e Majkei Lindit, politikolog që përfaqëson dilemën për zhvillimin e demokracisë shumë nacionale, ku me një studim të tij thotë “një shtet i cili nuk është i gatshëm të aplikojë metoda demokratike, siç është për shembull edhe nivelizimi i të drejtave. Atëherë balancin ndëretnik mund ta mbajnë vetëm me metoda jodemokratike”.

## II. Demokracia përfaqësuese në nivelin e vetad-ministrimit lokal



i shprehur përmes vullnetit të votës së lirë në zgjedhjet parlamentare në Maqedoni si shtet multi-etnikë. Nëse nuk ndodhin këto ndryshime kushtetuese, që në njëfarë mënyre është normë dhe dispozitë e demokracisë përfaqësuese, atëherë në një të ardhme do të shtohen iniciativat, apo edhe do të jenë të pashmangshme konceptet për ndryshimin kushtetues për ndarjen e Maqedonisë në dy njësi federale, ku mandej do të vijnë në shprehje modelet, dy shtesore federaliste të qeverisjes.

Këto ide për ndryshime kushtetues, që precizojnë vlerat e demokracisë përfaqësuese, janë edhe më të arsyeshme, kur kemi parasysh përbërjen multi-etnike të Maqedonisë. Duhet të kemi parasysh faktin se me Kushtetutën e Maqedonisë, por edhe në marrëveshjen e Ohrit nuk parashihet mekanizëm mbrojtës, për të siguruar përfaqësimin adekuat të bashkësive të cilat nuk janë

mund të ndodh, që gjatë bisedimeve për krijimin e shumicës parlamentare, ajo parti shqiptare e cila paraqitet me kërkesa më modeste, të jetë edhe pjesë e koçit qeveritar. Kjo situatë e sqaron edhe më tepër arsyen për ndryshime kushtetuese, ku për hir të avancimit të politikave afatgjate pajtuese shqiptaro – maqedonase, duke u bazuar edhe në legjitimitetin zgjedhor, partitë politike duhet të jenë edhe më tepër të nxitura që për zgjedhjen e Qeverisë, me Kushtetutë të parashihet edhe zgjedhja e qeverisë, me sigurimin e shumicës së deputetëve që nuk i takojnë popullit shumicë.

Mendoj se ka nevojë të përkujtohem se, njëzetë vjet para se të gufonin konfliktet e përgjakshme etnike në Ballkan, në librin e tij "Demokracia në shoqëritë pluralë", Liphard, politikolog amerikan propozonte disa elemente të demokracisë konsocionale të cilat e kufizojnë sundimin e shumicës: 1. Koalicioni i

## Roli i Komisionit për marrëdhënie në mes bashkësive në Këshillat e Komunave

Cili është roli i komisionit? Cilat çështje duhet t'i shqyrtojë komisioni? Cila është rëndësia e rekomandimeve të Komisionit për Këshillin e Komunës? Ndër kompetencat më kryesore të Komisionit mund të jenë: Çështjet të ndërlidhura me marrëdhëniet mes bashkësive; Çështjet që kanë të bëjnë me nenin 41, alineja 3 nga Ligji për vetë administrim lokal; përdorimi i shkrimit dhe gjuhës të bashkësive të cilat janë më shumë se 20% dhe më pak se 20%; verifikimi i përdorimit të flamurit dhe stemës së komunës dhe rregullat që kanë të bëjnë me vlerat kulturor nacionale. Për definimin e rolit të komisionit, duhet të analizohet, si është funksionimi struktural i tij. Për këtë komision, mund të vërehet një dozë e konsiderueshme e paqartësisë në definimin e veprimeve dhe mënyrës së propozimit të anëtarëve. Nëse shikohet më përseafërmi legjitimiteti zgjedhor, apo edhe i propozuesve të autorizuar, roli i komisionit për marrëdhënie me bashkësitë vihet në pikëpyetje. Duke e pasur parasysh se një komision i tillë, duhet të ketë vlerë afirmative për komunat që janë multi etnike, nëse i ngritët relevantë përfaqësuese, mund të quhet edhe si "senat i vogël" i cili do në përbërjen e tij duhet të tubojë njerëz me autoritet, njerëz të ngritur në pikëpamje arsimore, njerëz të cilët duhet të kenë autoritet në bashkësitë e veta, për të cilat edhe janë mbrojtës të interesave nacionale.

Nëse i kemi parasysh këta parametra, apo si kritere të cilat duhet t'i plotësojnë anëtarët e komisionit, me të drejtë parashtrohet pyetja, sa anëtarët e tashëm që përfaqësojnë bashkësitë e tyre e posedojnë legalitetin dhe legjitimitetin për t'i mbrojtur interesat kulturore, gjuhësore, nacionale të bashkësisë që e përfaqëson. Me keq ardhje mund të konstatohet, nëse i bëhet një vështrim anëtarëve të komisioneve për marrëdhënie me bashkësitë, për një pjesë më të madhe të tyre mund të vërehet se bëhet fjalë për njerëz partiak të cilët janë propozuar sa për t'i hequr qafe nga kombinatorikat kadrovike. Kjo i ngjan kohës së monizmit, kur bëhej fjalë për komisionet për marrëdhënie ndërnacionale, ku më tepër komisionet e tilla përbëheshin nga njerëz lojal të pushtetit dhe assesit nuk kishte të bëjë për mbrojtjen e interesave të kombit të cilit i përkisnin.

Një dileme të tillë mund t'i i bashkohet dyshimi për propozuesit e anëtarëve të bashkësive të cilat janë më pak se 20%. Bashkësi të cilat nuk janë të përfaqësuar për mes votës së lirë në Këshillat komunale. Parashtrohet pyetja, se kush duhet të propozoj ata anëtar, duke e pasur parasysh se megjithatë ata jetojnë në komunat përkatëse. Në situatë e tilla edhe më tepër mund keq përdorimit legaliteti dhe legjitimiteti propozues por mandej edhe legjitimiteti përfaqësues, të bashkësisë së tyre.

## Komunat me shumicë të konsiderueshme shqiptare

Shembull konkret komuna e Kumanovës. Me Statutin e Komunës, të gjitha komisionet janë të përfaqësuar me nga pesë anëtarë, përjashtim nga kjo praktikë bënë komisioni për mar-

kualitete arsimore dhe kulturore duhet t'i ketë anëtarë i Komisionit.

## Injorimi gjuhësor dhe pasojat?

Në Marrëveshjen e Ohrit saktësisht precizohet se "Lidhur me pushtetin vendor në komunat ku bashkësia e caktuar përbën të paktën 20% (për qind) e popullatës së komunës, gjuha e asaj bashkësie do të përdoret si gjuhë zyrtare, në mënyrë plotësuese maqedonishtja. Në raport me gjuhët, të cilët flasin më pak se 20% (për qind) të popullsisë së komunës, autoritetit lokale në mënyrë demokratike do të vendosin për përdorimin e saj në organet publike".

Mund të merren si shembull Komunat ku shqiptarët janë në numër të konsiderueshëm (mbi 20%) siç janë Kumanova, Buteli, Zeleneikova, Sopsishta, Çash-



redhënie me bashkësitë i cili është me një përbërje prej 11 anëtarëve, prej të cilëve 3 anëtar janë këshilltar komunal, ku edhe menjëherë bëjnë nivelin profesional i Komisionit. Kur kemi përvoja të tilla, ku këshilltar komunal mund të zgjidhen edhe persona të cilat mund të mos kenë kryer as shkollën fillore. Këtë dyshim e vejmë si dilemë edhe pse në rastin konkret të Kumanovës, këta janë njerëz që kanë përgatitje universitare, por nuk është e paraqitur përkatësia e tyre etnike. Ndërsa tetë anëtarëve të tjerë, saktësisht i shkruan përkatësia nacionale, por jo edhe profesioni apo përgatitja arsimore. Kështu, ndodh kur ligjvënësi e ka ngushtuar hapësirën për ekzistimin e propozuesve të autorizuar, edhe vënia më saktë e kriterëve se përveç se të jetë Maqedoni, shqiptar, turk apo përkatësia partiake, edhe cilat

ka, Dolneni etj, dhe të hulumtohet se cili është roli dhe ndikimi i Komisionit për marrëdhëniet me bashkësitë etnike. Duke shqyrtuar një informatë për përdorimin e gjuhëve në Kumanovë, në mes tjera përshkruhen edhe obligimet ligjore për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe shkrimit të bashkësive të cilat janë më tepër se 20%, nga numri i përgjithshëm i banorëve në Komunë. Pason një sqarim, ku në mes tjerash thuhet, "Ligji për vetë administrim lokal e rregullon përdorimin e gjuhëve të bashkësive të cilat nuk janë më pak se 20% por edhe të bashkësive të cilat janë nën këtë census. Ligji është i sjellur në fillim të vitit 2002, ndërsa përdorimi i pjesërisht i përdorimit të gjuhës shqipe fillon (si obligim ligjor) fillon me 18 prill të vitit 2005. Në informatën e lëshuar (mars 2006), si propozim nga Kryetari i Komunës se Kumanovës, ka orvatje të

sqaroj se përdorimi i gjuhës shkrimt shqip të cilën e përdorin më së paku 20% e banorëve të komunës do të filloj pas sjelljes të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Kjo informate e cila edhe mund të vlerësohet edhe si konfuze, të njëjtën nuk e ka shqyrtuar komisioni për marrëdhënie në mes bashkësive në Këshillin e komunës së Kumanovës. Megjithatë e gjithë kjo pakujdesje institucionale ndaj përdorimit të gjuhës shqipe, nuk mund të largojë shqetësimin se në këtë komunë nuk respektohet ligji, apo më konkret, përse nuk zbatohet (neni 90) i Ligjit për vetë administrim lokal. Me një veprimtari të tillë jo kushtetuese, të Prefektit të Kumanovës dhe këshilltarëve në Këshillin komunal, për pengimin e përdorimit zyrtar e ligjor të gjuhës shqipe, nuk vërehet roli i Komisionit për marrëdhënie në mes bashkësive. E gjithë kjo paraqet edhe një pamje të mos durimit apo edhe të urrejtjes ndaj gjuhës shqipe, nëse e kemi parasysh se nuk mund të vërehet asnjë gjurmë e mbishkrimeve, në dy gjuhë, që paraqet obligim ligjor duke filluar prej mbishkrimit në ndërtesën e komunës, apo në ndërmarrjet publike ku themelues është Këshilli komunal i Kumanovës. Edhe mbishkrimet e zyrave të punësuarve në sektorët e Komunës së Kumanovës, që sa vite janë vetëm në gjuhën maqedonase. Këtë anomali në mosrespektimin e Ligjit për vetë administrim, si pjesë e kriterit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit, me pak dallime, vërehet thuajse në të gjitha komunat ku shqiptarët janë me shumicë të konsiderueshme. Edhe më andej mbeten dilemat, sa konsultohet Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë, apo sa është i interesuar ky komision që të mbetet në nivelin e kompetencave të veta. Parashtrahet py-


etja, sa komisioni do të konsultohet në fazën përgatitore për sjelljen të Statutit të komunës. Edhe pse Statuti aktual i Këshillit të Komunës së Kumanovës është sjellur më 30 maj 2003, edhe atëherë nuk është e paraparë përdorimi i gjuhës shqipe. Vetvetiu parashtrahet pyetja, cili ka qenë aktiviteti i partive shqiptare (PPD, PDSH, BDI dhe PDK) të përfaqësuar në Këshillin komunal, çfarë rekomandimi apo mendimi kishte (apo pse nuk ka kurrfarë mendimi) Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë në Këshillin komunal të Kumanovës? Veprimtaria e Komisionit për marrëdhënie me bashkësitë duhet t'i i përcjellë ndryshimet e Statusit të komunave, duhet të rregullojnë lëmit ku komisioni duhet të ketë ndikim, sidomos në sjelljen e vendimeve, rregulloreve të cilat drejtpërdrejt janë të djeshme apo prekin kulturën, përdorimin e gjuhëve, përdorimin e simboleve duhet të jenë edhe si veprimtari e Komisionit. Kupthohet, duhet të gjinden modalitet ligjore që Këshillat e komunave ta praktikojnë procedurat parlamentare, ku komisioni për marrëdhënie me bashkësitë, do të ketë më shumë ndikim, apo vënia në praktikë e demokracisë koncensuale për çështje të caktuara që prek interesin e bashkësive nacionale në komunë. Mënyra se si duhet të propozoheshin anëtarët e Komisioneve për marrëdhënie me bashkësitë shikuar në këtë vështrim, fjalë është për demokracinë përfaqësuese edhe në rrafshin lokal, parashtrahet pyetja a duhet të jetë vetëm Avokati i popullit propozues i përfaqësuesve të grupeve etnike të cilat nuk janë të përfaqësuar në Këshillin e komunës? Duke e pasur parasysh shtrirjen territoriale - regionale të Avokatit të

popullit, dhe duke i vëzhguar përcaktimet kushtetuese për Komisionin për marrëdhënie me bashkësitë në nivel të Parlamentit, një propozim i tillë do të jetë edhe meritore dhe legjitim. Në ndryshimin e statuteve të komunave, sa i përket zgjedhjes të anëtarëve të Komisionit për marrëdhënie me bashkësitë, duhet të parashihet mundësia më e madhe e iniciativa qytetare për zgjedhjen e anëtarëve. Qytetarët edhe deri më tani kanë pasur të drejtë t'i propozojnë iniciativa kryetarit të komunës, Këshillit të komunës të sjellin akte të caktuara, rregullore edhe pse nuk iu është lejuar të propozojnë zgjidhje kadrovike. Duhet të shikohet mundësia që përmes iniciativa qytetare t'i ngritët niveli i interesimit për Komision, duke e pasur parasysh se bëhet fjalë për një komision që mund të jetë mjaftë ndikues për të gjitha proceset edhe në aspekt ndëretnike, në aspektin socio-ekonomik etj. Për një qasje të tillë, për një demokraci të drejtpërdrejt, përsikaj nivelit të interesimit të qytetarëve për këtë komision, do të ngritët edhe legjitimitetin e anëtarëve të Komisionit, kjo ka të bëjë sidomos për anëtarët e komisionit të cilët nuk kanë përfaqësues në Këshillin e Komunës. Edhe pse kupthohet, për çështjet e tjera, iniciativat qytetare janë të parapara dhe të rregulluara më ligj, të cilat më andej precizohen me rregullore, ku edhe parashihet koncenzi 10% i propozuesve të iniciativa nga numri i përgjithshëm i banorëve që kanë drejtë vote. Nëse Komisioni, do të mbetet vetëm në këto detyra që burojnë nga Ligji (edhe këto nuk implementohen në praktikë), atëherë me të drejtë mund të konstatojmë se komisionet e tilla nuk do të jenë funksionale dhe nuk do jenë me

Tabela 1	Gjithsej	%	Meshkuj	Femra
R. e Maqedonisë	2022547	100%	1015377	1007170
Maqedonas	1297981	64,2	648178	649803
Shqiptar	509083	25,2	258195	250888
Turq	77959	3,9	39550	28409
Serb	53879	2,7	27137	26742
Vlleh	9695	0,5	5146	4549
Boshnjak	35939	1,8	18580	17359
Rom	17018	0,8	8634	8384
Të tjerë	20993	1,0	9957	11036

Tabela 2	Ministria e Mbrojtjes		Ministria e punëve të brendshme	
	Numri	% nga numri i përgj.	numri	% nga numri i përgj.
Gjithsej	8147	100,00	13164	100,00
Meshkuj	0	0,00	10318	78,38
Femra	0	0,00	1743	13,24
Maqedonas	6467	79,38	10645	80,86
Shqiptar	1130	13,87	1917	14,56
Turq	100	1,23	74	0,56
Serb	199	2,44	243	1,85
Vlleh	64	0,79	0	0,00
Boshnjak	46	0,56	24	0,18
Rom	49	0,60	83	0,63
Të tjerë	92	1,13	178	1,35

rol ndikues. Me siguri se komisioni në dërvarëshmëri me komisionet e tjera të Këshillit të komunës, duhet të jetë në zgjerim të veprimtarisë monitoruese edhe të çështjeve që kanë të bëjnë me interesat socio-ekonomike të bashkësisë që e përfaqësojnë. Duke e pasur parasysh faktin siç u potencua më lart, komisionet për marrëdhënie me bashkësitë sipas Ligjit kanë të drejtë të japin mendime dhe rekomandime deri te këshilli i komunës, por nuk kanë rol vendimmarrës. Këshilli i Komunës është i obliguar t'i shqyrtojë dhe të vendos në bazë të rekomandimeve të Komisionit, vendimi mund të jetë pozitiv ose negativ. Zakonisht Këshilli duhet t'i i pranoj mendimet dhe rekomandimet e Komisionit, nëse kuptohet si komision relevant që shqyrton çështje të rëndësishme që ka të bëjë me marrëdhëniet në mes bashkësive. Mund të ndodh që edhe Këshilli i komunës t'i refuzoj rekomandimet e komisionit nëse ka argumente bindëse për një çështje të tillë. Me siguri se komisioni për marrëdhënie në mes bashkësive, do të drejtoj edhe rekomandime që kanë të bëjnë me ndërtimin e infrastrukturës rrugore, nevojave arsimore, emërtimi i rrugëve, shkollave, ku iniciativat e tilla mund të jenë implementues për mes Këshillit, ku mandej pason edhe obligimi i Kryetarit të Komunës për zbatimin e rekomandimit, respektivisht vendimeve të këshillit.



### **III. Implementimi i Aneksit C dhe zbatimi i ligjeve që dalin nga Marrëveshja kornizë e Ohrit**

Mos diskriminimi dhe përfaqësimi i drejt, në marrëveshjen e Ohrit precizohet me ligjet, ku precizohen edhe masat me të cilat do të sigurohet përfaqësimi i drejtë i bashkësive në të gjitha organet qendrore dhe lokale publike dhe në të gjitha nivelet e punësimit në këto organe, duke respektuar njëkohësisht rregullat e kompetencës. Me marrëveshjen e Ohrit, sugjerohen që autoritetet do të ndërmarrin aktivitet për ta korrigjuar mos ekuilibrin ekzistues në përbërjen e administratës publike, sidomos përmes punësimit të pjesëtarëve

të bashkësive me përfaqësim të pamjaftueshëm. Një vëmendje e posaçme do t'i kushtohet faktit që të sigurohet sa është e mundur me shpejtë që shërbimet policore në përgjithësi, ta shprehin përbërjen dhe shpërndarjen e popullatës së Maqedonisë, sikurse është theksuar në Aneksin C.

Tani, pas pesë viteve të implementimit të Marrëveshjes së Ohrit, parashtrohet pyetja, sa u ngritë niveli i mirëbesimit reciprok shqiptaro – maqedonas? A mjaftojnë vetëm ndryshimet kushtetuese dhe sjellja e ligjeve apo realizimi i disa pikave nga aneksi C, që të kemi vlerësime reale për besueshmërinë ndërnacionale, për kulturën shtetërore, për kulturën politike, për kulturën për paqen dhe për një stabilitet të qëndrueshëm institucional në Maqedoni. Sa i përket aneksit C, si pjesë

arriti rezultate të dëshirueshme, për përfaqësimin adekuat të shqiptarëve në institucionet shtetërore sipas dinamikës së përparme në implementimin e Marrëveshjes së Ohrit.

Me keqardhje mund të konstatohet fakti, se kësaj marrëveshje i mungoi kompetente ekonomike, që është natyrë e historisë të marrëveshjeve paqësore. Ky hendek ekonomik më së tepërmi hetohet në mungesën, apo në mos rindërtimin e vendeve të përfshira në konflikt dhe në mos risocializimin e invalidëve të luftës, familjeve të dëshmorëve dhe pjesëtarëve tjerë të UÇK-së. Nëse i bëhet një shqyrtim edhe deskriptiv të konfliktit shqiptaro – maqedonas të vitit 2001, shihet qartë se, si produkt i ndërprerjes të luftimeve ishte arritja e “Marrëveshjes Kornizë të Ohrit”, ku përveç tjerash nënkupton që pasojat e konfliktit të jenë të përbashkëta.

Por megjithatë, pjesëtarët e ARM-së me Ligj të veçantë, gëzuan të drejtat sociale, për sigurimin pensional dhe invalidor etj, kurse pjesëtarët e UÇK nuk gëzuan asnjë të drejtë. Pa atyre dhe pa të drejt, mbetet i pa definuar statusi i dëshmorëve të luftës. Nga mos definimin i statusit ligjor, u bë edhe një shkelje flagrante e të drejtave që duheshin t'i gëzojnë familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës me familjet e tyre. Këta familje mbetën në margjinat e shoqërisë.

e Marrëveshjes kornizë të Ohrit, që ka të bëjë me implementimin e masave për ndërtimin e mirëbesimit, mund t'i numërojmë disa aktivitete konkrete: u realizua regjistrimi i popullsisë në vitin 2002, u bë kthimi i refugjatëve dhe u realizua rindërtimi i pjesërisht i vendbanimeve të përfshira në konfliktin e armatosur të vitit 2001. Përveç tjerash në këtë periudhë 5 vjeçare të implementimit të marrëveshjes së Ohrit, u arritën disa rezultate për zhvillimin e pushtetit vendor përmes decentralizimit, duke krijuar aftësi menaxhuese financiare strukturave komunale. U realizuan aktivitete për përfaqësimin e bashkësive në shërbimet policore, në ministrinë e mbrojtjes, në administratën shtetërore, administratën publike dhe në shërbimet publike. Por ky aktivitet nuk

Duke u bazuar në faktin se R.M. është shtet social, ku potencohet mbrojtja sociale e individit dhe familjes, jemi të bindur se është mase nevojshme që të ndërmarrën hapa të rëndësishëm dhe konkret, që t'iu ndihmohet këtyre familjeve, duke e siguruar statusin e tyre me ligj të posaçëm, duke pasur parasysh se ata janë qytetar të R.M. Pjesëtarët e ish UÇK-së si qytetar të RM-së, duhet t'i kenë të drejtat si të gjithë të tjerët për mbrojtje sociale dhe të drejtat e tjera, ashtu si gëzojnë edhe pjesëtarët maqedonas, që ishin të involvuar në formacionet ushtarake dhe policore në konfliktin 2001. Për rregullin ligjor të statusit të pjesëtarëve të UÇK-së, ekziston edhe baza kushtetuese, nëse e njëjta problematikë bazohet në nenin 36 të Kushtetutës së RM. Ndërsa ngjashmëri për lehtësimin e sjelljes të Ligjit

# Shtojca

Tabela 2	Ministria e Financave		Ministria e Ekonomisë		Ministria e buqisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave	
	numri	% nga numri përgj.	numri	% nga numri përgj.	numri	% nga numri përgj.
Gjithsej	3728	100,00	404	100,00	544	100,00
Meshkuj	1733	46,49	219	54,21	319	58,64
Femra	1549	41,55	173	42,82	214	39,34
Maqedonas	3378	90,61	306	75,74	444	81,62
Shqiptar	225	6,04	80	19,80	66	12,13
Turq	31	0,83	6	1,49	9	1,65
Serb	53	1,42	5	1,24	15	2,76
Vlleh	9	0,24	4	0,99	4	0,74
Boshnjak	9	0,24	1	0,25	0	0,00
Rom	14	0,38	0	0,00	1	0,18
Të tjerë	9	0,24	2	0,50	5	0,92

## Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Gjyqësi dhe në Organet e Jurisprudencës (Administratës Gjyqësore)

Tabela 4	Udhëheqës	Professional	Professional administrativ	Të tjerë	Gjithsej	
Maqedonas	103	83,74%	406	88,26%	1690	87,93%
Shqiptar	16	13,01%	34	7,39%	143	7,44%
Turq	0	0,00%	5	1,09%	18	0,94%
Serb	4	3,25%	3	0,65%	17	0,88%
Vlleh	0	0,00%	9	1,96%	23	1,20%
Boshnjak	0	0,00%	2	0,43%	6	0,31%
Rom	0	0,00%	0	0,00%	15	0,78%
Të tjerë	0	0,00%	1	0,22%	10	0,52%
Gjithsej	123	100,00%	460	100,00%	1922	100,00%

## Numri i përgjithshëm i të punësuarve në ndërmarrjet publike

Tabela 6	Udhëheqës	Professional	Professional administrative	Të tjerë	Gjithsej	
Maqedonas	851	87,10%	1503	87,23%	1060	86,17%
Shqiptar	77	7,88%	133	7,72%	1005	8,17%
Turq	7	0,72%	27	1,57%	167	1,36%
Serb	19	1,94%	26	1,51%	262	2,13%
Vlleh	14	1,43%	11	0,64%	57	0,46%
Boshnjak	2	0,20%	7	0,41%	32	0,26%
Rom	0	0,00%	3	0,17%	94	0,76%
Të tjerë	7	0,72%	13	0,75%	84	0,68%
Gjithsej	977	100,00%	1723	100,00%	1230	100,00%

## Numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucionet shtetërore dhe publike

Tabela 3	Udhëheqës	Professional	Professional administrativ	Të tjerë	Gjithsej	
Maqed	6899	84,06%	15818	84,15%	24213	83,27%
Shqiptar	847	10,32%	1928	10,26%	3292	11,32%
Turq	75	0,91%	181	0,96%	301	1,04%
Serb	164	2,00%	392	2,09%	571	1,96%
Vlleh	53	0,65%	163	0,87%	133	0,46%
Boshnjak	31	0,38%	59	0,31%	80	0,28%
Rom	23	0,28%	59	0,31%	156	0,54%
Të tjerë	115	1,40%	198	1,05%	331	1,14%
Gjithsej	8207	100,00%	18798	100,00%	29077	100,00%

## Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve dhe Kryetarëve të gjyqeve

Tabela 5	Kryetar të gjyqeve	Gjykatës	Gjithsej	
Maqedonas	27	81,82%	518	85,90%
Shqiptar	5	15,15%	49	8,13%
Turq	1	3,03%	4	0,66%
Serb	0	0,00%	7	1,16%
Vlleh	0	0,00%	15	2,49%
Boshnjak	0	0,00%	3	0,50%
Rom	0	0,00%	0	0,00%
Të tjerë	0	0,00%	7	1,16%
Gjithsej	33	100,00%	603	100,00%

## Institucionet arsimore dhe institucionet shtetërore

Tabela 7	Shkollat fillore	Shkollat e mesme	Fakultet	Institucionet shtetërore	Gjithsej	
Maqedon	12543	66,16%	5670	78,44%	2497	87,83%
Shqiptar	5331	28,12%	1251	17,31%	169	5,94%
Turq	548	2,89%	112	1,55%	16	0,56%
Serb	174	0,92%	83	1,15%	68	2,39%
Vlleh	61	0,32%	8	0,11%	29	1,02%
Boshnjak	77	0,41%	25	0,35%	5	0,18%
Rom	89	0,47%	38	0,53%	13	0,46%
Të tjerë	137	0,72%	41	0,57%	46	1,62%
Gjithsej	18960	100,00%	7228	100,00%	2843	100,00%

për dëshmorët, për familjet e tyre dhe invalidët e luftës mund të shfrytëzohet edhe Ligji për (i brantelave) pjesëtarët e ARM-së dhe policisë për të drejta e veçanta, që u soll nga Parlamenti i RM-së në vitin 2002, që mandej i njëjti Ligj u plotësua me disa ndryshime në vitin 2005.

Tani pas pesë viteve, me të drejtë vazhdon të jetë brengosja por edhe parash-trohen dilema në mesin e qytetarëve, përse në strukturat qeveritare të partive VMRO - DPMNE – PDSH (2001- 2002) dhe në strukturën qeveritare LSDM - BDI (2002 -2006) mungoi arsyeja e pakontestueshme për implementimin më të shpejt apo edhe të zbatimit të plot të marrëveshjes se Ohrit. Këtë e kërkonin pjesa dërmuese e qytetarëve të Maqedonisë, Këtë e kërkojnë diplomatët me ndikim në qendrat e vendosjes.

Në vazhdim vijojnë disa të dhëna të publikuara për rezultatet e arritura në përfaqësimin e drejt të sipas strukturës etnike (Sektori i Qeverisë së RM-së për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, tetor 2006). Për të pasur një njohuri më të përafërt, për përfaqësim të drejt të bashkësive etnike, do të shërbehemi me pasqyrën statistikore të numrit të dhe përbërjes multi etnike të Maqedonisë, sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë, i realizuar në nëntor të vitit 2002.

Tani në vazhdim, mund të bëjmë një krahasim në mes rezultateve të regjistrimit të popullsisë dhe përqindjes etnike të punësuarve të cilët marrin paga nga Buxheti shtetëror në Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Punëve të Brendshme, në Ministrin e Financave, Ministrin e Ekonomisë, Ministria e Bujqsisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, pushtetin gjyqësor etj.

Për kompletimin e këtij vështrimi, për përfaqësimin e drejt bashkësive etnike, mungojnë të dhënat e disa sektorëve qeveritare dhe në tërësi mungojnë të dhënat e të punësuarve në njësitë e vetadministrimit lokal. Mosbalancimin ndëretnik, që vërehet nga rezultatet e publikuara nga Qeveria e RM-së, apo nga Sektori për implementimin e marrëveshjes së Ohrit (27 tetor 2006), dëshmon për mos implementimin e afateve kohore që autoritetet qeveritare është dashur t'i ndërmarrin aktivitet konkretë, për ta korrigjuar mosekuilibrin ekzistues ndëretnik. Këto dhëna mund t'i krahasoni nga rezultatet e publikuara nga Qeveria e RM-së, Sektori për implementimin e marrëveshjes së Ohrit (27 tetor 2006). Shih tabelat nr. 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Nëse autoritet shtetërore të Maqedonisë i kanë të përpunuara raportet e Komisionit Evropian të nëntorit 2005 dhe

nëntor 2006, dhe nëse tani e kanë të shqyrtim skemën e të punësuarve sipas përkatësisë etnike, nga rezultatet e shënuara në tabelat e paraqitura më lart, shihet çart se përkundër disa rezultateve të implementimit të Marrëveshjes së Ohrit, ngelet shumë punë për ndërmarjen e aktiviteteve konkrete për të korrigjuar mosekuilibrin ekzistues ndëretnik e të punësuarve, atje ku finasimi bëhet nga buxheti shtetëror i RM-së.

## Përfundim

Megjithatë, aktivitetet politike që lidhen me implementimin e Marrëveshjes së Ohrit brenda këtyre 5 viteve, nuk duhet të vlerësohen edhe me tone inkurajuese, për kundër lëshimeve që u potencuan edhe më lartë, duhet të jemi të ndërgjeshëm se kjo periudhë paraqet një histori të begatshme edhe për Maqedoninë dhe qetarët në përgjithësi, me gjithë ato vlera pozitive të stabilitet të brendshëm që ndodhën. Tani në mandatin parlamentar 2006-2010, mbetet që partitë kryesore të koalicionit qeveritar VMRO-DPMNE dhe PDSH, të jenë vazhdes të implementimit të Marrëveshjes së Ohrit. Me ndryshimet për pikëpamjet politike që ndodhën në VMRO-DPMNE pas vitit 2002, me të drejt vlerësohet se përbërja dhe përcaktimet programore të tashme dallojnë nga koha 16 nëntorit 2001, kur ndryshimet kushtetuese të bazuara në amendamentet e Marrëveshjes së Ohrit, kjo parti i kuptoi si pikëllim dhe humbje për Republikën e Maqedonisë.

Kuptohet, sot, pas 5 viteve vazhdon të paraqitet një realitet i ri në Maqedoni për arsyet, por edhe me vështirësitë që mund t'i ketë në të ardhmen me (mos)zbatimin e njëmend të kësaj Marrëveshjeje. Por, duke e pasur parasysh faktin se Maqedonia është me statusin e kandidatit për anëtarësim në BE dhe me perspektivë për pranimin e ftesës për anëtarësim edhe në NATO, harmonizimi madje edhe unifikimi i rregullativave ligjore, dhe ndër shumë çështjet që janë të parapara në standardet për anëtarësim të plot në këto struktura, ndër kriteret prioritare për stabilitetin e brendshëm të shtetit është implementimi dhe zbatimi i plot i Marrëveshjes kornizë të Ohrit.

## Literatura e konsultuar

Giovanni Sartori, Edhe njëherë për teorinë e demokracisë, Dituria, Tiranë, 2006  
Nikolas O'Shonesi, Fenomenot na Politickiot marketing, Sovremena administracija, Shkup, 1994  
Husamedin Feraj, Shkenca politike, PEGI, Tiranë, 2004  
Glen Tinder, Mendimi Politik, Shtëpia

botuese enciklopedike, Tiranë, 1993  
Rufi Osmani, Mendimi Alternativ politik dhe ekonomik, Gostivar, 2006  
Përmbledhje studimore: Te drejtat e njeriut si vlerë demokratike, Shoqata e intelektualëve shqiptar "Klubi Demokratik" Shkup dhe Fondacioni Fridrix Ebert, Shkup, 2003  
Përmbledhje studimore, Menaxhmenti politik, Fondacioni Friedrich Ebert, Shkup, 2003  
Përmbledhje studimore: Prventiva e konflikteve, Inicijativa za gradewe mir i demokratija, Shkup, 2004  
Nazmi Maliqi, Disertacioni i doktoraturës "Pribli'uvawe na R. Makedonija kon NATO", Instituti për ulumtime sociologjike dhe juridiko – politike, Universiteti " Kirili dhe Metodi" Shkup, nëntor 2003  
Arend Liphard, Demokratijata vo pluralnite opshtestva, Sovremena Administracija, Shkup, 1994

## Dokumentet burimore:

Kushtetuta e R. M. Studentski zbor, Shkup, 2002 I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII i XVIII, JP "Slu`ben vesnik na RM", 2002, Skopje;  
Marrëveshja Kornizë e Ohrit (13 gusht 2001)  
Ligji për vetadministrim Lokal, "Slu`ben vesnik na RM", Gazeta zyrtare e R.M. 5/2002, Shkup, 2002  
Me Ligjin për mbrojtje („Gaz.zyrtare e Republikës të Maqedonisë„, nr. 42/01, 5/03 dhe 2006  
Ligji për punë te brendshme, "Su`ben vesnik na RM" , Shkup, 2006  
Strategjia e reformave në sisemin e Jurispodencës, Ministeri për drejtsi, Shkup, nëntor, 2004  
Ligji për nën punësit shtetëror, Slu`ben vesnik na RM, br.59/2000; 112/2001 i 34/2001  
Qeveria e RM-së, Programi vjetor nacional për antarësimin e Maqedonisë në NATO, 2005  
Ligji për shërbim ne ARM, "Slu`ben vesnik na RM" nr. 62/2002, Shkup  
Reformat në gjyqësi, Shoqata për tolerancë qytetare dhe bashkëpunim (Prilep) 2005)  
Qeveria e RM-së, Nacionalna koncepcija za bezbednost i odbrana, "Slu`ben vesnik na RM" br. 40/23 juni 2003, Skopje  
Marrëveshjet: Republika e Maqedonisë dhe NATO-s (1998-2002)  
Raportet e Komisioni të BE-së, nëntor 2005 dhe nëntor 2006  
Dokumentet themelore të OKB –së dhe Dokumentet themelore të OSBE-së  
Qeveria e RM-së, Nacionalna strategjija za integracija na Republika Makedonija vo Evropskata Unija, Skopje, mart, 2004;

# Shtojcë 2 PAQJA



## Armiqtë e shqiptarëve: Në kërkim të themelit të politikës

Fqinjët tanë janë smirëzinj vetëm ndaj faktit që ekzistojmë. Ata kërkojnë të na e grabisin mendimin e ekzistencës sonë. Le të mendojmë dhe të punojmë për vete dhe të mos ketë asnjë ndryshim midis toskëve dhe gegëve, ne jemi të gjithë shqiptarë dhe duhet të formojmë një Shqipëri të bashkuar. - Abdyl Frashëri

Do të ishte qesharake të besosh se një popull i pambrojtur ka veç miq dhe një llogaritje e çmendur të supozosh se ndoshta armiku mund të mallëngjehet nga mungesa e qëndresës - Karl Shmit

Enis SULSTAROVA

### Një përkufizim i politikës

Karl Shmiti në esenë "Koncepti i politikës", shkruan se kategoritë themelore politike janë "miku" dhe "armiku" dhe thelbi i sjelljes politike të një kolektivi njerëzor është dallimi midis miqve dhe armiqtë (Schmitt, 1996: 26). Ai arrin në këtë përfundim duke e veçuar sferën e politikës nga sfera të tjera të veprimtarisë njerëzore, pikësëpari morali, estetika dhe ekonomia. Për përcaktimin e armikut të tij, një kolektiv nuk nisat nga karakteristikat morale, apo estetike të armikut, ose thjesht nga interesi ekonomike, armiku as nuk përcaktohet nga ndonjë i tretë neutral. Armikun e njohim atëherë kur ndjejmë se ai është ekzistencialisht i huaj për ne dhe se, në

rastin më të skajshëm mund të angazhohemi në luftë kundër tij. Pra, armiku zbulohet në rrethana konkrete prej pjesëmarrësve: Vetëm pjesëmarrësit aktualë mund ta njohin, kuptojnë dhe gjykojnë në mënyrë të saktë rrethanën konkrete dhe të vendosin mbi rastin e skajshëm të konfliktit. Secili nga pjesëmarrësit është në pozitën për të gjykuar nëse kundërshtari i tij ka për qëllim të mohojë mënyrën e jetesës së tjetrit dhe prandaj ai duhet ta zbrapsë apo luftojë atë me qëllim që të ruajë trajtën e vet të ekzistencës (po aty: 27).

Shmiti nuk e ka fjalën për armiq vetjakë, por për armikun publik, atëherë kur "potencialisht një kolektiv luftarak njerëzor përballet me një kolektiv të ngjashëm" (po aty: 28). Në përballjen e mundshme me armikun lindet politika. Politika nuk ka për qëllim luftën, por

mundësia e luftës shkakton mendimin dhe sjelljen politike, sepse nga "kjo mundësi më e skajshme jeta njerëzore merr tensionin specifik politik" (po aty: 35).

Atëherë kur njerëzit shtyhen prej rrethanave në një pozitë kur ndoshta do t'u duhet të japin jetën e tyre apo të marrin jetën e armikut, pikërisht grupimi i tyre me të ngjashmit për të zbrapsur rrezikun e përbashkët i jep përmbajtje politike sjelljes së tyre dhe institucioneve që ata themelojnë, d.m.th. shteteve. Në këtë mënyrë politika ka përparësi ndaj ligjshmërisë dhe kjo e fundit bazohet mbi vendimin politik që merret në rrethanën e jashtëzakonshme kur ligjet janë të pezulluara.

Mundësia e konfliktit me armikun zbulon natyrën e kolektivit, sepse pyetja "kush jemi ne?" (miqtë) gjen përgjigje nëse arrijmë t'i përgjigjemi pyetjes tjetër: "Për cilat bindje jemi gati të vdesim?" (Valk, 2002: 43). Nëse mendimtarë të tjerë me "miq" kuptojnë atë grupim të njerëzve që me anë të arsyes kërkojnë të zbulojnë të Mirën, apo arritjen e rendit shoqëror më të drejtë, "miqtë" e Shmitit grupohen për një shpallje të ekzistencës së tyre si kolektiv (po aty: 50).

### Lidhja e Prizrenit si shfaqje e kombit shqiptar

Ideja e kombit shqiptar kishte kohë që artikulohej prej intelektualëve, më së shumti nëpër kolonitë e shqiptarëve dhe të arbëreshëve, por hera e parë kur kombi shqiptar u shfaq si një kolektiv politik në trojet etnike shqiptare ishte Lidhja e Prizrenit. Nënshkrimi i Traktatit të Shën-Stefanit tregoi se Perandoria Osmane nuk ishte më në gjendje të ofronte mbrojtje të trojeve shqiptare. Përballë rrezikut të sulmit sllav në veri dhe lindje dhe paraqitjes së pretendimeve greke në jug, shqiptarët nisën të vetë organizoheshin për mbrojtje. Thirrja e Kongresit të Berlinit nga Fuqitë e Mëdha të Evropës u dha kohë shqiptarëve dhe mundësi që të paraqisnin edhe ata mendimet dhe kërkesat e tyre mbi ndryshimin e kufijve evropianë të Perandorisë. Fiset e veriut kishin nisur tashmë të lidheshin me njëri-tjetrin përballë përparimit të ushtrive serbe dhe malazeze (Skëndi, 2000: 44), mirëpo rrezikimi njëherazi i të gjithë popullsisë shqiptare në kufi me shtetet ballkanike i bashkoi për herë të parë shqiptarët në një kolektiv për të përballuar armiqtë e tij. Noël Malkolmi mund të ketë të drejtë kur shkruan se shumica e krerëve të fiseve dhe krahinave që u mblodhën në Prizren më 1878 e shihnin mbledhjen e tyre veçse si një zgjatim të kuvendeve të mëparshme ndërfishnore për të shuar gjakmarrjet dhe mbrojtur lirinë



e tyre ndaj rrezikut të jashtëm dhe se pak prej tyre kishin dijeni mbi planet nacionaliste të Komitetit të Stambollit (Malcolm, 1998: 219), mirëpo ata në atë ditë ishin grupuar në kërkim të miqve sepse e ndjenin kërcënimin e ekzistencës së tyre. Me anë të kundërshtimit të armiqve, tashmë shqiptarët kishin filluar të artikulonin idenë e kombit, si një kolektiv i vetëm përballë kolektivëve të tjerë, kombin si një “miqësi politike” të shqiptarëve.

Le të shohim disa prej dokumenteve të hartuar prej udhëheqësve shqiptarë në prag dhe gjatë Lidhjes së Prizrenit. Përfaqësuesit e popullsisë shqiptare të Shkodrës, Podgoricës, Shpuzës, Zhabjakut, Tivarit, Ulqinit, Grudës, Kelmendit, Hotit dhe Kastratit i dërgojnë nga qyteti i Shkodrës më 08.05.1878, një protestë ambasadorit francez në Stamboll, ku midis të tjerash shënojnë:

Fqinjët tanë malazezë, me anë të sulmeve të vazhdueshme kundër qyteteve tona na kanë detyruar prej shekujsh të jetojmë në gjendje mbrojtjeje të përherëshme dhe nëpërmjet veprimeve të tyre të egra kanë bërë që të mos kemi asnjë lloj sigurie. Ne katolikët dhe myslimanët, vëllezër që prej shekujsh dhe që jetojmë në bashkësi interesash e zakonësh, kemi qenë gjithnjë të bashkuar për t'u rezistuar akteve të kusarisë [të malazezëve] dhe kemi derdhur lumenj gjaku për të mbrojtur qytetet dhe fshatrat tona...Shkurtimisht, ne e shohim rrezikun që na kërcënon dhe sa të vdesim nesër të poshtëruar dhe të skllavëruar, pëlqejmë të asgjësohemi sot duke mbrojtur nderin dhe lirinë tonë, prandaj kemi vendosur të mos biem në skllavërinë e Malit të Zi (Pollo & Pulaha, 1978: 12-13). Në një protestë tjetër drejtuar Kongresit të Berlinit më 15.06.1878 nga popullsia e Podgoricës, Shpuzës, Zhabjakut, Grudës e Kuçit theksohet dallimi që ekziston midis vendasve dhe malazezve: “...nën presionin që i bëri Rusia shtetit të lartë osman, madhëria e tij padishahu ynë, u detyrua që të na lëshojë nën sundimin e malazezve barbarë, të cilët qysh prej katër shekujsh janë armiqtë tanë” (po aty: 30). Armiqësia e shqiptarëve shprehej edhe ndaj serbëve e bullgarëve. Popullsia e Prizrenit më 24.05.1878 i shkruan ambasadorit francez në Stamboll: Në të gjitha viset e vendit tonë ose të fqinjëve, që janë pushtuar, serbët e bullgarët kanë shkatërruar dhe kanë marrë nëpër këmbë siç nuk është parë më parë kurrë ndonjëherë, pasuritë tona, shtëpitë tona, fëmijët tanë dhe nderin tonë...prandaj do të ishte një veprim jonjerëzor dhe i padrejtë që në



t'i lihemshim [në dorë] një qeverie dhe një administrate sllave dhe bullgare, të cilat nuk kanë asnjë afri me ne dhe kanë treguar [me kohë] armiqtë e tyre (po aty: 16).

Nëse në citimin e mësipërm shkruesit e protestës nuk pranojnë asnjë qeveri që “nuk kanë asnjë afri me ne”, në protestën e shqiptarëve të Stambollit drejtuar Kongresit të Berlinit kundër pretendimeve territoriale greke, flitet në emër të kombit shqiptar si një subjekt, si një kolektiv i dallueshëm qartë prej kolektivëve të tjerë dhe me një atdhe integral: Ne protestojmë kundër copëtim-it të atdheut tonë të dashur. Humbja e vendeve aq të shtrenjta për qenien tonë kombëtare, si Janina, Narta dhe Preveza, nuk do të jetë për ne përveç një dënimi me vdekje. Ne do të pranojmë më mirë të vdesim bashkë me gratë dhe me fëmijët tanë se sa të nënshtrohemi. Populli shqiptar është i vendosur të ngrihet si një trup i vetëm, kundër lëshimit qoftë edhe të një pëllëmbë toke të vendlindjes (po aty: 37- 38).

Ndër vendimet e para të Lidhjes së Prizrenit ishte shpallja e një bese të përgjithshme që ndalonte gjakderdhjen mes shqiptarëve dhe përqendronte vëmendjen dhe energjitë e tyre ndaj armikut të jashtëm (Myzyri, 1994: 100; Skëndi, 2000: 46). Një interpretim të kohës për këtë besë na e jep Sami Frashëri në artikullin e botuar më 05.07.1878 në shtypin e Stambollit: Ata kanë marrë vendim të prerë dhe njëri-tjetrit i kanë dhënë besën se [në rast pushtimi] do të luftojnë për të çliruar atdheun derisa të mos mbetet qoftë edhe një njeri i vetëm. Madje kanë hapur edhe listat në të cilat

po regjistroheshin të gjithë ata që janë të armatosur.

Po ashtu kanë hequr dorë nga hasmëritë e vjetra e nga gjaqet që kishin mes veti dhe janë pajtuar të gjithë me njëri-tjetrin (S. Frashëri, 2000: 98).

Nga ky citim kuptojmë se bëhet fjalë për një mobilizim dhe përgatitje të ethshme për luftë kundër armikut dhe besa është shpallur si një mjet paqtimi brendashqiptar në funksion të luftës së mundshme. Sipas Kristo Frashërit, mbledhja e parë e Lidhjes më 10.06.1878 mori katër vendime të rëndësishme. Besa e përgjithshme vinte e treta, ajo paraprihej nga vendimi që të njoftohej Kongresi i Berlinit me anë të një peticioni popullor që asnjë shteti të huaj nuk do t'i jepej asnjë pëllëmbë tokë, nga vendimi për ngritjen e një fuqie të armatosur nën komandën e Lidhjes dhe pasojë nga vendimi për barazinë politike dhe juridike të mbarë shqiptarëve, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare (K. Frashëri, 1997: 92-93). Mendojmë se besa luan në këtë rast një rol qendror si një mekanizëm ndërmjetës për shfaqjen e subjektivit politik shqiptar. Në malësitë shqiptare besa rregullonte marrëdhëniet shoqërore fisnore dhe ndërfisnore. Në fillim mbledhja e krerëve në Prizren u quajt “besëlidhje”, pra një bashkim fisesh kundër armikut të jashtëm, përpara se të merrte më vonë emërtimin “Lidhja Shqiptare” (Omari & Luarasi, 1997: 76), si pasojë e shtrirjes së besës në të gjitha krahinat shqiptare. Gjithashtu barazia politike e juridike e të gjithë shqiptarëve e ka burimin te tradita e besës, e cila në të drejtën zakonore të viseve të veriut “nuk i përkiste një kaste

të vogël kalorësish, një elite, por ishte një institucion që zbatohet gjerësisht në jetën e popullit” (po aty: 13). Besa kësh-tu vendoste atë barazi politike mes shq-iptarëve që në shtetin modern sigurohet me anë të konceptit të “qytetarit”. Besa e përgjithshme e Lidhjes në funksionin e një armëpushimi të gjakmarrjeve e grindjeve vetjake shënon për herë të parë shqiptarët si subjekt politik përballë armiqve, ajo ndan sferën e brendshme (të paqes dhe rendit) prej asaj të jashtme (të luftës dhe kaosit) si edhe sferën private (gjakmarrjet dhe mosmarrëveshjet vetjake e fisnore) prej asaj publike (shqiptarët si kolektiv). Gjithashtu besa shënon edhe atë që Shmiti e quan “gjendje e jashtëzakonshme”, me fjalë të tjera pezullimin e ligjeve dhe normeve që rregullojnë jetën e zakonshme si pasojë e shfaqjes së një kërcënimi të

e fundit kërcënon atributet e subjektit dhe jo vetë subjektin. Kur ekzistenca e subjektit si i tillë kërcënohet, atëherë kemi të bëjmë me gjendje të jashtëzakonshme (Lazar, 2006: 259). Gjendja e krijuar pas Traktatit të Shën-Stefanit për Portën e Lartë ishte urgjente, sepse viheshin në dyshim zotërimet e saj në Ballkan, por jo vetë Perandoria si subjekt, përderisa Perandoria ishte nënkruese e Traktatit dhe u ftua të merrte pjesë në Kongresin e Berlinit. Ndërsa shqiptarët e interpretuan si gjendje të jashtëzakonshme, sepse, siç e pamë te protestat e tyre, pushtimi i tokave të tyre nga shtetet ballkanike ishte çështje ekzistenciale e kombit. Përballë armiqve, Lidhja e Prizrenit afirmoi kombin shqiptar si subjekt. Marrëdhëniet e Lidhjes së Prizrenit me Portën e Lartë ishin të ndërlikuara.

nënkuptojnë respektimin e ligjeve në fuqi. Interesant është thirrja e parimeve të sheriatit për të garantuar jetën dhe pasurinë e të gjithë shqiptarëve jomyslimanë në emër të vëllazërimit të përgjithshëm përballë armiqve të njëjtë (po aty: 104-121).

Në të gjithë veprimtarinë e saj, Lidhja e bënte dallimin midis shqiptarëve dhe osmanëve, apo turqve. Për të dhënë një shembull, Lidhja Shqiptare në Gjirokastrë në gusht të vitit 1880 merr vendimin se në rast se turqit ua lëshojnë tokat shqiptare grekëve, atëherë do të formonte një qeveri provizore. Nëpunësit e administratës aktuale osmane do të liheshin në punë vetëm në qoftë se ishin shqiptarë, pa dallim feje (Pollo & Pulaha, 1978: 112). Me fjalë të tjera, do të zbatohet parimi nacionalist që të qeverisurit duhet të kenë të njëjtin identitet me ata që qeverisin. Organet e Lidhjes vepronin paralelisht me ato osmane, në disa vende duke i zëvendësuar krejt këto të fundit. Në fazën e fundit të Lidhjes kur u shpall autonomia dhe u formua qeveria e përkohshme, ndaj osmanëve u kalua në veprime të hapura armiqësore, si ndaj pushtuesve fqinjë. Kjo erdhi si pasojë e dorëzimit të Ulqinit Malit të Zi, ku vullnetarët shqiptarë u përleshën me ushtrinë e Dervish Pashës. Taksat mblidheshin për llogari të Lidhjes dhe në vilajetin e Kosovës u ngritën gjykatat shqiptare që përdornin sheriatin dhe jo legjislacionin në fuqi osman. Parapëlqimi i sheriatit prej gjykatave shqiptare nuk duhet parë si parapëlqim fetar, sepse me sheriat kuptohet sistemi i vjetër ligjor osman, përpara reformave përqendruese të Tanzimatit, i cili lejonte trajtat e autonomisë vendore dhe në këtë rast “ka rëndësi fakti se ‘sheriat’ nuk u zbatua në interes të Perandorisë Osmane, por të revolucionit çlirimtar” (K. Frashëri, 1997: 379).

Lidhja u kujdes që të mos hynte në konflikt me të gjithë armiqtë në të njëjtën kohë. Për sa ishte e mundur dhe meqenëse interesat e dy palëve përputheshin, Lidhja nuk dëshironte përballjen e hapur me Portën. Nisur nga kjo rrethanë dhe të tjera pas saj në historinë moderne të shqiptarëve, Hysamedin Feraj nxjerr parimin themelor të politikës shqiptare:

...shqiptarët asnjëherë nuk janë ndodhë në situatë ekzistenciale historike për të zgjedhur ndërmjet së mirës dhe të keqes, por vetëm ndërmjet të keqes dhe me të keqes: kush angazhohej për “të mirën”, çlirimin nga të gjithë pushtuesit, sunduesit, armiqtë hynte në aventurë politike që kërcënonte ekzistencën



jashtëm. Shmiti thotë se “sovrani është ai që vendos mbi të jashtëzakonshmen” (Schmitt, 2005: 5) dhe kjo duhet kuptuar se sovrani vendos se kur ekziston gjendja e jashtëzakonshme dhe se çfarë duhet bërë për ta eliminuar atë (po aty: 7). Me besëlidhjen e tyre në Prizren, krerët shqiptarë tregonin se diçka e jashtëzakonshme po u ndodhte të gjithë shqiptarëve dhe se u takonte së pari atyre të vendosnin se si duhej zgjidhur kjo rrethanë dhe jo Portës së Lartë. Lidhja e Prizrenit po merrte përsipër atributet e sovranit, që deri atëherë i takonin Sulltanit. Besa e përgjithshme i anashkalonte institucionet e shtetit osman ndërkohë që bashkonte në një kolektiv shqiptarët, gegë a toskë, myslimanë a të krishterë qofshin. Këtu duhet shënuar se Shmiti gjendjen e jashtëzakonshme e dallon prej gjendjes së urgjencës. Kjo

Kur morën vesh për pranimin nga ana e shtetit osman të lëshimeve të territorëve shqiptare, popullata e zemëruar e Prizrenit i vuri Portës vulën e tradhtisë (Shpuza, 2000: 82). Nga ana tjetër duke i pasur duart e lidhura, Porta e Lartë e nxiti mbledhjen e krerëve shqiptarë në Prizren, duke dashur t'i jepte asaj një karakter islamik. Për këtë shkak shpeshherë argumentohet se dokumentet e para të Lidhjes, Kararnameja (Vendimet) dhe Talimati (Urdhëresat) kanë përmbajtje pro-sulltanore e islamike, jo kombëtare shqiptare. Në fakt një analizë e vëmendshme e këtyre teksteve brenda kontekstit të zhvillimeve të kohës, arin në përfundimin se në to interesat e Portës paraqiteshin dytësore përballë interesit për të mbrojtur trojet etnike prej pushtimit të fqinjëve dhe se referimet te sheriat

e shqiptarëve; kush bashkohej me më të keqen, me pushtuesin sundimtarin, armikun më të rrezikshëm kundër armikut më pak të rrezikshëm, po ashtu kërcënonte ekzistencën e shqiptarëve. E mirë mbetej vetëm angazhimi për “të keqen” më të vogël: bashkimi me pushtuesin sundimtarin më pak të rrezikshëm kundër armikut më të rrezikshëm, e pastaj çlirimin edhe prej tij. Kjo situatë ekzistenciale politike e shqiptarëve si qenësues politik përbën metafizikën, parimin fillestar, arhenë në të cilën mund të nxirren të gjitha parimet e tjera për shpjegimin situacionalist të politikës shqiptare (Feraj, 1998: 86-87).

Ajo që thekson Feraj është se sapo shqiptarët e bënë zgjedhjen midis miqve dhe armiqve në një rrethanë reale ku kërcënohej ekzistenca e tyre, duke u shfaqur kështu si një kolektiv politik, ata duhej të zgjidhnin edhe midis armikut dhe armikut. Këtë dilemë ai e quan “metafizika politike shqiptare”. Me fjalë të tjera mund të shprehemi se në Lidhjen e Prizrenit u bë dallimi midis “miqve” (kombi shqiptar), “mikut të përkohshëm” (Porta e Lartë, për sa kohë që ajo kishte armiq të përbashkët me shqiptarët) dhe “armikut” (shovinistët fqinjë). Dyzimi i Lidhjes për qëndrimin ndaj “mikut të përkohshëm” ishte një nga arsyet e shkatërrimit të saj. Kuvendi i Lidhjes në Dibër më 20.10.1881 doli me dy rezoluta drejtuar Sulltanit. Krahu i moderuar kërkonte prej Sulltanit një vilajet të vetëm me autonomi të kufizuar, kurse krahu radikal kërkonte me një ton paralajmërues krijimin e vilajetit shqiptar me autonomi të gjerë. Radikalët kërkonin edhe formimin e një qeverie të përkohshme, diçka që i dukej e pamundur krahut të moderuar (K. Frashëri, 1984: 284-285; 1997: 372). Pas dorëzimit të Ulqinit dhe shpalljes së qeverisë shqiptare, ushtritë osmane e shtypën Lidhjen dhe arrestuan shumë prej krerëve të saj. Megjithatë, Lidhja e Prizrenit mbeti si pikë referimi e politikës kombëtare shqiptare.

### **A janë shqiptarët subjekt politik?**

Shqiptarët shpallën pavarësinë nga Perandoria Osmane, por shtetet ballkanike dhe Fuqitë e Mëdha e reduktuan shtetin shqiptar në një hinterland për të mbrojtur portet e Adriatikut e të Jonit. Copëtimi i trojeve etnike solli problemin e qenësimit të kombit shqiptar si subjekt politik. Karl Shmiti thotë që një popull të ekzistojë në sferën politike duhet që ai të jetë i aftë, qoftë në rrethana të skajshme, ta bëjë vetë dallimin


midis miqve dhe armiqve: “atëherë kur ai nuk e ka më kapacitetin ose vullnetin ta bëjë këtë dallim, ai pushon së ekzistuari politikisht” (Schmitt, 1996: 49). Mund të mendohet se për shqiptarët nën pushtim nuk do të kishte dyshime në përcaktimin e armikut, me të cilin në rastin e skajshëm do të shkohej në konflikt, por kjo nuk mund të merret gjithmonë si e dhënë. P.sh. elita politike shqiptare në ish-Jugosllavi gjatë shpërbërjes së federatës tregoi pavendosmëri në përcaktimin e qartë të kërkesës poli-

një republikë shqiptare në Jugosllavi, e nëse nuk do të ketë Jugosllavi, atëherë do të ketë Shqipëri edhe për shqiptarët në Kosovë! Fort bukur! Mirëpo për cilin opsion duhet luftohet? (Hoti, 1996: 142; kursivi ynë). Ajo që do të thotë Hoti është se shqiptarët nuk po vepronin si subjekt politik, si një kolektiv, por po përshtateshin ndaj rregullimeve institucionale që i përcaktonin subjektet e tjera politike. Edhe pas luftës së viteve 1998-1999, elita politike shqiptare në Kosovë duket se republikën e pret



tike së cilët shqiptarët do t'i përmbaheshin me çdo kusht. Ukshin Hoti pak më vonë do të shkruante: Partitë politike në Kosovë i artikulonin qëllimet politike kryesisht përmes shprehjeve në kondicional: “në qoftë se”, “nëse” dhe “po që se...atëherë”. në qoftë se p.sh. do të ruhet integriteti territorial i Jugosllavisë, atëherë do të luftohet për një republikë të barabartë sovraane në Jugosllavi; në qoftë se do të lejohej prishja e kufijve të brendshëm, atëherë do të luftohet për

dhuratë nga të tjerët, Beogradi dhe faktorët ndërkombëtarë, kur dihet se i pari kurrë nuk do të pranohet vullnetarisht të heqë dorë nga Kosova dhe se faktorët ndërkombëtarë do të detyrohen kësaj të marrin parasysh vullnetin e tij. Adem Demaçi qysh në fillimet e viteve 1990 paralajmëronte: “Bota sheh a janë më të gatshëm shqiptarët të flijojnë për lirinë e tyre, apo serbët për t'i mbajtur të okupuar këta dhe po shohim se më të vendosur janë serbët” (cituar nga



Baleta, 1995: 7). Megjithëse u betuan e u stërbetuan se statusin e Kosovës do ta vendosnin brenda vitit 2006, ndërkom-bëtarët e shtynë vendimin dhe nuk ka asnjë siguri se nuk do ta shtyjnë përsëri. Ministri i jashtëm i Serbisë këtë shtyrje e brohoriti si fitore për Serbinë. A ka ndonjë fuqi politike në Kosovë që ta brohorasë si fitore të shqiptarëve?

A e ka ndihmuar shteti shqiptar subjektifikimin politik të kombit? Nga vetë pozita e dobët, për pjesën më të madhe të ekzistencës së vet, Shqipëria e ka patur të pamundur t'i deklaronte shtetet fqinje "armiq konvencionalë" të shqiptarëve, sipas termit të Shmitit (Slomp, 2005: 508-509). Ruajtja me çdo kusht e paqes me fqinjët është parë si kusht themelor për ruajtjen dhe fuqizimin e shtetit shqiptar, më mënyrë që kur të vinte çasti i përshtatshëm, ky i fundit të vepronte si subjekt për zgjidhjen e çështjes shqiptare, ashtu si shteti

i Piemontit ndihmoi për bashkimin e Italisë. Më qartë këtë argument e ka paraqitur Mitat Frashëri më 1921, në trajtën e disa tezave:

"1. Kosova asht tokë shqiptare; 2. Kosova nuk e shpëton Shqipërinë, Shqipëria e shpëton Kosovën; 3. Pra, ne dim me shpëtue Kosovën, duhet ma par me forcue Shqipërinë, se anija do nji hu që të lidhet; 4. Për me forcue Shqipërinë duhet që të ketë paqe; 5. Për me pas paqe, duhet me jetue mirë me fqinjët; 6. E shoh një punë kriminale me u dhanë kosovaret shpresë të kotë dhe me i marr në qafë; 7. Duhet me i bindë kosovarët si me jetue urtë e me ruejtë interesat e tyre në rrugë të nomit [ligjit]" (M. Frashëri, 1997: 279-280).

Mirëpo shteti shqiptar deri tani nuk ka qenë në gjendje ta luajë rolin e Piemontit dhe për këtë është kujdesur politika e fqinjëve tanë, të cilët nëse nuk bien në një mendje mbi ndarjen

e Shqipërisë, ishin në një mendje që shteti shqiptar duhet mbajtur përherë i dobët. Nëse Mitat Frashëri ishte i sinqertë në shpresën e tij se Shqipëria një ditë do të vepronte si subjekt politik shqiptar, tezat e tij u morën dhe u përdorën pikërisht prej atyre që kërkojnë t'ia mohojnë këtë rol Shqipërisë dhe që për miq të shqiptarëve kanë deklaruar fqinjët, qoftë edhe me anë të parullës "rruga e Shqipërisë për në Evropë kalon nga Athina", apo "Millosheviçi siç di të bëjë luftën, bën edhe paqen", ose ata që janë mjaftuar vetëm me një "hapësirë demokratike për shqiptarët në Ballkan". Prandaj Ukshin Hoti u thotë shqiptarëve të Kosovës që t'i heqin shpresat nga "shteti amë": "...ne shqiptarët e Kosovës, që dikur e kemi luajtur rolin e dorës së parë në themelimin e shtetit shqiptar, tani iniciativën për bashkim ua kemi lënë atyre të cilëve u mbetet që fillimisht të modernizohen, ndërsa në ndonjë të ardhme edhe të bashkohemi! (Hoti, 1996: 197).

Ndërsa Hysamedin Feraj shkon më tej kur u thotë shqiptarëve në Kosovë të supozojnë se Shqipëria nuk ekziston fare si shtet: "Çka do të bënte Kosova sikur të mos ekzistonte shteti shqiptar? A do të pranonte të jetonte nën sundimin serb, apo do të përpiquej për fitimin e pavarësisë politike?" (Feraj, 1997: 115). Megjithatë, nëse ndiqet kjo logjikë duhet bërë kujdes nga kurthi i të quajturit të Kosovës një subjekt tjetër joshqiptar. Rexhep Qosja ka shkruar se tentativat për krijimin e një "kombi kosovar" kanë ndikime shpërbërëse ndaj identitetit të kombit shqiptar. Kosovarizmi zëvendëson shqiptarizmin duke qenë "rrjedhimisht, ideologji kundërhistorike me të cilën do të mposhtej përgjithmonë ideja që e ka lëvizur historinë e popullit shqiptar prej Lidhjes së Prizrenit e këndeje: ideja e bashkimit kombëtar" (Qosja, 2006). Në fakt, është Kosova ajo që gjatë shek. XX e ka marrë përsipër përfaqësimin si subjekt të kombit: "...historia na ka treguar se Kosova tregoi pathyeshmërinë e kombit shqiptar, i shërben si mur mbrojtjeje shtetit shqiptar nga rreziku serb, po i shërben kombit shqiptar si ushtar pararojë dhe si kundërpeshë ndaj kërcënimit të shovinizmit grek" (Baleta, 1995: 21). Politikën zyrtare të Shqipërisë gjatë komunizmit mund ta karakterizojmë me termat e Karl Shmitit si një "revolucionar global" që luftonte për ideallet abstrakte të revolucionit proletar botëror dhe që tek kapitalistët dhe revizionistët e të gjitha ngjyrave shihte "armiq absolutë" (Slomp, 2005: 512). Brenda vendit ishte krijuar psikologjia

masive se e gjithë bota ishte armiqësore ndaj shqiptarëve dhe në këtë mënyrë enverizmi u hiqte shqiptarëve aftësinë për të dalluar miqtë nga armiqtë. Pas rënies së komunizmit, elita politike thekson vazhdimisht se Shqipëria nuk ka armiq dhe parullën “të gjithë janë armiq” e ka zëvendësuar me parullat “nuk kemi armiq”, apo “gjithë botën i kemi miq”. Ndikimi i këtyre parrullave në psikologjinë masive është po ai i enverizmit, sepse shqiptarëve u mpihet aftësia për të dalluar miqtë nga armiqtë (Feraj, 1999). Prandaj, në Shqipërinë e sotme kemi mungesë të politikës, sepse është hequr dorë nga kategoritë klasike të politikës: miku, armiku, sovraniteti, interesi kombëtar, reciprociteti, agjentë në shërbim të të huajit, etj. (Feraj, 2003: 9-13). Sfera publike është zëvendësuar nga ajo private, me politikanët që ndjekin interesat vetjake, ato të pasuesve të tyre, apo të vendeve fqinjë, por jo interesat kombëtare. Hysamedin Feraj thotë: “Problemi i Shqipërisë nuk është se ka shumë politikë, po se nuk ka fare politikë. Po ashtu thuhet se në Shqipëri duhet ndërtuar “shoqëria civile”, ndërsa problemi i Shqipërisë është ndërtimi i “shoqërisë politike”. Problemi i Shqipërisë është se ka vetëm “shoqëri civile”, sferë të privates, por nuk ka “shoqëri politike”. Sigurisht duke mos pas “shoqëri politike” edhe “shoqëria civile” nuk është mirëfilli civil. Por problemi madhor i Shqipërisë është ndërtimi i shoqërisë politike dhe jo i shoqërisë civile. Pa ndërtimin e një shoqërie politike, Shqipëria nuk mund të dalë nga kriza e saj totale” (po aty: 19-20). Këtu është vendi të ngremë py-



etjen se ç'duhet të bëjmë, ose me fjalët e Ukshin Hotit, “çka mund të bëhet që shqiptarët të jenë subjekt politik ndërkombëtar dhe jo vetëm objekt?” (Hoti, 1996: 261). Përgjigja është se duhet të rizbulojmë miqtë dhe armiqtë tanë. Shqiptarët kudo ku ndodhen, në Shqipëri, Kosovë, Ish-Republikë Jugosllave të Maqedonisë (IRJM), Mal të Zi, Greqi e diasporë duhet të binden se armiqtë i shohin ata si kolektiv dhe për t'u mbrojtur sa më mirë duhet edhe ata të veprojnë si kolektiv. Kjo do të thotë se miqtë e shqiptarëve në radhë të parë janë vetë shqiptarët. Me fuqizimin e faktorit shqiptar, pavarësisht

ndarjeve shtetërore, krahinore, fetare e gjeografike, shqiptarët do të gjejnë miq ndërkombëtarë. Pa i bindur faktorët ndërkombëtarë se kombi shqiptar është faktor pa të cilin nuk mund të realizohen interesat gjeopolitike në Ballkan e më gjerë, nuk mund të bëjmë miq ndër faktorët ndërkombëtarë.

Duhet të pyesim veten “ç'do të thotë të jesh shqiptar?” në rrethanat e sotme. Përgjigja duhet të jepet jo thjesht e me anë të miteve të së shkuarës, as me anë të ndonjë abstraksioni filozofik, por kryesisht nisur nga rrethanat ekzistenciale në të cilat gjendet kombi tani. “Cili është shqiptar?” ishte një pyetje vendimtare në vitet 1912-1913, atëherë kur caktoheshin kufijtë e shtetit shqiptar. Ishte pyetje që përcaktonte jetën dhe vdekjen. Ishte pyetje që në jug të Shqipërisë e bënte Komisioni Ndërkombëtar? A duhej marrë për bazë gjuha, siç donin nacionalistët shqiptarë, apo feja, siç donin grekët? Një pyetje e tillë shtrohet edhe sot: “A janë ‘homogjenët’ shqiptarë apo grekë?”, “A janë himarjetotë shqiptarë apo grekë?”, “A janë eshtrat e zhvarrosura në Kosinë të grave dhe fëmijëve shqiptarë apo të ushtarëve grekë?”. Nga përgjigjet e këtyre pyetjeve varet shumëçka. Nuk janë thjeshtë çështje individuale apo të drejtave të njeriut, por të kolektivit të quajtur “shqiptar”. Në mënyrë të ngjashme kur ambasadorët grekë deklarojnë me cinizëm se përveç atyre në Alpet e Veriut, të gjithë shqiptarët janë me prejardhje helene dhe se duhet të kthehen sa më parë në etninë dhe fenën e të parëve, apo se çamët nuk u përzu-



në nga trojet e tyre, por ikën vetë, nuk është thjeshtë çështje e mohimit dhe e mbrojtjes së vërtetës, por një sulm, një qëndrim armiqësor i një kolektivi tjetër kundër shqiptarëve. Ashtu sikundër edhe ligji grek i luftës me Shqipërinë nuk është një anakronizëm apo i drejtuar vetëm kundër çamëve, por pjesë thelbësore e sulmit kundërshtiqiptar. Le t'i braktisim iluzionet: kemi apo nuk kemi interes të quhemi shqiptarë, të tjerët na shohin si të tillë, si një kolektiv. Ata na llogarisin si kolektiv edhe kur veprojnë kundër një pjese prej nesh dhe ne duhet të reagojmë si kolektiv që të kemi sukses. Spastrimi etnik në Kosovë u drejtua kundër shqiptarëve. Në vend që të kërkonin falje për krimet e përbindshme dhe t'u përgjroheshin shqiptarëve për sigurinë e pakicës serbe në Kosovë, serbët me arrogancë krekosen se kanë në dorë çelësin e statusit dhe janë në sulm për të rifituar atë që humbën. Me anë të "ekstraterritorialitetit" të manastireve dhe komunave te reja strategjike me shumicë serbe që po krijohen po përgatitet boshnjakëzimi i Kosovës. Shqiptarët duhet të shikojnë se si po shkon shtet-formimi në Bosnjë-Hercegovinë, të pyesin nëse mund të quhet ajo një shtet sovran dhe pastaj të vendosin nëse është ajo trajtë sovraniteti që dëshirojnë për Kosovën. Kushtetuta e vjetër e IRJM, prej së cilës sllavomaqedonasit hoqën dorë vetëm nën kërcënimin e armëve të UÇK, i trajtonte shqiptarët si pakicë etnike. Nëse partitë shqiptare në IRJM do të vazhdojnë të jenë armiq të njëra-tjetrës, atëherë pozita faktike e shqiptarëve në atë shtet do të mbesë ajo e qytetarëve të dorës së dytë. Greqia ndërsa ua mohon shtetësi-

në greke çamëve ua dhuron me "bujari" atyre që shpreson se do të jenë kolonë e pestë në Shqipëri. Shqiptarët që shpallen grekë ta kenë të qartë se qoftë edhe pasivisht, thjeshtë si numër, po i shërbejnë shovinizmit grek.

Nëse një pjesë e popullatës shpall se nuk e njeh armikun, atëherë ata rreshtohen përkrah tij (Schmitt, 1996: 51).

Në këto rrethana ekzistenciale për kombin atyre që qahen për mungesë të një programi të shtjelluar kombëtar, duhet t'u përsërisim fjalët e Abdi Baletës: "Programi i shqiptarëve është me dy fjalë: kemi programin e Lidhjes së Prizrenit" (Kabashi & Baleta, 2005: 39). Programi është bashkim, organizim dhe mobilizim i të gjithë shqiptarëve që të japin ndihmesën e tyre në forma të ndryshme dhe në ballë të ndryshëm kundër armiqve. Të mos mendojmë se po shpallëm se nuk kemi armiq, kjo ka për t'i shkruajuar ata: "Do të ishte qesharake të besosh se një popull i pambrojtur ka veç miq dhe një llogaritje e çmendur të supozosh se ndoshta armiku mund të mallëngjehet nga mungesa e qëndresës" (Schmitt, 1996: 53).

## Burimet:

- Baleta, A. (1995) Shqiptarët përballë shovinizmit serbo-grek. Tiranë: Koha.  
 Feraj, H. (1997) Pavarësia është e shenjtë. Tiranë: Koha.  
 Feraj, H. (1998) Skicë e mendimit politik shqiptar. Tiranë: Koha.  
 Feraj, H. (1999) "Kadare kërcënon shqiptarët". Gazeta Rimëkëmbja. Tiranë, 09.03.1999.  
 Feraj, H. (2003). Kriza e përkryer e Shqipërisë. Tiranë: Eurorilindja.  
 Frashëri, K. (1984) Abbdyl Frashëri. Ti-

ranë: 8 Nëntori.

Frashëri, K. (1997) Lidhja shqiptare e Prizrenit (1878-1881). Tiranë: Toena.

Frashëri, M. (1997) Kthimi i Mitat Frashërit. Tiranë: Phoenix.  
10

Frashëri, S. (2000) Kush e prish paqen në Ballkan: Publicistika e Sami Frashërit turqisht.

Pejë: Dukagjini.

Hoti, U. (1996) Filozofia politike e çështjes shqiptare. Prishtinë.

Kabashi, B. & Baleta, A. (2005) Vetëm nacionalizmi e shpëton kombin shqiptar. Tiranë: Rimëkëmbja.

Lazar, N. C. (2006) "Must Exceptionalism Prove the rule? An Angle on Emergency

Government in the History of Political Thought". Politics & Society, 34 (2): 245-275.

Malcolm, N. (1998) Kosovo: A Short History. New York: New York University Press.

Myzyri, H. (red.). (1994) Historia e popullit shqiptar. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor.

Omari, L. & Luarasi, A. (red.). (1997) Historia e shtetit dhe e së drejtës. Tiranë: Luarasi.

Pollo, S. & Pulaha, S. (red.). (1978) Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912.

Tiranë: Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë.

Qosja, R. (2006) "Identiteti shqiptar dhe identiteti kosovar". Gazeta Korrieri. Tiranë, 07.02.2006.

Schmitt, C. (1996) The Concept of the Political. Chicago, London: The University of Chicago Press.

Schmitt, C. (2005) Political Theology: Four Chapters on the Concept of the Sovereignty.

Chicago, London: The University of Chicago Press.

Skëndi, S. (2000) Zgjimi kombëtar shqiptar 1978-1912. Tiranë: Phoenix & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit.

Slomp, G. (2005) "The Theory of the Partisan: Carl Schmitt's Neglected Legacy".

History of Political Thought, 26 (3): 502-519.

Shpuza, G. (2000) Kuvendime për historinë kombëtare. Tiranë: Dituria.

Valk, F. V. (2002) "Decisions, Decisions: Carl Schmitt on Friends and Political Will".

Rockefeller College Review, 1 (2): 38-52.

